



Koha

www.koha.mk



**Gazetarët
në Maqedoni,
ende nën trysni**

EDITORIAL |||||

Liria dhe profesionalizmi i mediave



Liria e shprehjes dhe liria e mediave nuk janë gjithmonë në të njëjtat nivele. Dje kur shënojm Ditën botërore të lirisë së shprehjes, na u kujtua t'i hedhim një sy edhe situatës në Maqedoni.

DOSSIER |||||

Kur Tito rrëzoi Rankoviqin në Brioni

RAJON |||||

Anton Çuni sërish pëplaset me Xhavit Halitin rreth fondeve të luftës



VAZHDOJNË TË HETOHEN NGJARJET E 27 PRILLIT

PËRGJEGJËSI EDHE PËR PROKURORËT



Dëmin më të madh pas ngjarjeve të 27 prillit, mendohet se e kanë bërë prokurorët e Prokurorisë së Shkupit dhe asaj për Krim të organizuar. Pastrimi i menjëhershëm i sallës së Parlamentit ku ndodhi dhuna më e madhe (Salla e Shtypit), dhënia e mundësisë për fshirjen e dëshmimeve të rëndësishme apo dhënia e kohës që video xhirimet e kamerave të vidhen e shkatërrohen, paraqesin elementet kryesor në bazë të cilëve zhvillohen hetimet përbrenda Prokurorisë Republikane

Gjendet trupi i pajetë i policit Armend Trena

Mediat kosovare kanë raportuar për gjetjen e njërit prej policëve të zhdukur qe gjashtë ditë në ujërat e lumit Lepenc. Bëhet fjalë për Armend Trenën. Policia e Kosovës të enjten ka dhënë informatat e para zyrtare lidhur me gjetjen e njërit nga trupave të policëve, të zhdukur mbrëmjen e së shtunës në lumin Lepenc. Agim Gashi, zëdhënës i policisë së rajonit në Ferizaj, ka thënë se trupi është gjetur

rreth orës 15:45 minuta. "Rreth orës 15:45 në një aksion të përbashkët të policisë së Kosovës, njësiteve zhytëse të FSK, zjarrfikësit, është kontrolluar një vend ku kemi dyshuar dhe pas një kohë ka rezoluar dhe në kilometrin e pestë në drejtim të Hanit të Elezit është gjetur njëri nga trupat e pjesëtarëve të policisë që ka pësuar aksident", ka thënë Gashi, transmeton gazeta KOHA.



EDITORIAL

LIRIA DHE
PROFESIONALIZMI
I MEDIAVE

Emin AZEMI

Liria e shprehjes dhe liria e mediave nuk janë gjithmonë në të njëjtat nivele. Dje kur shënonim Ditën botërore të lirisë së shprehjes, na u kujtua t'i hedhim një sy edhe situatës në Maqedoni. Shumë kush, siç është zakoni të flitet në ditë festash, zgjodhi të thotë atë që i dukej më interesant. Por ngeli pa u trajtuar profesionalizmi i mediave dhe çlirimi i tyre nga shtërngimet e pronarëve me afërsi politikanësh, si parakusht për një gazetari të lirë e të paanshme. Në shumë vende postkomuniste, liria e shprehjes madhje ka qenë e garantuar edhe me ligje, mirëpo monopoli dhe koncentrimi i mediave ka penguar profesionalizmin e mirëfillt të tyre. Për rrjedhojë, liria e shprehjes dhe liria e medias ka qenë në njëfarë grindjeje të vazhdueshme dhe jo rrallë liria e shprehjes ka pësuar nga ambicet politike të pronarëve të mediave.

Ngeli pa u trajtuar edhe puna dhe statusi i portaleve, por edhe çështja e bashkëpunimit të mediave në vend dhe në rajon. Sa i përket portaleve, disa prej tyre, janë nusprodukt i gazetarisë, por nuk prodhojnë informacion origjinal. Ato më shpesh transmetojnë nga të tjerët, se sa që raportojnë vet nga vendi ngjarjes. Pra, ato perodhojnë shumë informacion, por pak gazetari origjinal dhe ky është problem fundamental i portaleve, të cilat këtë nuk e bëjnë nga luksi por nga halli. Mund të jetë ky edhe një rast që të gjenden mekanizma institucional për subvencionimin e atyre portave që janë në suaza të mirëfillta të profesionalizmit

Në botë njihen disa tipe portalesh, por portalet e mirfillta janë ato të cilat burojnë prej një medie të caktuar, prej një gazete prej një televizioni. Por edhe atëher kur një portal funksionon si medie e mirfilltë që ka ekipin e vet, që ka infrastrukturën e vet dhe burimet e veta të informacionit, atëher një portal i tillë mund të jetë konkurrues në treg bashkë me mediat e tjera.

Fatkeqësisht te ne ka shumë pak portale të tilla dhe dominojnë ato të cilat duke u marrë me ashtuquajturën "copy paste", gazetari, po i bëjnë më së shumti dëm vet gazetarisë, nga arsya se në portalet e tilla e kemi vërejtë se udhëhiqen nga njerëz jo profesionist dhe tekstet që ata po botojnë nuk i konfirmojnë burimet.

Një dukuri tjetër që bie në sy është perkthimet apo marrja integrale e teksteve nga portalet maqedone ose ato serbe, prandaj një informacioni i tillë i papërpunuar mund të krijoj më shumë huti se sa informim të drejtë në opinion. S'do medn se dhe portalet duhet të trajtohen me anë të një ligji për media dhe portalet të kenë statusin e gazetave dhe të televizioneve, aq më tepër kur tani interneti është resursi kryesorë që e bënë gazetarinë të jetë më afër lexuesit.

Pra behet fjalë për gazetarinë e internetit që është shumë afër portaleve. Është mirë që të kemi një gazetari të shpejtë, në të cilën do të kemi qasje të drejtpërdrejtë dhe një shtrirje të gjithëanshme. Portalet në gjuhën shqipe në Maqedoni do të duhej të bashkëpunojnë me portalet tjera në hapsirën shqiptare që të kenë herë pas here projekte të përbashkëta hulumtuese, dhe kjo do t'ju ndihmon mediave tjera të ashtuquajtura klasike, si televizionet dhe gazetatat, që ti furnizojnë dhe ushqejnë me tema dhe informacione të dores parë.

HAMDI BAJRAMI NUK ËSHTË VETËM!

"Gjithë kjo spërhellje e politikanëve shqiptarë në Maqedoni për t'u ngulur në pushtet! Kush duhet të mendojë për kushtet e bashkëqeverisjes, platformën shqiptare, avancimin e statusit të popullit shqiptar në Maqedoni, apo të gjithë janë shndërruar në 'integristë', 'globalistë', 'internacionalistë', 'socialdemokratë', pasi i morën në qafë dhe viktimizuar disa qindra familje shqiptare, i shkatërruan dhjetëra vendbanime, ekonominë, shëndetësinë, arsimin, kulturën, dhe e 'paketuan' rininë për në botën e jashtme?! Deputet me përkatësi rome, i cili bën pjesë (numër) në secilën qeveri të Maqedonisë, pavarësisht nga programi dhe orientimi i saj...", shkruan në profilin e tij në Facebook, prof.Abdulla Mehmeti.

JO SHËRBIME PËR QYTETARËT

"Republika e Kosovës është rezultat i përpjekjeve të popullit për liri. Ne besojmë se barazia midis popujve dhe brenda popujve është rrugëzgjdhje për paqe, mirëqenie dhe progres. Konsiderojmë se vështirësitë e saj të sotme me Republikën e Serbisë janë pasojë e të kaluarës pushtuese dhe historisë së segregacionit etnik e zhvillimor, që shkaktoi ndasitë mes qytetarëve dhe grupeve sociale. Regjimet e tilla nuk do të përsëriten në Kosovë. Shoqëria jonë që i përjetoi ato duhet të jetë garantuese e trajtimit të barabartë të të gjithë banorëve të saj. Megjithatë, sot Republika e Kosovës vazhdon të jetë e pazhvilluar si shoqëri, e varfër si ekonomi dhe e pa konsoliduar si shtet. Shumica e saj, qytetarët, janë të nënshtruar politikisht dhe të shfrytëzuar ekonomikisht brenda një shteti që i shërben interesave të pakicës që pronëson dhe kontrollon shumicën e pasurisë.

Sot, qeverisja shtetërore nuk ushtrohet në gjithë territorin e Republikës. Administrata e saj e madhe mundëson punësim për klientët, por jo shërbime për qytetarët. Sistemi politik mundëson demokraci zgjedhore, por zvogëlon legjitimitetin shoqëror. Tregu vendor vazhdon të ketë qarkullim të madh të mallrave, por akumulim të vogël të pasurisë. Si shoqëri, qytetarët e saj jetojnë bashkë formalisht, por të ndarë në realitet. Përgjithësisht, republika jonë mbetet vend ku mundësohet mbijetesja, por jo edhe mirëqenia e bashkëjetesa. Jemi të përkushtuar që ta ndryshojmë këtë situatë. Sot, qytetarët e Republikës janë shumica që ka pak.

Angazhimi për ta, angazhimi bashkë me ta, është përpjekje për interesin e përgjithshëm. Politikat që shpunësuan, varfëruan dhe përjashtuan duhet të zëvendësohen me politikat zhvillimore, social-demokrate, që do të mundësojnë prodhim vendor, punësim për të gjithë dhe shpërndarje të drejtë", shkruan në FB, deputeti Dardan Molliqaj.

PËR SHKAK TË ATYRE DHE KËTYRE...

"Ka vite që nuk marrë pjesë në tubime ku përkujtohen personalitete apo ngjarje të rëndësishme të historisë sonë kombëtare! Jo që nuk çmoj lartë veprat e lavdishme të ATYRE që sakrifikuuan gjithçka për lirinë tonë, por për shkak të KËTYRE që nuk lanë gjë të pistë pa bërë, pikërisht në emër të sakrificës së lartëcekurve! lavdi jetës dhe veprës së të gjithë dëshmorëve, martirëve dhe atdhetarëve të vërtetë, që i kishim ndër shekuj...", shkruan në profilin e tij në Facebook, ish-ushtari i UÇK-së, dr.Selver Jashari.

MEDIACitate

Grindje për
Buxhetin

Negociatat për buxhetin e Bashkimit Evropian, për "Kornizën Shumëvjeçare të Financimit" (KSHM), janë gjithmonë të vështira. Por kësaj radhe ekspertët si Guntram Wolff mendojnë se vështirësitë do të jenë edhe më të mëdha. Me daljen e Britanisë së Madhe nga BE-ja do të largohet që nga viti 2021 edhe paguesi i tretë më i madh në buxhetin e BE-së. Për periudhën 2021 - 2027 do të ketë një zbrastirë financimesh prej rreth 90 miliardë euro, pohon Komisioneri për Buxhetin Günther Oettinger. BE-ja do të ketë pra më pak para për të shpërndarë, ndaj edhe lufta për financimet do të jetë më e ashpër. Günther Oettinger do të dëshironte të ketë një përzjerje mes kursimeve dhe riorientimit të financimeve. "Në dy programe të mëdha, politika agrare dhe politika e kohezioneve, do të kemi shkurtime efektive prej 6%, në krahasim me vitin 2020", tha Oettinger në prill në Berlin. "Për këto fusha janë ndarë më parë rreth 80% e buxhetit, ndërsa në të ardhmen do të ndahen 60%". Kjo do të thotë se shtetet të cilat përfitojnë shumë nga kjo mbështetje, si Polonia, Hungaria apo Greqia, duhet të përgatiten për më pak para. Ndërkohë po shtohet edhe rezistenca. Qeveria polake kërkon që financimet të mos shkurtohen në rajonet më të dobëta. Irlanda angazhohet fuqishëm kundër shkurtimeve për bujqësinë. Ajo ka kërcënuar me veto. Eksperti Guntram Wolff mendon se subvencionimet për bujqësinë janë të tepërta. "Ne duhet të japim më pak për bujqësinë, ndërsa mjetet duhet të përdoren më mirë". Wolff kritikon edhe ndihmat për rajonet me struktura më të dobëta, sepse para paguhen edhe për vendet e pasura si Gjermania apo Spanja. "Duhet parë se cilat rajone kanë vërtet nevojë dhe sa janë efektive këto financime". Negociatat do të jenë të vështira dhe të gjata. Për kornizën e tanishme financiare negociatat kanë zgjatur gati dy vite. Oettinger kësaj radhe pretendon që ato të përfundojnë më shpejt - brenda një viti.

(DW, 3 maj 2018)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

Çfarë është "sëmundja e Gushës"?

Gusha është një sëmundje që karakterizohet nga zmadhimi i vëllimit të gjëndrave tiroide. Në disa periudha të caktuara të jetës, kur proceset metabolike të organizmit zhvillohen më me vull, nevojat për hormonin e tiroides shtohen dhe tiroidja, në pamundësi të sigurojë hormonin e saj në sasi të mjaftueshme, rritet. Gusha është sëmundje që njihet prej kohësh. Në

shumicën e vendeve të botës është endemike, si edhe në shumë rrethe të Shqipërisë. Shkaku i saj është pamjaftueshmëria e jodit në mjedis (në ujë dhe ushqime). Profilaksia e gushës endemike bëhet me anën e jodit, për t'i siguruar individit sasinë që i duhet organizmit. Mënyra më e përshtatshme është përdorimi i kripës së jodizuar.

VAZHDOJNË TË HETOHEN NGJARJET E 27 PRILLIT

PËRGJEGJËSI EDHE PËR PROKURORËT

Dëmin më të madh pas ngjarjeve të 27 prillit, mendohet se e kanë bërë prokurorët e Prokurorisë së Shkupit dhe asaj për Krim të organizuar. Pastrimi i menjëhershëm i sallës së Parlamentit ku ndodhi dhuna më e madhe (Salla e Shtypit), dhënia e mundësisë për fshirjen e dëshmimeve të rëndësishme apo dhënia e kohës që video xhirimet e kamerave të vidhen e shkatërrohen, paraqesin elementet kryesor në bazë të cilëve zhvillohen hetimet përbrenda Prokurorisë Republikane



Kryeprokurori, Lubomir Jovevski, në deklaratën e fundit të dhënë për portalin "Sdtk" ka njoftuar se përgjegjësi disiplinore për ngjarjet e dhunshme të 27 prillit, në të ardhmen do të kërkohet edhe nga vetë prokurorët që fillimisht e kanë shqyrtuar lëndën. Vonesa e fillimit të hetimeve apo mos iniciimi fare i hetimeve për ngjarjet e 27 prillit, kryesisht nga prokurorët të Prokurorisë së Shkupit dhe asaj për Krim të organizuar, janë lëndë shqyrtimi i hetimeve të brendshme të Prokurorisë Publike të Maqedonisë. Kryeprokurori, Lubomir Jovevski, duke folur për "Sdtk", nuk ka dhënë detaje tjera dhe aq më pak nuk ka treguar se vallë paraardhësi i tij Marko Zverlevski, është pjesë e këtyre hetimeve

Procedura interne e Prokurorisë Publike për vërtetimin e

përgjegjësisë së prokurorëve për ngjarjet e 27 prillit, paraqet një hap të rëndësishëm në rrugën e reformave të sistemit të drejtësisë në vend. Ndonëse deri më tani shumë veprime të prokurorëve nga palët e ndryshme në procese gjyqësore, por edhe nga vetë opinionin janë cilësuar si jo ligjore dhe aspak profesional, hetimet e brendshme në Prokurorinë Republikane, ngjallin shpresa se përfundimisht edhe kjo pjesë e hierarkisë së shtetit mund të'i nënshtrohet procedurës disiplinore.

Dëmin më të madh, siç raportojnë mediat në gjuhën maqedone, pas ngjarjeve të 27 prillit, mendohet se e kanë bërë prokurorët e Prokurorisë së Shkupit dhe asaj për Krim të organizuar. Pastrimi i menjëhershëm i sallës së Parlamentit ku ndodhi dhuna më e

madhe (Salla e Shtypit), dhënia e mundësisë për fshirjen e dëshmimeve të rëndësishme apo dhënia e kohës që video xhirimet e kamerave të vidhen e shkatërrohen, paraqesin elementet kryesor në bazë të cilëve zhvillohen hetimet përbrenda Prokurorisë Republikane.

Krahas proceseve të ndara për sulmuesit e deputeti Ziadin Selës dhe Radmilla Shekerinksës (që përfundoi muaj më parë), para Gjykatës Penale të Shkupit, së shpejti pritet të filloi procesi gjyqësor kundër 35 të akuzuarve që në nëntor të vitit të kaluar u arrestuan në dyshimin se drejtëpërdrejtë kanë marrë pjesë apo kanë ndihmuar dhunën e 27 prillit. Aktakuza e ngritur nga Prokuroria për Krim të Organizuar e parashtruar në GJPSH, javë më parë, në vetë përmban një varg detajesh nga ajo se si

ka filluar dhe kush ka marrë pjesë në hyrjen brutale në Parlament. Megjithatë, deri më sot, përkundër shumë hetimeve dhe risive prokuroria nuk ka njoftuar se a disponon me të dhëna se kush janë organizatorët e 27 prillit. Në një pjesë të aktakuzës për ngjarjet e 27 prillit e cila për momentin është para Këshillit për vlerësim në GJPSH-së, thuhet se pas ditën e 27 prillit të vitit 2017, një pjesëtar i sigurimit të Nikolla Gruevskit, nga Vjena ka kontaktuar me disa persona në Shkup, prej ku edhe ka filluar sulmi ndaj institucionit më të lartë në vend, Parlamentit. Sidoqoftë, ish kryeministri Gruevskin, në disa raste i ka demantuar këto konstatime dhe ka thënë se pjesëtarët e sigurimit të tij asnjëherë nuk kanë shfrytëzuar telefona celular nga shteti, por vetëm kartela telefonike.

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 3 maj- Pas një viti të plotë, Prokuroria Publike e Maqedonisë, ka filluar hetimet e brendshme për mbulimin e provave nga prokurorët paraprak të cilët e proceduan lëndën për ngjarjet e 27 prillit të vitit 2017. Përveç prokurorëve, deri më tani organet e rendit, në bashkëpunim me prokuroritë përkatëse, kanë shqyrtuar masa disiplinore kundër një numri të konsiderueshëm të nëpunësve policor. Në mesin e shumë policëve që hetohen për ngjarjet e 27 prillit, vitin e kaluar u arrestua edhe ish shefi i Byrosë për Siguri Publike, Mitko Çavkov dhe disa epror të lartë të njësive speciale.

LSDM: Mickoski mbetet në mbrojtje të krimeve të Gruevskit

Qendra për komunikim me media e Lidhja Sociale Demokratike të Maqedonisë ka reaguar ndaj qëndrimeve indiferente të liderit të ri të VMRO-DPMNE-së.

"Hristijan Mickoski përsëri ka humbur mundësi që të distancohet nga politikat e ndarjeve dhe destruktivitetit të paraardhësit të tij Nikolla Gruevski që fuqishëm u mposhtën nga shumica e qytetarëve. Me këtë Mickoski tregon se mbetet në mbrojtje të krimin, shkatërrimit dhe korrupsionit që partia dhe shefi i tij Gruevski e kanë bërë 11 vite të plota.

Mickoski deri tani është i njohur vetëm për vazhdimin e politikave destruktive dhe përhapjen e lajmeve të



rrime. Maqedonia po ec përpara si një shoqëri për të gjithë, shtet modern-mik në rajon dhe Evropë dhe asnjë veprim destruktiv i VMRO-DPMNE-së nuk do ta ndalon procesin e reformave, integritetit dhe zhvillimit", thuhet në reagimin e Qendrës për komunikim me media e Lidhja Sociale Demokratike të Maqedonisë.

Kongresistët amerikanë pro anëtarësimin të Maqedonisë në NATO

Kongresisti amerikan, Jim Banks, udhëheq një grup kolegësh të tij në letërën dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-së, Jens Stoltenberg, në lidhje me Maqedoninë. Në këtë letër thuhet se SHBA-të e kanë mbështetur synimin e Maqedonisë për anëtarësim të plotë në institucionet euro-atlantike, shkruan Telegrafi.

Duke e konsideruar si komb shumë kulturorë, kongresistët thonë se Maqedonia ka të ardhme të ndritshme, dhe se besojnë që është koha për anëtarësim të Maqedonisë në NATO.

Kongresistët shprehën se e kanë vëzhguar nga afër situatën politike dhe diplomatike, duke theksuar se shohim mundësi për forcimin e marrëdhënieve me këtë shtet, dhe se janë të inkurajuar nga përparimi i bisedimeve dhe vulnetit të Maqedonisë dhe Greqisë në marrëdhëniet e tyre. Sipas tyre, partneriteti i Maqedonisë



me NATO-në, dhe natyra e ndërlikuar e sigurisë, sidomos përkeqësimi me Rusinë, bëjnë që Maqedonia me patjetër të bëhet anëtare e Aleancës.

Prandaj, kongresistët kërkojnë që Maqedonia të ftohet në NATO, për të forcuar bashkimin transatlantik, si edhe për të rritur përparësinë ndaj agresionit të Rusisë

Deputeti i ASH-së Syrja Rashidi tha se puna e deritashme e PSP-së lë shumë për të dëshiruar sa i përket drejtësisë selektive që ende siç tha ai është e pranishme në organet gjyqësore në Maqedoni duke mos bërë përjashtim as PSP

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 3 maj - Raporti 6 mujor për aktivitetet e Prokurorisë Publike Speciale (PPS) ishte në rend dite në vazhdimin e seancës së Komisionit parlamentar për sistem politik dhe marrëdhënie ndërmjet bashkësive.

Deputeti i VMRO-së Zoran Ilioski adresoi kritika ndaj Prokurores speciale Katica Janeva. Duke përzgjedhur ekspertët ligjor të afërt me LSDM-në, Janeva len dilema tek qytetarët se në të vërtetë, siç tha Ilioski, nëse kjo prokurori është e paanshme në punën e saj. Shkelja e ligjit mbi prokurorinë special publike lidhur me vonesat në ndërtimin e akuzave edhe për skaj asaj se ka kaluar afati 18 mujor, mungesa e transparencës duke mos dhënë shifra konkrete në raport për harxhimin e mbi 900 mijë eurove gatë periudhës gjashtë mujore, ishin këto konstatimet e deputetit Zoran Ilioski për punën e PDSP-së.

Ndërkaq deputeti i ASH-së Syrja Rashidi tha se puna e deritashme e PSP-së lë shumë për të dëshiruar sa i përket drejtësisë selektive që ende siç tha ai është e pranishme në organet gjyqësore në Maqedoni duke mos bërë përjashtim as PSP. "Kemi dëgjuar biseda se si dikush merret me kurdisje për gjyqtar e

KATICA JANEVA RAPORTOI PËR PUNËN GJASHTË MUJORE

OPOZITA ME VËREJTJE TË SHUMTA PËR PSP-në



prokurorë, se si merren vendime për prishje të ndërtesave. Puna juaj është të veproni njëjtë si ndaj atyre që kanë qenë në pushte dhe atyre që janë tani në pushtet", tha Syrja Rashidi.

Prokurorja Speciale Katica Janeva, nga ana e saj, tha se institucioni që ajo drejton nuk mund t'i japë llogari institucioneve tjera për njerëzit që përzgjedhur për ekspertë. Të gjitha ekspertët që janë përzgjedhur janë në listën publike të ekspertëve të ministrisë së drejtësisë. Ajo sa i përket transparencës për shpenzimin e parave tha se në faqen e elektronike të PSP-së është e publikuar fletëparaqitja e shpenzimeve për çdo periudhë gjashtë mujore.

Ndërkaq për dilemën që ngrii Deputeti Zoran Ilioski se deri më tani ende jemi larg konstatimit të dimëse kush në të vërtetë ka përgjuar në Ma-

qedoni, Katica Janeva përmendi rastet "Target" për të cilin ka aktgjykim. Por siç tha jo pa ekstradimin e Nikola Boshkosvit dhe të Goran Grujovskit nuk mund të përfundojë hetimet ndaj Sasho Mihajkovit.

Ndryshe gjatë raportimit të saj për punën e Prokurorisë Publike Speciale për periudhën 15 shtator 2017-të dhe 15 mars 2018-të, Katica Janeva tha se zgjedhjet e fundit ligjore me theks të veçantë ligji për dëshmitar të mbrojtur do të mundësojë lehtësimin e punës së saj dhe që ky institucion ta realizojë misionin e vetë për të cilin është themeluar edhe atë hetimin dhe ndjekjen e të gjitha veprave që dalin nga përgjimet e palejuara të garniturës së kaluar në pushtet. Ajo veç tjerash përmendi atë se kane konceptuar dhe punuar rregulloren për themelimin e Qendrës për hetime e

cila siç tha Katica Janeva u bë e mundur me ndryshimin e ligjit për ndjekje penale. Ajo vuri theksin tek marrja e kompetencës për hetimin e veprave të larta për korrupsion që sugjerohet së fundmi në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian. "Shumë qytetarë pyesin nëse vetëm materialet e përgjuara janë dëshmi për ngritjen e akuzave ndaj funksionarëve të pushtetit të kaluar. Jo ato janë vetëm indicie se ka pasur keqpërdorime por akuzat ngrihen në bazë të materialeve të dokumentuara dhe dëshmi të dëshmitarëve për ato vepra. Deri më tani kemi përfunduar me shumicën e aktakuzave të cilat janë pranuar nga ana e gjykatave përveç njëres që nuk është pranuar ku kishte të bënte me akuzat ndaj gjyqtarëve të caktuar por besojmë se edhe kjo do të kryhet", tha Katica Janeva.



Maqedonia dhe K DFA nënshkruan memorandum mirëkuptimi

Shkup, 3 maj - Qeveria e Maqedonisë nënshkroi Memorandum mirëkuptimi për zbatimin e reformave në sektorin e sigurisë dhe shërbimeve të kundërbulimit, për periudhën 2017-2020, me Qendrën e Gjenevës për Kontroll Demokratike ndaj Forcave të Armatosura (K DFA).

Me këtë rast, Zaev tha se bashkëpunimi është kyç për kthimin e besimit të qytetarëve në këto institucione të sigurisë, që në të kaluarën ishin të konsideruara si simbol i shtetit të kapur.

Thomas Gruber nga K DFA tha se ky moment është kulminacion i bisedave të gjata disamujshme të afërta me Qeverinë dhe partnerët ndërkombëtarë. Për këto reforma, ndihmë ofroi SHBA-ja, ndërsa zbatohen sipas modelit të Gjermanisë, por parasegjithash sipas shembullit të Kroacisë.

DEBAT PËR PLANIN 3-6-9

JO REFORMA SIPAS STATISTIKËS, POR SIPAS REALIZIMIT

Lukash Holub nga Delegacioni i BE-së shfaq shpresë se ky do të jetë rekomandimi i fundit i BE-së për fillimin e negociatave. "Nuk bëhet fjalë për inkuadrim në BE, ju tashmë jeni në Evropë. Nevojitet ndryshim i mënyrës se si bëhen punët dhe ky është thelbi. Nuk bëhet fjalë për ligje, por për implementimin e tyre", tha Holub



ra, ndërsa 30 janë të pamatshme. Këto janë rezultatet për agjendën reformuese nga Plani 3-6-9 i Qeverisë që sot i prezantoi Instituti për Demokraci "Societas civilis - Shkup", "IDSCSH" në bashkëpunim me Fondacionin "Konrad Adenauer".

Koordinatori projektues i "IDSCSH", Zoran Neçev tha se analiza tregon se 66 aktivitete apo 51 për qind i adresojnë rekomandimet nga raportet e Pribesë, derisa 16

apo 12 për qind nga masat tregojnë harmonizim me Programin kombëtar. Konkluzioni është se Plani në mënyrë të kënaqshme i ndjek rekomandimet e Pribesë, ndërsa është vërejtur edhe harmonizim i ulët me dokumentet strategjike kyçe i cili i përfshin harmonizimet e legjislativonit kombëtar me atë evropian.

Zëvendëskryeministri për Eurointegritim, Bujar Osmani tha se Plani 3-6-9 e ka arritur qëllimin dhe

e ka kthyer vendin në rrugën euroatlantike.

"Kam dilema lidhur me matjen statistikore të Planit për shkak dallimeve në masat dhe peshën e tyre. Kemi metodologji të ndryshme në matjet nga vendi ynë, sipas të cilës kemi 94 për qind realizim. Megjithatë, më me rëndësi është që vendi është stabilizuar", tha Osmani.

Theksoi se qëllimi i Planit është që është gjithëpërfshirës dhe i përfshijnë të gjithë nga opozita dhe

shoqëria civile.

Ambasadori francez, Kristian Timonie tha se Plani 3-6-9 në afat të shkurtër nuk ka dalë nga binarët, por ka pasur ngadalësim, për të cilin beson se i detyrohet kulturës politike të akuzave.

"Sistemi politik nuk funksionon mirë, opozita u tërhoq nga Kuvendi dhe u sollën ligje të përsheptuara. Në një demokraci moderne opozita nuk duhet të jetë jashtë. Amendamentet nuk duhet të shikohen si mjet për sabotim dhe duhet të pranohen dhe shqyrtohen", tha Timonie.

Lukash Holub nga Delegacioni i BE-së shfaq shpresë se ky do të jetë rekomandimi i fundit i BE-së për fillimin e negociatave.

"Nuk bëhet fjalë për inkuadrim në BE, ju tashmë jeni në Evropë. Nevojitet ndryshim i mënyrës se si bëhen punët dhe ky është thelbi. Nuk bëhet fjalë për ligje, por për implementimin e tyre", tha Holub/MIA

Shkup, 3 maj - Vëzhgimet e Raportit të tretë nga përbushja e reformave në Planin 3-6-9 tregojnë se ka realizim të kënaqshëm dhe se prej gjithsej 130 aktiviteteve janë përbushur 78, gjegjësisht 60 për qind, shtatë aktivitete janë përbushur pjesërisht, 14 janë të papërbushu-

DITA BOTËRORE E LIRISË SË SHTYPIIT

GAZETARËT NË MAQEDONI, ENDE NËN TRYPSNI

Në Ditën Botërore të lirisë së mediave, nga Shoqata e Gazetarëve (SHGM) apelojnë për reforma serioze mediatike, përmirësimin e performancave të Qeverisë, ndryshime urgjente lidhur me prioritetet për të siguruar të drejtat profesionale të gazetarëve dhe punonjësve të mediave

Koha

Evis HALILI

Shkup, 3 maj – Pavarësisht se raportet e organizatave të huaja e rangojnë Maqedoninë disa shkallë më lart sa i takon lirisë së mediave, panorama e përgjithshme është shumë larg pritshmërive. Gazetarë të keqpaguar, me paga nën mesataren dhe kushte pune me siguri minimale, e rendisin vendin ndër shtetet e fundit në rajon për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve dhe lirisë së mediave. Kjo është arsyeja që në Ditën Botërore të lirisë së mediave nga Shoqata e Gazetarëve (SHGM) apelojnë për reforma serioze mediatike, përmirësimin e performancave të Qeverisë, ndryshime urgjente lidhur me prioritetet për të siguruar të drejtat profesionale të gazetarëve dhe punonjësve të mediave.

LARG REFORMAVE SERIOZE TË MEDIAS

Sipas kreut të SHGM, Naser Selmani mesazhi më i rëndësishëm, i dërguar nga Komisioni Evropian nëpërmjet raportit më të fundit është tolerancë zero ndaj sulmeve fizike dhe verbale ndaj gazetarëve.



Pasi në vendet e lira dhe demokratike nuk ka vend për dhunë dhe shantazh ndaj gazetarëve, por edhe në rastet kur ndodh, institucionet duhet të kenë kapacitete për të kryer hetime efikase, për të identifikuar dhe ndëshkuar sulmuesit.

“Të gjithë pajtohen se ka progres krahasuar me vitin e kaluar, por jemi larg reformave serioze të medias. Mediat duhet të shërbejnë për mbrojtjen dhe zbatimin e vlerave demokratike dhe lirinë e shoqërisë. Nuk ka rregullator më të mirë për pushtetin sesa mediat, vetëm ato mund të parandalojnë autoritarizmin dhe tiraninë e një pushteti”, ka deklaruar Selmani në konferencën e organizuar me rastin e Ditës Botërore të Lirisë së Mediave.

Me rastin e kësaj dite kryemini-

stri Zoran Zaev ka theksuar se mediat duhet të punojnë të jashtë çdo lloj presioni, të informojnë opinionin në kohë reale dhe pa censurë.

“Pikërisht 3 Majin ne e shënojmë si ditën kur festohen principet fundamentale të këtij profesioni, por kjo ditë na shërben edhe për të mos harruar që ta humbasim këtë liri. Por edhe për të përkujtuar të gjithë ato gazetarë që dhanë jetën në krye të detyrës, duke luftuar që e vërteta të dalë në shesh”, ka thënë kryeministri.

Ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Robert Popovski, ka premtuar për një erë reformash të mëdha në skenën mediatike. Sipas tij kjo qeveri nuk do të lejojë kërcënimet dhe shantazhimet ndaj mediave dhe gazetarëve, ndërsa nuk duhet tole-

ruar zbatimin e censurës në asnjë lloj rasti. Edhe ministri i Shoqërisë Informatike, Damjan Mançevski me rastin e kësaj dite ka thënë se mediat e lira, të sigurta, ta pavarura dhe të përgjegjshme janë baza për zhvillimin e një shoqërie demokratike. Sipas tij, mediat janë një alat i rëndësishëm për ndërtimin e një shoqërie të përparuar, për avancimin ekonomik dhe social dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

NUK KA MEDIA TË LIRA ME GAZETARË TË FRIKËSUAR

Gazetaria është profesion që lufton për të drejtën kushtetuese të çdo qytetari për të disponuar me fakte të cilave mund t’iu besojë, të marrë informacionet e duhura në raportet e shkruara me vëmendje

OSMANI: LIRIA E MEDIAVE DUHET KURUAR VAZHDIMISHT

Zëvendëskryeministri Bujar Osmani gjatë një takimi me përfaqësues të mediave ka kujtuar se mediat nuk përbëjnë një sistem të izoluar dhe se liria e medias ndërtohet përmes ndërtimit të institucioneve të qëndrueshme, sundimit të ligjit, Qeverisë dhe institucioneve shtetërore transparente, konkurrencës, respektimit të rregullave. “Pikërisht për këtë arsye liria e



medias paraqet pasqyrë të qartë për gjendjen në shoqëri, për shkallën e zhvillimit demokratik, në përgjithësi shkallën e zhvillimit civilizues. Shpresoj se ky shoqërim mund të rritet edhe në traditë të cilën çdo vit do ta shënojmë këtë ditë, si një kujtesë se liria e medias duhet vazhdimisht të trajtohet, dhe përfitimi i saj, të shënohet ashtu siç duhet”, ka thënë Osmani.

dhe saktësi. Me rastin e Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit 3 Majit, Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Medial sugjeron për ndryshimin urgjent të prioritetëve dhe fokusim në të drejtat e punës dhe ato profesionale të gazetarëve dhe punonjësve medial.

Nga Sindikata, thonë se për disa vite me radhë në raportet për lirinë e mediave në Maqedoni, duke përfshirë edhe të fundit të Reporterëve pa Kufij, konstatohet se gazetarët paguhet keq dhe punojnë në kushte të pasigurta, gjegjësisht pagat në media janë nën 300 euro, që është larg nën nivelin e pagës mesatare në Maqedoni. “Në mënyrë shitesë më shumë se gjysma ose rreth 54 për qind e punonjësve medial dhe gazetarëve nuk janë të punësuar në mënyrë të përhershme, gjegjësisht nuk kanë kontrata të përhershme, ndërsa situata është veçanërisht dramatike në sferën digjitale ku po zhvendoset gazetaria e deritanishme tradicionale e shtypit. Marrëveshjet kolektive janë një emër i shpikur, për to pak janë të njoftuar edhe punëtorët edhe punëdhënësit, ndërsa bëhet fjalë për dokument që i rregullon të gjitha çështjet jetësore me funksionimin e mediave”, thuhet në kumtesën e SPGM. Është koha e duhur, thotë SPGM, që çështja e kushteve të punës dhe të profesionit të gazetarëve dhe punonjësve medial të vihet në qendër të debatit rreth asaj se çfarë lloj mediash duam në Maqedoni. Sipas tyre, kërcënimet prej lajmeve të rrejtshme para se cilës është vendosur gazetaria cilësore në vendin tonë e cila u bë sinonim për “lajme të rrejtshme” nuk mund të fitohet me forcë punëtore të paguar dobët, e të patrajtuar mjaftueshëm, e cila nuk është e mbrojtur me marrëveshje kolektive.

AMEJKL KËRKON NGA BRUKSELI PËRQËNDRIM MË TË MADH NDAJ LIRISË SË MEDIAVE

Podgoricë, 3 maj - Asociacioni i Mediave të Europës Juglindore i ka dërguar sot, me rastin e Ditës botërore të lirisë së mediave, letër të hapur, nënshkruar nga drejtori ekzekutiv Vuk Maraš, kryetari të Këshillit të Europës, Donald Trusk, kryetari të Parlamentit Evropian, Antonio Tajani dhe atij të Komisionit Evropian, Zhan Klod Juknker, të cilëve iu kërkohet ngritjen e një Trupi ad-hoc punues ekspertësh në Bashkimin Evropian që në mënyrë të vazhdueshme do të ndiqte gjendjen e lirisë së mediave në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Një trupë e tillë punuese, formimin e të cilit e propozon Asociacioni i Mediave të Europës Juglindore, do të ndiqte segmentet



qenësore në fushën e lirisë së mediave – ndriçimin e rasteve të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve, presionet e ndryshme politike e administrative mbi mediat si dhe ndihmën shtetërore përmes financimit të hapur dhe të fshehtë të mediave të caktuara private nga fondet publike, që e cënojnë tregun mediatik dhe

krijojnë kushte të pavolitshme për punën e mediave të pavarura dhe profesionale.

Për shkak të faktit se vetë Bashkimi Evropian ka identifikuar mangësi të shumta në fushën e lirisë së mediave në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, si një prej problemeve thelbësore, Asociacioni i Mediave të Europës Ju-

glindore i është drejtuar drejtuesve të tri institucioneve të rëndësishme – Këshillit të Europës, Parlamentit Evropian dhe Komisionit Evropian, nga të cilët ka kërkuar ndërmarrjen e hapave konkret në nivel të BE-së.

Ua kemi bërë të ditur njerëzve kryesor të BE-së, se raportet e tyre mbi përparimin e vendeve të rajonit, janë të një rëndësie të posaçme për vlerësimin e progresit të të gjitha vendeve në fushën e lirisë së mediave. Megjithatë konsiderojmë se duhet shkruar edhe një hap para, duke ngritur trupë profesionale që do të ndiqte në mënyrë të vazhdueshme situatën në fushën e lirisë së mediave në Ballkanin Perëndimor, e që do të ishte në gjendje të reagoje sa

herë që do të paraqitej rasti, pa patur nevojë të pritët që të publikohen raporte formale e joformale.

Duam të besojmë që zotërinjtë Tusk, Tajani dhe Junker do të kenë mirëkuptim për këtë iniciativë të Asociacionit të Mediave të Europës Juglindore dhe se personalisht do të angazhohen për forcimin edhe më të madh të kornizave institucionale për monitorimin e lirisë së mediave në EJT dhe në këtë mënyrë do të ndihmojnë që në të gjitha vendet e rajonit të krijohen kushtet për punë të papengueshme të mediave të lira, të pavarura dhe profesionale, thuhet midis tjerash në letrën e Asociacionit të Mediave të Europës Juglindore. /Koha.mk

TRANSPARENCA FINANCIARE NË ARSIMIN E MESËM

TENDERËT SI "OAZË" SHPENZIMESH

Thujse gjysma e shpenzimeve për arsimin e mesëm realizohen përmes tenderëve të kategorisë deri 5.000 euro. Mirëpo, pjesa më e madhe e tenderëve në fjalë kanë vetëm një ofertues. Një studim rasti tregon se në 739 raste (procedura tenderimi) është paraqitur vetëm një operator ekonomik (pra ofertues), në 670 raste janë paraqitur vetëm dy dhe në 396 raste janë paraqitur vetëm tre ofertues. Studimi ka analizë 3.343 marrëveshje të arritura me tenderim në periudhën 2013-2016



shumë se 20.000 euro (për gjësende dhe shërbime) dhe deri 50.000 euro (për punime). Mirëpo, pjesa më e madhe e shpenzimeve të realizuara me tenderë deri në 5.000 kanë pasur vetëm një ofertues. Konkretisht, studimi tregon se për shpenzimet e kësaj kategorie në 739 raste (procedura tenderimi) është paraqitur vetëm një operator ekonomik (pra ofertues), në 670 raste janë paraqitur vetëm dy dhe vetëm në 396 raste janë paraqitur tre ofertues.

Deri te këto të dhëna ka arritur studimi "Si shpenzohen paratë e shkollimit të mesëm", realizuar nga Instituti i Kërkimeve Strategjike dhe Edukimit, në Shkup (IKSE) në kuadër të projektit "Platforma mediale për qasje" e zbatuar nga Organizata Joqeveritare "Most" dhe i financuar nga Unioni Evropian. Studimi, që kap periudhën e viteve 2013-2016 ka për qëllim të nxit interesin publik dhe të palëve të interesit për çështjet e transparencës dhe qasjes deri te të dhënat dhe indikatorët relevant sa i përket shpenzimeve në arsimin e mesëm përmes furnizimeve publike. Autorët e kë-

tij studimi vërejnë se njësitë e vetëqeverisjes lokale kalojnë përmes shumë peripecive dhe sfidave kur është në pyetje siguri i mjeteve financiare për veprimtari publike, sikurse është në rastin konkret edhe çështja e financimit të arsimin të mesëm. Sakaq, emergjenca për realizimin e studimit, sipas tyre, shpjegohet me faktin se një prej çështjeve kryesore që trajtohet në studim ka të bëjë me sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies se si shpenzohen të ardhurat publike në arsimin e mesëm.

"Periudhën e kaluar, ishim dëshmitarë të këtyre rasteve, sidomos të pjesës së financimit me transportimin e nxënësve. Për këtë mendojmë se bëhet fjalë për çështje aktuale dhe emergjente, për çka pikërisht kjo fushatë do të kontribuon që gjërat të bëhen të qarta dhe aktuale", vërejnë autorët e studimit "Si shpenzohen paratë e shkollimit të mesëm". Sikurse dihet, nga viti 2017 kur arsimi i mesëm në Maqedoni u bë i obligueshëm për të gjithë. Me këtë u ritën edhe shpenzimet në këtë sferë, pasi është rritur edhe numri i nxënësve të

përfshirë në këtë nivel shkollimi. Në vitin shkollor 2016/2017, evidencat tregojnë 103 shkolla të mesme prej të cilave 89 me karakter publik dhe 14 me karakter shtetëror. Në total numri i nxënësve të regjistruar për katër vite shkoj në 70.139, ndërsa 7.021 i profesorëve të angazhuar në mësimdhënie. Përmes furnizimeve publike, për vitin kalendarik 2016, thuhet se janë shpenzuar 220.837.775 denarë, përderisa shpenzimet dedikuar arsimit shkojnë në 4 për qind e BPV. Në periudhën nga 1 korriku i vitit 2013 deri në 30 qershor të 2017-ës shuma e përgjithshme e shpenzuar nga shkollat e mesme publike përmes furnizimeve publike është 696.248.519 denarë. Prej tyre, 49.6 për qind (345.321.763 denarë) në kategorinë e ofertës deri 5.000 euro, ndërsa

46.4 për qind (322.792.022 denarë) për oferta në vlerën deri 20.000 euro, respektivisht 50.000 euro.

Për periudhën që ishte në fokusin e këtij studimi, janë përfshirë në analizë 3.343 marrëveshje për furnizime publike nga bartës të ndryshëm. Prej tyre 2.435 Marrëveshje të realizuara nga 96 shkollave janë në kategorinë e furnizimeve deri në 5.000 euro, 781 marrëveshje të 70 shkollave janë në kategorinë e shërbimeve dhe gjësende) dhe 50.000 euro (për punime). Ndërkaq, 127 marrëveshje kanë arritur për shërbime deri 20.000 euro sipas Urdhërësës për caktimin e shërbimeve që janë lëndë e marrëveshjeve për furnizime publike.

Nga gushti roaming më i lirë për Maqedoninë

Sofje, 3 maj - Çmimet e roamingut për Maqedoninë dhe Serbinë do të zvogëlohen në muajin gusht, ndërsa vendimi për atë do të silltet gjatë kryesimit bullgar me BE-në, deklaroi ministri bullgar i Transportit, Ivajlo Moskovski. Ai pret se shpejtë lirim të roamingut edhe për vendet tjera të Ballkanit Perëndimor. Moskovski informon se operatorët celular të Bullgarisë, Maqedonisë dhe Serbisë tashmë në mënyrë aktive po punojnë në nënshkrimin e marrëveshjes. "Aktivitetet rrjedhin në koordinim me eurokomisaren bullgare Marija Gabriel e cila ishte iniciatore për çmime më të lira të roamingut në rajon", thekson ministri bullgar i Transportit. Në shkurt të këtij viti ishte nënshkruar memorandum ndërqeveritar për zvogëlimin e çmimeve të roamingut për shtetet e Ballkanit Perëndimor, që hapi mundësi operatorët celularë të fillojnë biseda për arritje të marrëveshjes së ndërsjelltë rreth zvogëlimit të çmimeve. Çmime më të ulëta për bisedat telefonike mes shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së është një nga prioritetet e kryesimit bullgar me Unionin.

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 3 maj - Pjesa më e madhe e shpenzimeve në arsimin e mesëm në Maqedoni, realizohen përmes ofertave publike (tenderëve) që nuk tejkalojnë shumën prej 5 mijë euro. Konkretisht shpenzimet e realizuara në këtë mënyrë, për periudhën e viteve 2013-2016, kapin vlerën e 345.321.763 denarëve, apo 49.6 për qind të shumës së përgjithshme të të hollave që janë shpenzuar në shkollat e mesme publike brenda këtij harku kohor. Shuma tjetër, pra 322.792.022 denarë apo 46.4 për qind është realizuar përmes tenderëve me jo më

DHUROHEN PAISJE MEDICINALE NË SPITALIN E ÇAIRIT

Shkup, 3 maj - Fondacioni "HOPE" ka dhuruar pajisje medicinale në Spitalin Special për obstretikë gjinekologji "Nëna Tereza", në Çair. Ky fondacion do të vazhdojë kontributin edhe në klinikën e Tetovës dhe spitalin e Kumanovës me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj pacientëve.

Këtë e bëri të ditur ministri Shëndetësisë Venko Filipçe.

"Ky donacion është shumë i rëndësishëm, që ka për qëllim të rritë kualitetin në shërbimet mjekësore. Kjo është vetëm një pjesë e projektit, në vazhdim do të ketë donacione edhe në klinikën e Tetovës dhe në spitalin e Kumanovës. Ky donacion përfshin CDG - aparate, eho aparate, ku edhe janë përmbushur të gjitha ambulanet në këtë spital dhe veçanërisht aparate për fëmijët e sapolindur", tha ministri Filipçe.

Ai shtoi se në mungesë të kua-



drit cilësor janë përfshirë në trajnim shumë mjekë, që zhvillojnë ushtrimet në institutin e gjinekologjisë në Londër.

Sa i përket vdekshmërisë së foshnjave, ministri Filipçe njoftoi se është përgaditur plan aksional për parandalimin e kesaj dukurie.

"Ne kemi bërë një plan aksional, ku është bërë kontroll në të gjitha repartet e lindjes në vend, bashkërisht me ekipe ekspertësh,

ku edhe punohet në atë aspekt, për punësimin e kuadrove të reja në çdo profil, ku duhet të punohet në çdo klinikë gjinekologjike, me ç' rast do të punësohen specialistë të gjinekologjisë, anestologë, dhe nga sfera e neotologjisë", tha ministri Filipçe.

Duke folur për gjendjen në banjën e Katllanovës, ministri Filipçe paralajmëroi se në të gjitha banjat do të ketë kontrolle. Ai bëri

të ditur se ajo çka është vërejtur në këtë banjë do të sanksionohet, duke e ndaluar veprimtarinë shëndetësore.

"Inspektorati Sanitar Shtetëror dhe Shëndetësor ka lëshuar një ndalim për kryerjen e

Veprimtarisë së saj dhe bordi drejtues është dërguar në shërbimet e ministrisë me qëllim që ata të përfundojnë rrugën e rregullt në drejtim të regjistrimit sipas kriterëve tona për regjistrimin e një institucioni mjekësor", thekson Filipçe, pasi vizitoi Spitalin Special për obstretikë gjinekologji "Nëna Tereza", në Çair

Bashkim Ismaili, drejtori i Spitalit të Gjinekologjisë së Çairit, tha se dhurimi i pajisjeve do të ndihmojë në procesin e punës.

"Me pranimin e pajisjeve do të rritet kualiteti i punës dhe shërbimeve mjekësore si dhe në çdo aspekt", tha Ismaili. / D.K.

Shkup, 11 aksidente për 24 orë

Shkup, 3 maj - Një motoçiklist është lënduar më rëndë në një nga gjithsej 11 fatkeqësi që ndodhën gjatë ditës së djeshme në rajonin e SPB Shkup. Në gjatë fatkeqësi më lehtë janë lënduar shtatë persona, ndërsa në katër është shkaktuar dëm material. Nga MPB informojnë se dje policia rrugore ka zbuluar dje sanksionuar një numër më të madh kundërvajtjesh.

Tetëdhjetë e dy vozitës kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se e lejuara, shtatë vozitës kanë kaluar në udhëkryq në dritë të gjelbër, tre vozitës për reshtim jo të rregullt, si dhe katër vozitës mosshfrytëzim të kapelës mbrojtëse. Janë sanksionuar edhe tre këmbësorë të cilët kanë kaluar jashtë kalimit për këmbësorë dhe dy këmbësorë të cilët kanë kaluar rrugën në dritë të kuqe të semaforit. Nga komunikacioni janë përjashtuar dy vozitës të cilët kanë drejtuar automjetin nën ndikim të alkoolit, 11 vozitës para se të përfitohen me të drejtën e vozitjes dhe katër vozitës fillestarë, si dhe 15 automjete të paregjistruara. Janë hasur 100 automjete të parkuara në mënyrë të parregullt. Me ndihmën e automjetit të posaçëm, janë mënjanuar 68 automjete.

Mosazhurnimi i të dhënave për shumata e kontratave të nënshkuara midis pushtetit dhe partnerit privat, kohëzgjatja e projektit, si dhe mungesa e metodologjisë transparente që do të përcaktojë se sa projekti është i suksesshëm, janë shkak pse se partneriteti privato-publik shumë pak zbatohet në Maqedoni

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 3 maj - Ideja e partneritetit privato-publik, në shikim të parë, është shumë e thjeshtë. Sektori privat do të investon në projekte të ndryshme në vend të shtetit, me të drejtën që të ekonomizojë me investimin për një periudhë të caktuar kohore. Pas përfundimit të kësaj periudhe, projekti i kthehet në pronësi të shtetit. Shtrohet çështja nëse ideja është aq e thjeshtë, se çka presin shtetet në zhvillim me infrastrukturë të dobët që të zgjedhin problemet në këtë mënyrë. Ekspertët ekonomik thonë se koncesionet nuk janë mënyrë aspak e lehtë, dhe jo pa rrezik për realizimin e projekteve investuese. Në teori, duhet shumë tërheqëse që komunat apo pushteti qendror në mungesë të të hollave për investime ti ofrojë sektorit privat të ketë përfitim nga projekte të tilla, por megjithatë në praktikë në Maqedoni, por edhe shtetet e rajonit paraqiten problem të shumta dhe përfitime më të vogla nga secë pritit.

Analiza e partneritetit privato-publik në Maqedoni e shoqatës jo-

PARTNERITETI PRIVATO-PUBLIK NË MAQEDONI

ZBATUESHMËRIA PA EFEKTET E PROJEKTEVE



qeveritare "Analitika", tregon se partneriteti private publik shumë pak zbatohet në Maqedoni. Shkaqet sipas tyre janë në mosazhurnimin e të dhënave për shumata e kontratave të nënshkuara midis pushtetit dhe partnerit privat, kohëzgjatja e projektit, si dhe mungesa e metodologjisë transparente që do të përcaktojë se sa projekti është i suksesshëm. Mangësi të ngjashme ka konstatuar edhe Enti Shtetëror për Revizion, por megjithatë vërejtjet dhe rekomandimet e tyre kanë mbetur vetëm në letër.

"Revizioni shtetëror ka konstatuar se objekte të caktuara të financuara me partneritet privat-publik janë tërësisht jopropitabile, pra nuk sjellin fitim as për qytetarët dhe as për komunat që kanë nënshkruar marrëveshjet. Çdo herë ka edhe përjashtim nga marrëveshjet, ndër-

PROJEKTE JOPROFITABE

Revizioni shtetëror ka konstatuar se objekte të caktuara të financuara me partneritet privat-publik janë tërësisht jopropitabile, pra nuk sjellin fitim as për qytetarët dhe as për komunat që kanë nënshkruar marrëveshjet. Çdo herë ka edhe përjashtim nga marrëveshjet, ndërsa për shkak të mungesës së llogaridhënies dhe publikimit të marrëveshjeve të vërteta që kanë nënshkruar pushtetit dhe partneri privat, nuk mund të shikohet as efekti i projekteve të tilla.

sa për shkak të mungesës së llogaridhënies dhe publikimit të marrëveshjeve të vërteta që kanë nënshkruar pushtetit dhe partneri privat, nuk mund të shikohet as efekti i projekteve të tilla", thotë Tamara Mijoviq nga Analitika.

Nga ana tjetër, nga Analitika thonë se financimi i projekteve të partneritetit privat-publik në Maqedoni duhet të realizohet me kujdes për shkak se në parim paraqet edhe rritjen e borxhit në nivel lokal

dhe shtetëror. Gjithashtu projekte të tilla janë komplekse për shkak të shumës së madhe të parave që qarkullohen. Rekomandohet edhe revidimi i legjislacionit me qëllim që të merret parasysh interesimi jo vetëm i partnerit privat, por edhe interesi publik.

"Ekziston rreziku nga korrupsioni duke marrë parasysh fushat që përfshihen me këto projekte, lartësia e marrëveshjeve si dhe periudha e gjatë e marrëveshjeve, megjithatë

transparenca është parakusht për pengimin e korrupsionit", thotë Tamara Spasova nga Analitika.

Në ndërkohë, eksperti i partneritetit private-publik, Sasha Maksimovski thotë se në Maqedoni ekziston potencial i madh për realizimin e projekteve nga pushteti lokal deri në pushtetin qendror, por megjithatë rezultatet e deritanishme janë të dobëta.

"Në të ardhmen do të duhet të revidohet koncepti i legjislacionit duke vendosur një sistem më efikas institucional të menaxhimit të këtyre projekteve. Pra, nevojitet përgatitja adekuate dhe ndjekja e realizimit të projekteve të partneritetit private-publik duke marrë parasysh qëllimet më të gjëra ekonomike, sociale dhe ekologjike si dhe përfitimet për partnerin publik" thekson Maksimovski.

Në ndërkohë raporti i Analitika thotë se shembuj të projekteve të suksesshme të partneritetit private publik në nivel lokal janë komunat Çair, Kavadar dhe Makedonski Brod për ndriçimin rrugor, Komuna e Ohrit-Tregu i gjelbër, Komuna e Aerodromit-Salla Sportive, komuna e Gjoçe Petrov-grumbullimi i mbeturinave, Komuna e Manastirit-Parkingu, Komuna e Kriva Palankës - ndërtesa komunale si dhe disa marrëveshje për hidro-elektrana në nivel lokal. Në nivel qendror, aeroportet në Shkup dhe Ohër vlerësohen si projekte të suksesshme. Shembuj të realizimit të pasuksesshëm janë ndriçimi rrugor në Shën Nikollë për shkak se komuna nuk ka paguar obligimet ndaj partnerit privat. Ekzistojnë edhe dy shembuj të tenderëve të filluar dhe të papërfunduar si koncesioni për projektin e transportit të udhëtarëve në Shkup me tramvaj në formë të koncesioni si rrjedhojë e mungesës së ofertuesve. Nuk kishte interesim as për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e parkut zbatimës në Shkup.

Me ligj të ri kundër anarkisë farmaceutike

Barnat të cilat priten të vijnë përmes importit paralel, domosdo të kenë dy certifikata - një certifikatë nga prodhuesi dhe tjetra nga laboratoriu vendor, si garanci për kualitetin e barërave

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 3 maj - Siguria e cilësisë së medikamenteve dhe efikasiteti, mënyra dhe procedurat për prodhimin e tyre, ekzaminimi, vendosja në treg, qarkullimi, çmimi, kontrolli i cilësisë, reklamimi dhe inspektimi, janë segmente që i rregullon Ligji i ri për medikamente dhe pajisjet medicinale, në Maqedoni, i cili është futur në procedurë parlamentare dhe fillimisht është debatuar në Komisionin e shëndetësi-

së. Ky ligj gjithashtu përcakton edhe statusin e barnave, substancave psikotropike dhe pararendësitë e nevojshëm për prodhimin e ilaçeve ose pajisjeve medicinale nëse nuk rregullohet me ligj tjetër.

Ky ligj duhet të parashikojë ndarjen e drejtë të certifikatave, që të garantojë barna cilësore, ndërkohë që kërkesës së komisionit për shëndetësi, deputetët i kanë dhënë dritë jeshile, me çka barnat të cilat priten të vijnë përmes importit paralel, domosdo të kenë dy certifikata. Një certifikatë nga prodhuesi dhe tjetra nga laboratoriu vendor, si garanci për kualitetin e barërave.

Nga Agjencia e barnave dhe pajisjeve mjekësore thonë se siguri i certifikatave do të mundësojë që të kemi barna më cilësore. Dhe se, shumë nga këto produkte vijnë nga shtetet e jashtme dhe përmes certifikatës siguria do të rritet të përdoruesit e barnave.

"Përqindje e madhe e ilaçeve nga importi paralel vijnë nga shtete me të cilat ne nuk kemi rregullator të harmonizuar dhe përmes këtyre ndryshimeve, përmes certifikatave që do të jepën drejtpërdrejtë nga prodhuesit, do ta garantohet kualiteti i ilaçeve", deklaroi Robert Bekirovski, Drejtor i Agjencisë së Barnave dhe Mjeteve mjekësore.

Për dhënien e certifikatave, shumë mjekë, por edhe deputetë, ngrejnë dilemën se do të veçohen disa kompani që importojnë barna. Sipas tyre, monopoli do të përqendrojë prodhimin dhe kapitalin te një grup pronarësh që zotërojnë tregun. Në këtë rast importuesit në Maqedoni do ta kenë vështirë të sigurojnë certifikatën, sepse ato nuk janë për përdorim me shumicë. Për këtë ministri i Shëndetësisë Venko Filipçe ka thënë se ligji garanton transparencë në ndarjen e certifikatave, kurse Agjencia e barnave



do të garantojë për furnizim me barna kualitative.

"Ai dokument nuk është e drejtë e klasifikuar, ai dokument i bashkëngjitet serisë së ilaçit. Prodhuesi është i detyruar ta jep atë. Të gjithë kompanitë e mëdha importojnë ilaçe edhe përmes importit të rregullt dhe atij paralel. Përse për importin e rregullt të kenë certifikatë, dhe për paralelin jo. Kjo hap dyshim, jo ndryshimet në këtë ligj. Me këtë, kriteret bëhen më të rrepta", deklaroi ministri i shëndetësisë, Venko Filipçe.

Ndryshe, procedura e deritanishme ka dëshmuar se një sasi e

barnave të importuara kanë cilësi të dyshimtë dhe kanë patur efekte të padëshiruara te pacientët. Ndërkohë që çështja e importit paralel është bërë lëndë hetimore në prokurori, pas kontrollit të realizuar dhe tërheqjes së dy ilaçeve nga tregu. Ilaçet e tërhequra ishin për sëmundje të rralla dhe për sëmundje malinje. Shitësit e tyre morën vetëm padi për kundërvajtje. Rishikimi i ligjit për ilaçe dhe pajisje mjekësore bëhet me qëllim të shtrëngimit të procedurave për siguri dhe cilësi të ilaçeve nga importi paralel, që pritet të miratohet së shpejti në Kuvend.

Në bazë të nenit 135 paragrafi 1 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/16, 127/16), dhe nenit 34, paragrafi 2 i Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Lajmëtari universitar nr. 274/13 – teksti i pastruar), Fakulteti matematiko-naturor në Shkup, shpall

KONKURS për zgjedhje të titujve titullar

INSTITUTI PËR BIOLOGJI

1. Zgjedhje të një docenti titullar për grupin e lëndëve nga fusha *biologji*, sfera mësimore-shkencore *fiziologjia (fiziologjia aplikative)* dhe fusha *biokimi*, sfera mësimore-shkencore *enzimat (enzimologjia)*.

Afati për zgjedhje është për kohë prej pesë vjet.

INSTITUTI PËR ETNOLOGJI DHE ANTROPOLOGJI

1. Zgjedhje të një docenti titullar për grupin e lëndëve nga sfera mësimore-shkencore *antropologjia kulturore, antropologjia sociale dhe antropologjia aplikative*.

Afati për zgjedhje është për kohë prej pesë vjet.

2. Zgjedhje të një docenti titullar për grupin e lëndëve nga sfera mësimore-shkencore *etnogeneza, kultura materiale dhe teoria dhe historia e civilizimit*.

Afati për zgjedhje është për kohë prej pesë vjet.

Kushtet: Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/16, 127/16), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistent-doktorues të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Lajmëtari universitar nr. 274/2013 tekst i pastruar) si dhe akteve të tjera të Universitetit dhe Fakultetit.

Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit.

Procedura pas konkursit mund të zgjatë më së shumti gjashtë muaj.

Në Arkivin e Fakultetit kandidatët duhet të dorëzojnë: fletëparaqitje për pjesëmarrje në konkurs, dokumentet e nevojshme për shkallën e arsimit (një ekzemplar origjinal dhe tre kopje të vërtetuara në noter), vërtetim për njohje të gjuhës së huaj (në katër kopje), biografi të shkurtër (në katër kopje), formular të plotësuar ndaj raportit për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencore dhe titujt mësimor-profesional (merrret në fakultet), certifikatë të shtetësisë (në katër kopje), dëshmi se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe deklaratë për përbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë procesit të vendimmarrjes.

Për informata të tjera në lidhje me Konkursin kandidatët mund të drejtohen në Sekretariatën e Fakultetit matematiko-naturor në Shkup.

Dokumentet të dorëzohen në ndërtesën e Fakultetit Matematiko-Naturor në Shkup, rr "Arhimedova" nr. 3, 1000 Shkup.

UNIVERSITETI "SHËN KIRILI DHE METODI"- SHKUP
FAKULTETI MATEMATIKO-NATYROR - SHKUP

Në bazë të nenit 19-a të Ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 38/9664/18), si dhe Vendimit nr. 09-235/1 të datës 30.04.2018 për publikim të shpalljes publike për zgjedhje të drejtorit të Ndërmarrjes komunale KOMUNALEC Negotinë, Kryetari i Komunës së Negotinës publikon

KONKURS PUBLIK Për zgjedhje të drejtorit të NPK "KOMUNALEC" Negotinë

Publikohet konkurs publik për zgjedhje të drejtorit të Ndërmarrjes publike komunale KOMUNALEC Negotinë për periudhë të mandatit prej 4 (katër) vjet.

Kandidatët e konkursit krahas kushteve të përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Të jetë i moshës së rritur,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,

Duhet të përbushin edhe kushtet e posaçme në vijim të cilat janë të nevojshme për realizimin e punës:

- të ketë të arritur së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të arsimit,
- të ketë së paku pesë vjet përvojë pune,
- të posedojë një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht në vijim ose certifikatë për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet edhe atë: TOEFL IBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2, FCE (Cambridge English: First) – të dhënë, BULATS – së paku 60 pikë ose APTIS – së paku niveli B2.

Kandidatët e interesuar duhet të parashtrorjnë:

Fletëparaqitje (format i lirë) që duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin e kandidatit dhe emrin e dokumenteve të parashtruar. Të bashkëngjitur me fletëparaqitjen duhet të parashtrohet edhe dokumentacioni në vijim:

- Biografia e shkurtë e kandidatit
- Certifikata e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë
- Dëshmi për së paku 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë të VII/1 të arsimit sipëror;
- Certifikatë se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- Dëshmi për përvojën e punës. (pasqyrë ose historiat nga Fondi për sigurim pensional dhe invalidor ose Qendra për punësim dhe dëshmi tjera për përvojën e punës),
- Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se gjashtë muaj, e parashtruar vetëm kandidati i zgjedhur për drejtor, menjëherë pas zgjedhjes..
- Kandidati i zgjedhur për drejtor obligohet të përbushë kushtin për njohje të gjuhës angleze më së voni në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes së tij.
- Fletëparaqitjen së bashku me dokumentet e nevojshme parashtrohen personalisht në arkivin e Komunës së Negotinës ose përmes postës në adresën në vijim – Komuna e Negotinës, rr. "Aco Axhi Ilov" nr. 2, deri te Kryetari i Komunës së Negotinës me shenjë "Për konkurs publik për zgjedhje të drejtorit të Ndërmarrjes publike komunale KOMUNALEC Negotinë".
- Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve është 30 ditë pune, duke mos konsideruar ditën e publikimit të konkursit në shtypin ditor.
- Zgjedhjen e kandidatit, Kryetari do ta realizojë më së voni në afat prej 15 ditëve nga dita e parashtrimit të dokumenteve deri te Kryetari i komunës, nga ana e Komisionit për shqyrtim të dokumentacionit. Fletëparaqitja e dorëzuar pas afatit, jo e plotë dhe e parregulluar nuk do të merrret parasysh gjatë shqyrtimit.

KOMUNA E NEGOTINËS
Kryetari i Komunës,
Toni Dellkov

Në bazë të nenit 21 dhe 22 të Ligjit për punësuarve në sektorin publik dhe nenit 22 dhe 23 prej Ligjit të marrëdhënieve të punës, Agjencia e Punësimi të Republikës së Maqedonisë, boton

Shpallje

për punësim me kohë të caktuar deri me 31.12.2018

1. Për nevojat e themelimit të marrëdhënieve së punës për kohë të caktuar në Agjencinë e punësimi të Republikës së Maqedonisë për vendin e punës siç vijon:

1. Bashkëpunëtor shërbimeve për mbështetjen e punësimi në Agjencinë e Punësimi- Viniçë-(2) dy realizues;
Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Arsimin e lartë, përkatësisht të ketë së paku 180 kredit të arritura sipas ECTS-së ose të ketë mbaruar shkallën VII/1;
- Të ketë së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Të ketë njohje aktive të njërës prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 23.230,00 denarë

2. Bashkëpunëtor shërbimeve për mbështetjen e punësimi në Agjencinë e Punësimi – Resnjë -(1) një realizues;
Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Arsimin e lartë, përkatësisht të ketë së paku 180 kredit të arritura sipas ECTS-së ose të ketë mbaruar shkallën VII/1;
- Të ketë së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Të ketë njohje aktive të njërës prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 23.230,00 denarë

3. Referent për shërbime sportelike në Agjencinë e Punësimi të Republikës së Maqedonisë – Qendra e Punësimi në qytetin e Prilepit – (1) një realizues
Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Arsimin e lartë, përkatësisht të ketë së paku 180 kredit të arritura sipas ECTS-së ose të ketë mbaruar shkallën VII/1;
- Të ketë së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Të ketë njohje aktive të njërës prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 23.230,00 denarë

4. Referent për shërbime sportelike në Agjencinë e Punësimi të Republikës së Maqedonisë – Qendra e Punësimi në qytetin e Prilepit – (1) një realizues
Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Të ketë arsim të lartë ose të mesëm
- Të ketë së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Të ketë njohje aktive të njërës prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 14.900,00 denarë

5. Bashkëpunëtor për shërbime për orientacioni profesional- (1) një realizues, në Qendrën për Punësim në qytetin e Shkupit;
Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Arsim të lartë- Psikologji;

6. Bashkëpunëtor për shërbime për orientacioni profesional- (1) një realizues, në Qendrën për Punësim në qytetin e Shkupit;
Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Arsim të lartë- Psikologji;

Në bazë të nenit 155- b, 156, 157, 158, 159, 160, 164-b të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16, dhe 37/16), Pëlqimit për punësim nga Ministria e Financave nr. 18-7084/2 të datës 03.08.2017 dhe 18-4552/2 të datës 18.04.2018, Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 0401-859 të datës 02.05.201 U. D Drejtori medicinal i IPSH Klinika universitare për neurologji – Shkup publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të I (një) farmaceuti të diplomuar për kohë të pacaktuar

- IPSH Klinika universitare për neurologji – Shkup ka nevojë për punësim të:
 - (një) farmaceut të diplomuar për kohë të pacaktuar
- Kandidati duhet të përbushin **kushtet e përgjithshme** të parapara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore
 - të jetë shtetas i RM,
 - të jetë i moshës së rritur,
 - të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe
 - të mos i jetë shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj kandidatët duhet të përbushin e dhe **kushtet e posaçme** në vijim:
 - arsim të mbaruar sipëror me së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – Fakulteti i farmacisë
 - provim të dhënë profesional
 - licencë për punë
 - sukses të arritur mesatar prej të gjitha lëndëve nga të gjitha ciklet të studimeve universitare që ka mbaruar kandidati prej së paku tetë (në tekstin e mëtejshëm: sukcesi mesatar) dhe
 - në mënyrë aktive të njëh një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, gjermane ose frënge) të nivelit B2 sipas Kornizës së përbashkët referuese evropiane për mësim të gjuhëve, mësim dhe vlerësim (Common European Framework of Reference for Languages: Learning, Teaching, Assessment) (në tekstin e mëtejshëm: CEFR dhe të posedojë certifikatë të pranuar ndërkombëtarisht të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian të nivelit B2 të CEFR, gjegjësisht IELTS me 5-6 pikë, FCE, BEC, ILEC, IKFE, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 500 pikë, TOEFL CBT së paku 175 pikë ose TOEFL IBT së paku 60 pikë ose DELF, TCF, TEF, ose Goethe-Zertifikat, TestDaF.
 - me dhe pa përvojë pune.
 - Njohja e gjuhës së huaj nga pika 3 e kësaj shpallje publike, përveç certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave të përdorura ndërkombëtarisht, dëshmohet edhe me vërtetim për cikël të parë, të dytë ose të tretë të studimeve në një prej 200 fakulteteve më lartë të ranguar në Shanghai Ranking - ARWU (Academic Ranking of World Universities) të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane), për të cilat studime kandidatët posedon diplomë të nostrifikuar.
- Orari i punës është prej 40 orëve në javë dhe neto pagesë bazë:
 - është 38.392,00 denarë.
- Të bashkëngjitur me fletëparaqitjen kandidatët janë të obliguar që të parashtrorjnë dokumentet në vijim
 - fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
 - biografi të shkurtë (CV)
 - Diplomë me sukses mesatar
 - Njohja e gjuhës së huaj dëshmohet me dorëzimin e një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave të përdorura ndërkombëtarisht: BULATS, CAE, IELTS, FCE, BEK, PET, KET, ILEC, TOEFL PBT, TOEFL CBT, TOEFL IBT për gjuhën angleze, gjegjësisht DELF, DALF, TCF, TEF, BULATS për gjuhën frënge, gjegjësisht Goethe-Zertifikat, TestDaF dhe BULATS për gjuhën gjermane ose certifikatë tjetër të njohur ndërkombëtarisht të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian ose organizatave të tjera ndërkombëtare të nivelit B2 të Kornizës së përbashkët referuese evropiane për mësim të gjuhëve mësim dhe vlerësim (CEFR).
 - Kandidatët të cilët kanë mbaruar ciklin e parë, të dytë ose të tretë të studimeve nga sfera e medicinës në një prej 100 fakulteteve të mirë të ranguar në Shanghai Ranking-ARWU (Academic Ranking of World Universities) nuk kanë nevojë të përbushin kushtet e posaçme nga pika 3 e kësaj shpallje, as edhe për punësimin e tyre realizohet procedurë për selektim të kandidatit.
 - certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, original ose kopje të vërtetuar në noter
 - certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, original ose kopje të vërtetuar në noter
 - certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, në original ose kopje të vërtetuar në noter
 - certifikatë për fakultet të mbaruar të farmacisë, original ose kopje të vërtetuar në noter
 - certifikatë për provim të dhënë profesional, original ose kopje të vërtetuar në noter
 - licencë për punë, original ose kopje të vërtetuar në noter.
- Afati për paraqitjen në shpalljen publike është 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit.
- Dokumentacioni i vonuar, jo i plotë dhe i parregulluar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.
- Pas përzgjedhjes së realizuar të kandidatëve të paraqitur për farmaceut të diplomuar dhe teknolog radiologjik të cilët i përbushin kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore.
- Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e plotë të nevojshëm dhe telefoni për kontakt, të dorëzohen deri në IPSH Klinika universitare për neurologji – Shkup, rr. Vodnjanska nr. 17, përmes postës ose në arkivin e IPSH Klinika universitare për neurologji – Shkup, ndërsa me mbishkrim për Shpallje publike për punësim.

IPSH Klinika universitare për neurologji – Shkup
U. D Drejtori medicinal
D-r Ivan Barbov

“Në fillim të viteve 900, kush kalonte monopateve të ngushtë të Maqit në Shën Dhimitër Koronë do të ndeshte patjetër një udhëtar të veshur me tessa të vjetra e me një bastun në dorë. Ishte Jeronim De Rada i cili nëpërmjet kësaj rruge të rrepirë shkonte në Shën Dhimitër Koronë për të dhënë leksione shqip, i fishkëlluar nga era e ftohtë e dimrit dhe zhegu i verës. Qe pothuajse 90-të vjeçar. E megjithatë moshë e shkuar dhe brengat e mëdha në jetë nuk ia kishin shterur energjitë që të paktën tre herë në javë për disa vite rresht të përshkonte 5 milje në këmbë deri në 1903, vit ku ndahet nga jeta”. Nën tingujt e lehtë të një kënge arbëreshe, e imazhet e Shën Mitrit e Maqit dy fshatrave të njohura arbëreshe të Jugut të Italisë, nis rrëfimi në dokumentarin “Hieronymi, arbëreshi i Italisë”, realizuar nga gazetarja Beti Njuma, i cili pati premierën të martën në Muzeun Historik Kombëtar.

“Një dokumentar që lartëson figurën e një prej personaliteve të letrave shqipe”, u shpreh Dorian Koci drejtor i Muzeut Historik Kombëtar. Përmes një pune të thelluar Njuma na solli në këtë dokumentar anën tjetër të De Radës, duke e rindërtuar profilin e tij nga fëmijëria deri në orët e fundit të jetës. Studiuës të letërsisë arbëreshe e De Radës erdhën përmes një rrëfimi për ta bërë më të plotë këtë rrëfim që ishte i ndërtuar në anën tjetër përtej Adriatikut, nga aty ku De Rada imagjinonte atdheun e tij të dashur, Shqipërinë. De Rada lindi në një fshat afër Shën Mitër Koronës, në familjen e një prifti, e cila pati luhatje financiare. “Vetë De Rada pohon se vinte nga një familje fisnike. Në fakt



BETI NJUMA, SJELL JERONIM DE RADËN QË NUK NJOHIM

U Shfaq premierë në sallën UNESCO të Muzeut Historik Kombëtar “Hieronymi, Arbëreshi i Italisë”, një dokumentar që i kushtohet Jeronim De Radës, me autore gazetaren e mirënjohur Beti Njuma

kishte një stemë tek dera një lis me dy yje”, u shpreh studiuesja Klara Kodra. Sipas Francesko Altimarit De rada lindi në komunitetin më të vogël arbëresh, i cili sot nuk ka më shumë se 200 njerëz, ku ende sot flitet me aq dashuri për poetin. Për gazetaren Njuma e cila ka vizituar vendin e tij të lindjes, Maqi një fshat i skajshëm i provincës së Kozencës është mjedisi ku De Rada u lind dhe u rrit.

“Është mjedisi ku për 5 shekuj shqiptarët ruajtën të paprekur gjuhën dhe trashëgiminë e tyre kulturore e shpirtërore, duke krijuar kështu edhe në Itali atdheun e tyre të humbur. Maqi sot ngjan me një fshat të dhëne pas një harrese të përgjumur, që shprishet kur dikush feks nga rrugicat e ngushta apo nga një dere ndërsa pllakatet krenare të kujtojnë se ajo botë nuk është zh-

dukur, sepse zëdhënësi i saj, De Rada, i lindur në 1814 ende jeton në vetëdijen e çdo guri aty ku kanë lindur këngët e tij, në fshatin e humbur kodrinor të Kalabrisë”, thotë Beti Njuma. Duke folur për fshatin e lindjes së poetit, Moikom Zeqo shton se “Në kujtimet e tij thoshte që nuk kishte as xhandarë as gjykatës”.

“Unë jam marrë kohët e fundit me periudhën rinore që kaloi midis kolegjit të Shen Adrianit dhe Napolit dhe në ato dy tre vite 1883-1886 që është viti i botimit të Milosaos. Aty vatra deradiane dha zjarrin me te shenjte me te flakte sepse arriti te krijonte duke kapercyer edhe probleme e kompleksitete qe linden në atë moment kur përfaqësonte realitetin qe përfytyronte të kapërcente ato vështirësi qe nuk arrinte t'i kapte me leximin”, shprehet Matteo Mandala. Ndërsa Francesko Altima-

ri tregon se në të vërtetë karriera e De Rades nis si folklorist, shkruan Gazeta Shqip.

Dokumentari “Hieronymi, Arbëreshi i Italisë” erdhi për publikun me pamje ekskluzive, të operatorit Vladimir Grori, regjistruar në vendlindjen e poetit, fshatin e vogël Maki i Kozencës, fare pranë me Shënmitër Korona. Pjesë e dokumentarit, që vinn me trajtimin e jetës dhe veprës së themeluesit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, ishin dhe zëra të njohur të kulturës sonë si studiuesit: Matteo Mandala, Klara Kodra, Moikom Zeqo, Lili Sula, Francesco Altimari e Shaban Sinani.

Nëpërmjet tyre dhe të vetë naratorës Beti Njuma, brenda një kufiri kohor prej 60 minutash, u transmetua e plotë gjithçka mund të thuhej e të mbetej në kujtesë për një figurë të ndritur si ajo e Jeronim De Radës



Viti Mbarëkombëtar i Skënderbeut, i bën bashkë arkivat e Shqipërisë e Kosovës

Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave dhe Agjencia e Arkivave të Kosovës, po vijojnë bashkëpunimin e tyre, me qëllim unifikimin e praktikave arkivore në të gjitha viset shqiptare.

Më 9 qershor 2018, do të zhvillohet në Prishtinë, Konferenca e Dytë Mbarëkombëtare e Arkivistikës, që synon të kthehet në traditë, pas konferencës së parë mbarëkombëtare të zhvilluar vjet në Tiranë.

Qëllimi i kësaj konference është të mbledhë bashkë arkivistët e Shqipërisë dhe të Kosovës, arkivistët shqiptarë të viseve jashtë Shqipërisë, por që vepron në ndërshqiptarë, nga Maqedonia dhe Mali i Zi, si dhe të tjerë arkivistë që punojnë apo studiojnë në fushë të arkivistikës. Temat që propozohen për diskutim lidhen specifiki-sht me arkivistikën, por edhe me historinë e arkivave apo institucioneve arkivore në zonat shqipfolëse.

Veç arkivistëve të rrjeteve arkivore kombëtare, ftesa për pjesëmarrje u drejtohet të gjithë profileve të tjerë të arkivistëve, institucioneve që ruajnë apo atyre që ndërveprojnë me ruajtjen e kujtesës kolektive.

Viti Mbarëkombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu është një shans i artë për të gjithë arkivistët dhe historianët për të përfunduar praktikën profesionale në viset kombëtare. Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave u bën thirrje të gjithë studiuesve të bashkohen në këtë përpjekje për të trajtuar historinë kombëtare njëjtë-trajtshëmrisht pavarësisht kufijve politikë. /ATSH

“ZBULIMET” SERBO-RUSE

NË GAZIVODË, SHTRIHET QYTETËRIMI MESJETAR SERB

Në këtë gënjeshtrë të radhës, “ekspertëve” serbë ua janë bashkuar edhe rusët, ndërsa lajmi i parë për këtë u publikua në portalin rus ‘sputnjik’ që editohet serbisht. Këtë shkrim e përcjell edhe gazeta e Beogradit “veçernje novosti”. Ajo thotë se në Luginën e Kollashinit buzë Ibrit në Kosovë është ndërtuar Liqeni i Gazivodës i cili vazhdon të mbetet pikë kontestuese në bisedimet ndërmytet Serbisë e Kosovës.

Sipas këtij shkrimi, në ish-Jugosllavinë e atëherëshme që kishte cilësimin kushtetues edhe republikë socialiste federative, në fillimin e viteve të 70-ta të shekullit të shkuar, përkundër se dihej ç’ thesar kulture ruhej në atë vend, janë shpërngulur 14 fshatra serbe. Portalet serbe ankohen se sado që zyrtarët e Kosovës e dinin dhe dinë rëndësinë e këtij vendi, ekspertët serbë e aq më pak opinionin, nuk e dinë se çfarë, goja, fsheh thellësia e liqenit.

Ndërsa, “për ta dëshmuar” këtë rëndësi, në Serbi, një ekip serbo-rus ka filluar xhirimin e një filmi dokumentar me titullin „Gazivode,



putevima Jelene Anžujске” – Gazivoda, rrugëve të Elena Anžuines nga dr Dushan Jovoviq. „Për ikjen në Kosovë mjafton letërnjoftimi dhe dëshira për të vizituar diçka për të cilën flitet vazhdimisht. Këtë e po e bëjmë pak për revoltë pak për kryengritje. Kam mbledhur ekipin “diversant” kulmor të ekspertëve”, thotë Jovoviq i cili ndihmohet nga historia-nia Katarina Mitrovic e cila thekson se me film do të zbulohen shumë sekrete dhe “sa ishte mbi Lindjen e Perëndimin Serbia në shekujt 13 – 14” në këtë pjesë të Kosovës. Sipas Jovoviqit, “fundosja e trashëgimisë serbe është planifikuar gjatë dhe është bërë shumë shpejt”.

„Për më pak se gjashtë muaj u vendos të ndërtohet liqeni. Që të krijoheshin kushtet për fundosje, së pari u desh të dërgoheshin arkeologët në rajon. Duhej studiuar 25 kilometra. Ekipi përbëhej nga shqiptarë e serbë. U regjistruan 30 lokalitete. Pastaj përnjëherë gjysma e këtij dokumentacioni, ku ishin shënuar të gjitha gjetjet, u zhduk. Dhe u ndërtua liqeni e thesari mesjetar u harrua krejtësisht ose u fundos”, thotë Jovoviq, transmeton Koha.net.

Ai në vazhdim ka treguar për ndihmën që po merr nga rusët për këtë film: „Një ekip rus nga Shën Petërburgu, i përbërë nga 40 persona me katër furgonë dhe me paji-

sjet me vlerë 2.5 milionë euro, erdhi në Kosovë. Ky është projekti më i madh serbo-rus pas luftës në Kosovë. Liqeni është i thellë 110 metra dhe me skanuesit shumë seriozë rusë kemi punuar në dimension 3D. Kemi punuar me shumë ekipe të koordinuara dhe me arkeologë nënujorë. Përkundër kushteve të këqija atmosferike, menjëherë kemi ndër lidhje vëllazërore – ata u gëzuan më shumë se ne kur e gjetëm kishën e shekullit 13 të fundosur dhe Kullën e Kambanave 7 metra të lartë”. Sipas tij, projekti po punohet në faza, KFOR-i fluturon sipër, valët janë të mëdha, ndërsa shton se puna në këtë film do të zgjasë tri vjet, tek ankohet se vetëm „Elektroprivreda Srbije” i ka dhënë mjete për dy lente për kamerë pa të cilat, sipas tij, është i pamundur xhirimi. Se a do të mbetet ky film vetëm në domenin e filmave shkencorë-fantastikë ku ende nuk është provuar kinematografia serbe, apo në suazat e propagandës kundër Kosovës dhe gënjeshtrave të tjera në shërbim të Beogradit që e synon jo vetëm Gazivodën në Ko-

Turp për Bullgarinë, turp për BE



Nga
Alexander ANDREEV



Me pozicionin aktual në indeksin e Reporterëve pa Kufij, Bullgaria jo vetëm që zë vendin e fundit nga vendet e BE. Po të përjashtosh Rusinë, Bjellorusinë dhe Turqinë, Bullgaria madje mund të mburret për peizazhin mediatic më pak të lirë të të gjithë Evropës. Dhe pikërisht ky vend drejton fatet e BE. Kërkon që t'i afrojë me BE fqinjët e Ballkanit Perëndimor e t'u mësojë atyre standardet demokratike, vende të cilat në çështjet e lirisë mediatike ndodhen me kilometra përpara Bullgarisë! Ore në cilën botë po jetojmë?

Po, marrja e drejtimit të BE është një proces automatik. Përndryshe askush nuk do ta kishte zgjedhur vulnëtarisht Bullgarinë kryetare, aq më pak në kohët kur kryhen negociatat e Brexitit, kur caktohet kuadri i buxhetit 2021-2027 dhe kur duhet të kërkohen rrugëdalje nga kriza e refugjatëve. Por fakti që Brukseli, ashtu si edhe shumica e shteteve të BE drejtohet nga parti mes-i djathtë, të cilat ka vite që i injorojnë shkeljet në Bullgari, nuk është proces automatik.

Apo është? Partia GERB që qeveris prej vitit 2009 (me një ndërprerje të shkurtër) në Bullgari, në fakt një One-Man-Show e kryeministrit Boiko Borisov, është anëtare krenare e Partive Popullore Evropiane (PPE), të cilat kanë aktualisht shumicën në Parlamentin Evropian dhe në këtë mënyrë kanë të drejtën edhe të zgjedhin Presidentin e Komisionit Evropian. Por për shumicat e saj, PPE-së i duhen edhe politikanë të tillë të diskutueshëm si Viktor Orbani dhe Boiko Borisovi. Është i lig ai të cilit i vete mendja te një shprehje që i atribuohet ish-Presidentit të SHBA, Franklin D.Roosevelt: "He may be a son of a bitch, but he's our son of a

bitch". Bullgaria e Borisovit vërtet që kritikohet rregullisht ashpër për shkak të korrupsionit galopant dhe për shkak të drejtësisë së mangët - edhe nga radhët e PPE. Veçanërisht për këtë shkak ky vend së bashku me Rumaninë vazhdon të ndodhet nën vëzhgimin e Brukselit. Por kjo është e gjitha. Pasoja ose ndëshkim për shkak të mungesës së sundimit të ligjit deri tani nuk janë në rend të ditës. Edhe situata katastrofale mediatike gjithashtu nuk i intereson askujt, me përjashtim të disa organizatave joqeveritare si Reporterë pa

Kufi ose Freedom House.

Në Bullgari nuk ka censurë dhe kabineti nuk ushtron ndikim mbi mediet, pohojnë pa u lodhur pushtetarët. E parë në sipërfaqe, kjo është e saktë, prandaj partnerët e BE kanë mundësi të heshtin të lehtësuar për këtë temë. Dhe në vend të kësaj të brohorasin për Borisovin: për politikën e tij konsekuente proeuropiane, solidaritetin e tij në krizën e refugjatëve dhe për distancën e tij ndaj shteteve të Vishegradit.

Megjithatë ky vështrim sipërfaqësor të mashtron. Censurë direkte

Një listën e re të lirisë së shtypit të Reporterëve pa Kufi, Bullgaria zë vendin e 111. Rrethanat e turpshme në vend vërtet që janë të vetëshkaktuara, por BE është bashkëpërgjegjës



mund të mos ketë në Bullgari. "Por natyrisht ka fushata shpifjeje nga ana e shtetit dhe nga ana e qeverisë ka herë pas herë fushata njollosëse", thotë Drejtori Ekzekutiv i Reporterëve pa Kufi dhe njohësi i mirë i Bullgarisë, Christian Mihr. Por meqenëse tregu privat i reklamave është shumë i ngushtë, shumica e mediave varen nga reklamat e qeverisë ose të autoriteteve komunale, për të mbijetuar. Fushata imazhi për ministrinë, programet qeveritare ose projekte të BE janë bukë e përditshme për shumicën e redaksive. Me këtë instrument qeveria mund të drejtojë pa u vënë re nga opinionin në mënyrë shumë efikase. Bullgaria është vendi më i varfër dhe më i korruptuar i BE-ky konstatim tashmë i stërpërdorur shihet gati në çdo raport mediatic në fillim të presidencës bullgare të radhës të BE në 1 janar 2018. Tani kjo mund të zgjerohet me një superlativë tjetër: Bullgaria është definitivisht vendi mediatic më pak i lirë i BE. Shumë bullgarëve u vjen turp që jetojnë në një vend të tillë. Por edhe bashkësia e shteteve të BE në fakt duhet të ketë turp që ka toleruar kaq gjatë rrethana të tilla. Direkt para hundës së saj - në një shtet që aktualisht drejton bashkësinë e shteteve.

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delfev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtyp dhe distribuim: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 3 maj | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

“Perdja e re e hekurt” që po ndan kontinentin e Europës



Nga
Alfredo De GIROLAMO

Presidenti francez Emmanuel Macron sapo është kthyer nga udhëtimi i tij në Uashington, pasi publikisht shfaqiqi miqësinë me presidentin e SHBA-së. Shtrëngime duarsh me Trump, puthje dhe përfaqime. Megjithatë, pak ditë para kreu i Elysee nisi fushatën zgjedhore për zgjedhjet e ardhshme evropiane me një paralajmërim mjaft populist: “Ndaloni egoizmin kombëtar, përndryshe do të ketë luftë civile në Evropë”. Një deklaratë me ton zhurmues, një sfidë për aleancën e Vishegradit midis Hungarisë, Polonisë, Republikës Çeke dhe Sllovakisë: Perdja e re e hekurt po e ndan Europën. Një karrocë e dominuar nga qeveritë me devijime autoritare, raciste dhe ksenofobike.

Kryeministri i Republikës Çeke, miliarderi Andrej Babis, nuk fsheh qëndrimin e tij se preferon të jetë si një bankomat për arkat e BE-së dhe të mos hap kufirin për emigrantët. Në Varshavë, qeveria nacional-konservatore vlerëson demonstruesit nacionalistë që mbushin sheshet me “marshimin e madh të patriotëve”. Dhe në “zemrën e zezë” të Evropës, ata shikojnë fqinjët austriakë të krahut të djathtë të Heinz-Christian Strache dhe partisë gjermane AfD.

Në Hungari, Fidesz (partia e Viktor Orbán) arriti të merret dy të tretat e vendeve në zgjedhjet e fundit, numra me të cilët ai mund të llogarisë ndryshimin e Kushtetutës



Ndërkohë, brenda Evropës, çështje të tjera diplomatike gërshetohen në sipërfaqe. Negociatat për hyrjen e Turqisë mbeten të ngrira.

Përkundrazi, përparohet në zgjerimin e unionit me Serbinë dhe Malin e Zi, teksa ka vend për dyshime për Shqipërinë dhe Maqedoninë



Orbanit janë emigrantë, të akuzuar si pushtues që kërkojnë të fshijnë vlerat e krishtera. Dhe së fundi, modeli i urryer i Brukselit, ai i pluralizmit dhe demokracisë. Modeli i Orban është një udhëhe-

dhe të rregullojë llogaritë me opozitën, por jo vetëm. “Fitoj dhe kujdesem për armiqët”, tha Orban në prag të votimit. Efekti i parë i fitores dërrmuese është mbyllja e një gazete që nuk është në një linjë me qeverinë, e ndjekur nga “Stop Soros”, si edhe futja e legjislacionit që kufizon veprimtarinë e organizatave joqeveritare, duke filluar nga fushata për pranimin e emigrantëve të drejtuara nga George Soros, veprat filantropike të të cilit në mbarë botën shpesh akuzohen për sabotim dhe komplot për të përmbysur qeveritë e krahut të djathtë.

Përveç Sorosit, armiku tjetër i

qje që shqetëson dhe hap një debat brenda shtëpisë shumë delikate të Europës. Ka nga ata që besojnë se udhëheqësi i fuqishëm i maxhoranës dhe i erës populiste e vë në pozitë të vështirë Perëndimin, pasi mund të përipiqet të nisë një ofensivë politike në Bruksel, duke minuar centralizmin frankogjerman. “Është duke u bërë gjithnjë e më shumë ambicioz, argumenton Laurent Pech, një profesor i së Drejtës Evropiane në Universitetin e Middlesex dhe në Institutin Universitar European. Ai mendon se bota politike evropiane është e përgatitur mirë në ditët e sotme për të ndjekur idetë e tij”

Kambanat e alarmit bien edhe në periferitë tona. Nga sondazhet hungareze nuk bën përshtypje vetëm çështja e Orban, por është edhe partia ultra e djathtë e Jobbik, një lëvizje neonaziste e cila u rendit në vend të dytë me rreth 20 për qind të votave. Respekti për rregullat që Brukseli imponon, përcakton një dënim të fortë ndaj atyre që nuk i respektojnë, i cili mund të marrë formën e nisjes së një procedure. Kjo është metoda e parashikuar në përputhje me nenin 7 të Traktatit të BE-së, i cili lidhet me detyrimin për të respektuar të drejtat e njeriut. Edhe familja e popullit evropian, shtëpia e Orbanit dhe Fideszit, është thirrur për përgjegjësi më të madhe, duke vlerësuar dëbimin nga dosjet e tyre.

Ndërkohë, brenda Evropës, çështje të tjera diplomatike gërshetohen në sipërfaqe. Negociatat për hyrjen e Turqisë mbeten të ngrira. Përkundrazi, përparohet në zgjerimin e unionit me Serbinë dhe Malin e Zi, teksa ka vend për dyshime për Shqipërinë dhe Maqedoninë. Roma është në favor të pranimit të këtyre të fundit për arsye historike dhe tregtare. Parisi frenon dhe tërheq një reflektim mbi besueshmërinë e kombeve që, pas gjysmë shekulli të diktaturës sovjetike, ata kthehen për të rritur barrierat. Europa, e cila bashkohet me vlerat themelore, ka frikë nga makthi i një “luftë të palodhur” që rrezikon diktimin e agjendës së të nesërme.

P ara 132 vjetëve, protestat e 1 Majit në Çikago mbaruan me gjakderdhje dhe hapën një faqe të re në luftën shekullore për të drejtat e klasës punëtore në suaza botërore. Jehona e këtyre protestave ishte e madhe dhe përfshiu të gjitha kontinentet, më vonë duke u shpallur si festë internacionale e punës dhe klasës punëtore gati në të gjitha shtetet, qofshin ato kapitaliste apo komuniste. Në shtetet kapitaliste kjo festë shfrytëzohej për avancimin e të drejtave të punëtorëve dhe lufta kundër eksploatimit të punëtorit dhe rritjes të pagave, kurse në bllokun lindor dhe shtetet tjera komuniste jashtë bllokut, kjo datë u shfrytëzua për maskimin e gjendjes të rëndë të klasës punëtore dhe shfrytëzim të skajshëm duke u thirrur në gjoja diktaturën e proletariatit e diktuar nga diktatorët komunist që paraqiteshin në forma dhe modele të ndryshme.

Diktatura komuniste në ish Jugosllavi në mënyrë eklatante e sh-

Kurthi i 1 Majit

frytëzoi këtë datë që të festohet në çdo qytet e fshat, në çdo fabrikë dhe punëtori. Shkohej aq larg, sa lideri i asaj kohe proklamoheshte si punëtor edhe atë makinist që më vonë u bë gjeneral lufte e më pas burrështeti që luajti një rol interesant në politikën botërore të asaj kohe. Festa e 1 Majit ishte shumë e rëndësishme, bile festohej nga dy ditë e kështu vazhdoi deri vonë. Duket sikur edhe qeverive të deritanishme në Maqedoni u ka konvencuar kjo festë për ikje nga realiteti dhe përditshmëria e hidhur e klasës punëtore. Punëtorët e këtyre anëve hyrën në kurth dhe në vend të protestave apo marsheve, kjo festë u shndërrua në festë të

Në Maqedoni, pas romëve, shqiptarët janë komuniteti më i keqpërdorur nga punëdhënësit, por siç duket janë më të untit për ushqim, valle dhe tallava



çoroditur të ushqimit, ditë të skarës, ditë të piknikut të pakuptimë familjar. Gjatë anketave të gazetarëve në vendin e ngjarjes, shumica nuk dinë pse kanë dalur në natyrë, çka festojnë!!! Ky kurth zgjat shumë vjet, bile e mbaj mend si fëmijë që në dy maj popullata e Strugës dhe Ohrit “takoheshin” në vendin e ashtuquajtur “Sindikallni”, ku hahej e pihej pa kufi, pa kontroll, por pa qëllim, pa orientim, pa cak...

Seriozisht nuk mundem ta kuptoj këtë veprim, këtë kremtim që shumë pak dallon nga dasmat familjare me muzikë dhe daulle dhe kam ndjenjë që këto dasmore shumica janë njerëz pa punë apo

marrin rroga e rrinë në shtëpi dhe aspak nuk kanë ndjenjën e të punuarit dhe punëtorit. Në Maqedoni, pas romëve, shqiptarët janë komuniteti më i keqpërdorur nga punëdhënësit, por siç duket janë më të untit për ushqim, valle dhe tallava. Kjo festë e shpifur nuk mund të jetë më e rëndësishme se Dita e Flamurit apo Dita e Alfabetit. Mëkati edhe më i madh është ajo që lihet pas kremtimit të kotë, një gërmadhë me plehra, qese të najlonit dhe ndonjë pelenë të dasmorit të ardhshëm në ardhmërinë e afërt nëse, si optimist patologjik që jam, diçka do të ndryshoj. Lum ai/ajo që është punëtor. Gëzuar!



Nga
Dr. Bekim TATESHI

A shohin të verbrit në ëndrrat e tyre?



Njerëzit të cilët janë të lindur të verbër, ose bëhen të verbër në fillimin e jetës (para moshës deri në shtatë vjet), nuk përjetojnë imazhe vizuale kur ëndërrojnë. Njerëzit që janë bërë të verbër më vonë zakonisht ruajnë disa imazhe vizuale kur ëndërrojnë, por më pak sesa individët që shohin. Një studim nga studiues danezë zbuloi se, sa më gjatë që dikush ka qenë i verbër, aq më pak gjasa ka që ata të shohë në ëndërr. Ndërkohë që, ata që kanë lindur të verbër nuk mund të shohin në gjumë, ata gjithsesi kanë më shumë gjasa që të përjetojnë komponentë të dëgjimit, nuhatjes, shijes, dhe prekjes, se sa njerëzit që shohin.

Pse milingonat ecin në një kolonë? Sekreti tek feromonet



Milingonat janë shumë insekte sociale, që lulëzojnë në koloni prej miliona individësh, që punojnë si ekip. Aftësitë e mira të komunikimit qëndrojnë në zemër të suksesit të tyre. Ato mbështeten shumë në aromën kimike, të quajtura feromone, për të mbrojtur territoret dhe për të shkëmbyer informacione komplekse - nga vendndodhja e burimeve ushqimore dhe vendeve të foleve, deri në praninë e grabitësve. Çdo lloj milingonash ka fjalorin e vet kimik që ka deri në 20 feromone të ndryshme, të cilat mund të sekretohen për të formuar shtigje të veçanta aromash. Antenat e tyre përkthejnë 'mesazhet' kimike, duke udhëzuar milingonat, në një vijë, drejt destinacionit të dëshiruar.



LEGGJENDA E ÇOKOLLATËS

Vetëm në vitin 1502 kakaoja u njoh nga qytetërimi evropian. Kristofor Kolombi gjatë udhëtimit të tij të katërt e të fundit në Amerikë, zbarkoi në Honduras ku pati rastin të provonte një pije me bazë kakaoje. Në kthim mori me vete disa fara kakaoje për t'ia treguar Ferdinandit dhe Izabelës së Spanjës, por nuk i dha asnjë rëndësi zbulimit

Tokat që shtrihen mes gadishullit Jukatán, Ciapasit dhe bregut paqësor të Guatemalës ishin të parët që panë fillimin e historisë së kakao dhe bashkë me të, të çokollatës. Legjenda thotë se kultura e kakao u zhvillua nga mbreti i tretë Maja: Hunaphu.

Një tjetër legjendë, kësaj radhe azteke thotë që në kohë të hershme, një prince-she iu la nga i shoqi i nisur për në luftë, një thesar i madh. Kur erdhën armiqët, prince-she nuk pranoi të tregonte se ku e kishte fshehur thesarin dhe për këtë e vranë. Nga gjaku i saj lindi bima e kakao, farat e së cilës janë të hidhura si vuajtja, por në të njëjtën kohë, të forta dhe emocionuese si virtytet e saj. Më vonë, Majët dhe Aztekët filluan kultivimin e kakao dhe me të prodhonin çokollatë, të cilën e lidhnin me Xokikuetzalin, perëndeshën e fertilitetit. Bima e kakao ka origjinë antike dhe sipas disa studimeve botanike, mendohet të ketë qenë e pranishme mbi 6000 vjet më parë në lumenjtë Amazona dhe Orinoko. Bujqit e parë që filluan ta kultivonin bimën e kakao ishin Majat, rreth vitit 1000 para erës sonë.

VETËM ELITA KONSUMONTE ÇOKOLLATË

Sipas vlerave mistike e fetare, kakaoja konsumohej nga elita gjatë ceremonive të rëndësishme. Ofruhej me flakë si sakrificë ndaj hyjnive dhe ndonjëherë përzihej me



Bima e kakao ka origjinë antike dhe sipas disa studimeve botanike, mendohet të ketë qenë e pranishme mbi 6000 vjet më parë në lumenjtë Amazona dhe Orinoko. Bujqit e parë që filluan ta kultivonin bimën e kakao ishin Majat, rreth vitit 1000 para erës sonë



gjakun e priftërinjve. Si prova të kësaj janë gjetur shume piktura të bimës së kakao nëpër vazo dhe kode Maja.

Përveç përdorimit liturgjik e ceremonial, në Amerikë çokollata përdorej si pije e quajtur ksokoalat, shpesh e aromatizuar me vanilje, spec djegës e piper. Kjo pije konsumohej e ftohtë ose e nxehtë duke i shtuar ujë ose përbërës të tjerë si mielli. Një tjetër mënyrë përgatitje ishte duke i shtuar çokollatës miell misri dhe mjaltë. Karakteristika e saj parësore ishte shkuma, e cila në antiki-

tet përftohej duke e kaluar disa herë nga një enë në tjetrën. Pas pushtimit spanjoll filloi të përdorej "dybeku" (molinilo) i cili lëvizte poshtë e lart dhe kështu arrihej me shpejt shkuma aq e dëshiruar.

A E NJIHNIN EUROPIANËT ÇOKOLLATËN?

Vetëm në vitin 1502 kakaoja u njoh nga qytetërimi evropian. Kristofor Kolombi gjatë udhëtimit të tij të katërt e të fundit në Amerikë, zbarkoi në Honduras ku pati rastin të provonte një pije me bazë kakaoje. Në kthim mori me vete disa fara kakaoje për t'ia treguar Ferdinandit dhe Izabelës së Spanjës, por nuk i dha asnjë rëndësi zbulimit. Vetëm me Hernando de Soton u arrit futja e kakao në Evropë me shumicë, në vitin 1519. Ai arriti në Amerikë nga Spanja dhe popullsia e vendit e kujtoi për perëndinë Kutzalkoatl, i cili sipas legjendës duhej të kthehej pikërisht në atë vit. Perandori Montezuma e priti krahëhapur dhe i ofroi një plantacion të tërë me kakao.

Ngarkesa e parë e dokumentuar e çokollatës drejt Europës me qëllim tregtar, udhëtoi mbi një anije nga Verzkruzi në Sevilje në 1585 (në Sevilje ndodhej Këshilli Mbretëror i Indive, nëpërmjet të cilit kurora spanjolle kontrollonte të gjitha trafiqet tregtare, administrimin, aspektet ushtarake dhe fetare të kolonive të veta përtej oqeanit).

NJERËZIT KANË SHFAROSUR GJIGANTËT LESHATORË

Njerëzit primitivë kanë bashkëjetuar me qenie gjigante, barngrënëse e leshatore, të cilat i kanë vrarë aq shumë sa kanë arritur t'i shfarosin.

Gjurmë të fosilizuara, të zbuluara në Nju Meksiko të SHBA-ve, të krijuara rreth 15,000 vite më parë, vërtetojnë akoma më shumë se Megalonyx Jefferson, "slothët gjigantë", kanë bashkëjetuar me njerëzit primitivë dhe janë guajtur prej tyre. Sipas Metju Benet, profesor i Universi-

tetit Bournemouth, gjurmët e fosilizuara të gjigantit leshator kanë rrotull gjurmë njerëzish që me ç'duket kanë qenë duke e vrarë. Sipas tij, pozicionimi tregon se kafsha ka qenë ngritur mbi dy këmbë për t'u mbrojtur, ndërkohë që sulmohej nga një grup njerëzish të uritur. Megjithatë, shkencëtarë të tjerë thonë që njerëzit mund t'i kenë lënë gjurmët edhe në një kohë tjetër, jo patjetër në të njëjtin çast me gjigantin. Ndryshe nga pa-



sardhësit e tyre të sotëm, slothët dembelë, të cilët kalojnë një pjesë të madhe të kohës duke fjetur në degë pemësh, kushërinjtë pa-



rahistorikë ishin deri në tre metra të lartë dhe peshonin deri në 360 kg. Pavarësisht përmasave, ata nuk ishin kafshë gjuetare, por ushqeheshin me gjethe dhe fruta.

HUDHRA PARANDALON KANCERIN DHE DISA SËMUNDJE TË TJERA!

Endërsa shkencëtarët ende po diskutojnë për teknikat e duhura për përgatitjen e saj, studiuesit bien të gjithë dakord se hudhra një prej bimëve që ka aftësi të forta terapeutike



Prej shumë e shumë vitesh hudhra është konsideruar si një përbërës i rëndësishëm për të pasur një shëndet të mirë. Ajo përdoret prej qindra vitesh për të trajtuar sëmundjet te njerëzit. Mirëpo, mënyrën se si hudhra sjell përfitime për organizmin e tregon një studim i kryer së fundmi. Në një studim të kryer nga shkencëtarët e Universitetit të "Nottingham" theksohet se hudhra zvogëlon rrezikun e zhvillimit të disa llojeve të kancerit, lufton sëmundjet kardiovaskulare si dhe lufton zhvillimin e diabetit të tipit 2.

Për më tepër, mënyra si përgatitet hudhra mund të ketë një efekt pozitiv në funksionimin e mirë të trupit dhe shëndetit tuaj. Megjithatë, shkencëtarët ende nuk

kanë arritur të zbulojnë se cila metodë e përgatitjes së hudhrës është më efektive për shëndetin. Hudhra prodhon një shumëllojshmëri të përbërësve të sqfurit kur është e përgatitur, kur është e copëtuar, e fermentuar në alkool ose e shtypur në vaj. Sipas studiuesve, këto përbërje sqfuri mund të ndikojnë në "molekulat e sinjalizimit të gaztë", të tilla si oksid nitrik dhe sulfur hidrogjeni, që prodhohen

natyrshëm në trupin e njeriut.

Endërsa shkencëtarët ende po diskutojnë për teknikat e duhura për përgatitjen e saj, studiuesit bien të gjithë dakord se hudhra një prej bimëve që ka aftësi të forta terapeutike. "Ka plot elementë në këtë fushë për të treguar se si hudhra mund të ulë rrezikun e sëmundjeve dhe për të përmirësuar shëndetin e njeriut. Por gjithçka kthehet në pyetjet thelbësore, se

çfarë ndodh në trupin tonë, kur këta përbërës kalojnë në metabolizëm", tha dr. Rose, një prej studiuesve. Gjithashtu hudhra veti anti-inflamatore dhe ul presionin e gjakut; Hudhra është një mjet efektiv për ftohjet dhe një antibiotik natyral; Është shumë e rëndësishme të dini se hudhra rrit aftësinë e trupit për të përballuar ndikimet e dëmshme të ambientit, sepse ajo forcon sistemin imunitar.



Vitamina D mbron nga diabeti

Nivelet e larta të vitaminës D zvogëlojnë ndjeshëm rrezikun e diabetit të njerëzve, sugjeron hulumtimi i ri. Autori kryesor Dr. Sue Park, nga Universiteti Kombëtar i Seulit, tha se kanë gjetur se pjesëmarrësit me nivele të gjakut të [vitaminës D] që ishin mbi 30 ng / ml kishin një të tretën e rrezikut të diabetit dhe atyre me nivele mbi 50 ng / ml kishte një të pestën e rrezikut të zhvillimit të diabetit.

Studiuesit argumentojnë se gjetjet e tyre theksojnë se të rriturit duhet të kenë të paktën 30ng vitaminë D për millimetër të gjakut, e cila është 10ng / ml më e lartë se niveli i rekomanduar nga Instituti i Mjekësisë. Rreth 77 për qind e të rriturve në SHBA janë të mangët në vitaminë D, e cila është dyfishi i shkallës së vitit 1980. Hulumtimet e mëparshme sugjerojnë forca të vitaminës D sistemet imunitare të njerëzve.

Diabeti i tipit 1 është një gjendje autoimmune që ndodh kur trupi i një personi sulmon qelizat që prodhojnë insulinë. Diabeti i tipit 2 është më i lidhur me faktorët e jetesës, të tilla si bartja e peshës së tepërt.

Një foto në ditë ju bën të ndiheni më mirë

Studime të reja kanë sugjeruar se realizimi i një fotoje në ditë ndihmon në mirëqenien e njerëzve. Postimi i një imazhi online për dy muaj ju jep njerëzve një ndjenjë të rutinës, nxitë interaktivitetin me të tjerët dhe i bën që të ndihen më të lidhur me rrethin. Një fotografi në ditë gjithashtu inkurajon njerëzit që të lëvizin nga shtëpia, kjo pasi 76% e fotove janë të realizuara në

ambiente të jashtme. Disa prej personave të përfshirë në studim madje kanë deklaruar se shpërndarja e fotografive u ka ndihmuar që të përballen me vetminë dhe ngjarjet tragjike në familje. Sipas studiuesve nga Universiteti Lancaster kjo praktike është një proces aktiv i të krijuarit kuptime, përmes së cilit krijohet një koncept i ri i konceptualizimit.



A TREGON FYTYRA SA I PASUR JE? NJË STUDIM THOTË PO

Në përgjithësi, njerëzit me para jetojnë më të lumtur, më pak ankth, krahasuar me ata që luftojnë për të arritur qëllimet. "Këto dallime të mirëqenies reflektohen në fytyrat e njerëzve", thotë Thora Bojrnstodt, një studente e universitetit të Torontos dhe bashkautore e studimit

Një studim i ri i publikuar në Journal of Personality and Social Psychology të tregon se mund të dallosh një person nëse është i pasur apo i varfër thjesht duke e parë.

"Lidhja mes mirëqenies dhe nivelit social është treguar në studimet e mëparshme", thotë Thora Bojrnstodt, një studente e universitetit të Torontos dhe bashkautore e studimit. Në përgjithësi, njerëzit me para jetojnë më të

lumtur, më pak ankth, krahasuar me ata që luftojnë për të arritur qëllimet. "Këto dallime të mirëqenies reflektohen në fytyrat e njerëzve", thotë ajo. Ajo bashkë me profesorin e psikologjisë, Nicholas O. Rule, kishin lëndë universitare të etnive të ndryshme në foto bardhë e zi. Studimi i tyre u bë duke ua treguar studentëve këto foto dhe saktësia e treguar për të pasurit dhe të varfrit ishte 68%. Për Rule

kjo ishte pjesa më e habitshme e studimit. "Nuk prisja që efektet të ishin kaq të forta dhe të vërehehin diferencat", thotë ai.

Kur i pyet njerëzit se ku bazohen për të bërë këtë përcaktim, e çuditshme është se nuk e dinë se ku bazohen, por personi u jep përshtypjen që është i pasur, apo është i varfër. Duke u fokusuar më shumë në studim, autorët thonë se sytë dhe goja ishin tiparet krye-



sore që tregonin gjendjen sociale. "Me kalimin e kohës fytyra juaj ka reflektime të përjetshme për të zbuluar eksperiencat tuaja. Edhe

kur mendoni se nuk shprehni diçka, reliket e këtyre eksperiencave janë akoma aty", thotë Rule për Universitetin e Torontos.

Seanca e ditës së enjte e Kuivendit të Kosovës ka nisur sërish me akuzat dhe kundër akuzat mes Xhavit Halitit dhe Anton Çunit lidhur me atë se ky i fundit, pati deklaruar se Haliti ka marrë rreth 8 milionë marka nga Ahmet Krasniqi. Deputeti i LDK'së, Anton Çuni, ka thënë se ka mbledhur faktet ku shihet se Ministria e Mbrojtjes ka financuar Shtabin e Përgjithshëm të UÇK'së.

ANTON ÇUNI SËRISH PËPLASET ME XHAVIT HALITIN RRETH FONDEVE TË LUFTËS



“E pastaj me kolonel Halil Bicaj, gjithnjë është kërkuar dhe biseduar për unifikimin dhe ndërtimin e një hierarchie ushtarake dhe për të gjitha vështirësitë në këtë proces. Ka ekzistuar dhe funksionuar Ministria e Mbrojtjes së Kosovës, për të cilën ende ka mohime nga akterët të ndryshëm. Në dëshmitë e mia nuk ishin në focus shuma apo totali i të hyrave nga institucionet e Kosovës, tek Shtabi i Përgjithshëm. Por reagimi agresiv i zotit Xhavit Haliti dhe i paarsyeshëm, tani më bën të dyshoj se tani në pyetje janë shuma shumë më të mëdha dhe a u përdorën ato para në destinimin e duhur. Është fakt se kompetent janë të gjithë ata që ju zoti Haliti i apostrofuara në seancën e kaluar. Unë do të respektoj autoritetin e tyre, por me forcën e fakteve dhe argumenteve gjithnjë do të flas

edhe për rolin e Ministrisë së Mbrojtjes në Kosovë. Unë i kam dëshmitë, zoti Haliti, ato dëshmi janë të klasifikuara dhe varet nga ju a do t'i publikoni apo jo por nëpërmjet administratës ku janë të përfshira shumata, data, datat, e kalimit të mjeteve financiare nga Ministria e Mbrojtjes”, ka thënë Çuni.

Haliti, në Kuvend iu përgjigj Çunit duke thënë se ai ka pasur bashkëpunim të ngushtë me Ahmet Krasniqi, por sipas tij, ai si ministër i Mbrojtjes ishte i luftuar nga “segmente të caktuara”, shkruan Periskopi.

“Sa për ta përkujtuar, unë kam pas raporte me Ibrahim Rugovën, Bujar Bukoshin, Shaqir Shaqirin, Anton Folën... Me të gjithë kam biseduar, shumë herët, deri te themelimi i Fondit Kombëtar, deri te

prishja e këtij fondi. E di shumë mirë edhe fondin e Qeverisë së Kosovës... por nuk dua ta analizojë. E vërteta është që më është ofruar Ahmet Krasniqi, përmes Shaban Mujës dhe Billal Sherifit, më kanë thirrë në shtëpinë e Bilal Sherifit. Ahmet Krasniqi s'ka qenë ministër i Mbrojtjes. Problemi është dhe e mira është, që ka pas përpjekje dhe ka pas bashkëpunim. Ka pas edhe hezitim. Unë kam bashkëpunuar ngushtë me Ahmet Krasniqin deri sa është vlarë. Kam bashkëpunuar edhe me zotin Bicaj. Për juve, skam ditë as kush jeni. I di problemet që kanë qenë, akuza kundërukuza, e kam marrë vesh kush ke qenë pas luftës. Segmentet të caktuara e kanë penguar Ahmet Krasniqin. Ahmet Krasniqi është emëruar ministër i Mbrojtjes shumë vonë dhe ka luf-

tu me ato struktura të Qeverisë sepse e luftojshin si ministër të Mbrojtjes”, tha ai.

Më pas ka eskaluar në fjalë të rënda debate mes Xhavit Halitit dhe Anton Çunit në Kuvendin e Kosovës

Xhavit Haliti: Deshta ti them Anton Çunit se le ti informon mediat se nuk e ke sjellë asnjë dokument që dëshmon se unë kam marrë 8 milionë. Unë nuk i kam marrë 8 milionë. Atë interpretimin qysh e ke bërë në emisione të ndryshme. Por mirë është me thënë që ta ndërprejnë gënjeshtren. Nuk po e hapim debatin, por mirë është t'ju thush vet, se qysh ju ke bërë këtë informatë thuju le ta ç'bëjnë ose po i qes letrat edhe unë.

Anton Çuni: Nuk e kuptoj pse e shfaqni këtë nervozë.

Xhavit Haliti: E shfaq se po i shoh portalet, s'ka portal që se ka se Anton Çuni dorëzoi një dokument që Xhavit Haliti ka marrë 8 milionë marka, tregojnë mediave se nuk ke dëshmi se kam marrë 8 milionë marka

Anton Çuni: Nuk kam arritur ti siguroj të gjitha, por në ato dëshmi, janë vultat e Ministrisë së Mbrojtjes.

Xhavit Haliti: A janë 8 milionë marka, lej vultat

Çuni: Janë më shumë se 8 milionë marka që Qeveria e Republikës së Kosovës i kanë nda për UÇK'në

Haliti: Po të pyes Anton rrenci, a

ke dorëzoi dokument. Je tuj rrejtë Anton Rrenci. Nëse ka një dokument se unë kam kërcënu, kam shantazhu, unë për besë kam me dhënë dorëheqje.

Në debat është inkuadruar edhe kryetari i Kuvendit Kadri Veseli, i cili ka ndërhyrë në përplasjet mes Anton Çunit dhe Xhavit Halitit, duke thënë se mund të mbahet një debat për paratë e fondeve të luftës.

“E majna ni debat se s'di ku a kanë shku paret as kah na kanë shku e majna ni debat për këtë punë, zoti Çuni thirre ni debat flasin dy ditë për këtë punë” ka thënë Veseli, transmeton Periskopi.

Ndërkaq, deputeti Avdullah Hoti ka kërkuar ta sqarojë deklaratën e tij Xhavit Haliti se kush i kishte thënë në Vjenë se ‘presin që komandantët ta vrasin njëri – tjetrin e pastaj ta marrin pushtetin’.

“Në media po qarkullon lajmi se ju keni thënë se ish-kryeministri Isa Mustafa ju ka thënë në Vjenë se presim që komandantët e UÇK'së ta vrasin njëri tjetrin, presim ta sqarosh ose ta përgënjeshtrosh këtë”, ka thënë Hoti.

Haliti ka thënë se mediat e kanë keqinterpretuar deklaratën e tij, sepse nuk e ka pasë fjalën për Isa Mustafën, por për Bujar Bukoshin.

“Jo, ashtu kam deklaruar por nuk e kma pasë fjalën për Isa Mustafën por për Bujar Bukoshin”, ka thënë Haliti.

SAIMIR TAHIRI DORËZON MANDATIN E DEPUTETIT

KQZ duhet të pranojë dorëheqjen dhe të konstatojë përfundimin e mandatit për deputetin Saimir Tahiri. Pas kësaj, nëse prokuroria e vlerëson për një arrest të mundshëm të tij, atëherë mund të veprojë me “urdhër arrest” dhe më pas ky urdhër të vlerësohet nga gjykata



Saimir Tahiri ka hequr dorë nga mandati i deputetit për tu përballur si qytetar i thjeshtë me hetimet që kanë nisur ndaj tij për përfshirje në trafikun e drogës.

Në një konferencë për mediat, deputeti i sapodorëhequr tha se do të përballlet jo vetëm me drejtësinë, por edhe me palaçot politikë, siç ai quan jo vetëm përfaqësues

të opozitës që e kanë sulmuar prej kohës që ai ishte ministër i brendshëm në mandatin e parë të qeverisë Rama, por edhe përfaqësues të qeverisë në 25 vite që sipas tij vetëm kanë vjedhur në kurriz të shqiptarë.

Tahiri foli për një gjyq politik që po i bëhet, duke e quajtur gjyq nga daj të politikës shqiptare. Ai shtoi se 6 muajt që ka heshtur nuk janë aspak shprehje e frikës së tij, por faktit që ka dashur të përballlet

vetëm me drejtësinë dhe jo me akuzat politike.

“Nga sot dorëzoi mandatin tim të deputetit, deri kur të zbardhet e vërteta. Si qytetar i thjeshtë me të drejtën time me familjen time me miqtë e mi dhe me gjithë njerëzit që më besojnë ende do përballim me drejtësinë me ligjin, siç do përballim me palaçot në politike. Nuk do të dorëzohem në asnjë çast. Ja ku më keni si qytetar të thjeshtë. Kjo nuk është ndeshja ime e fun-

dit, është veç e para. Unë jam Saimir Tahiri dhe nuk kam nevojë për mandat dhe imunitet për tu përballur me palaçot e politikës sot dhe sa të kem fuqi”, tha Tahiri.

“Oligarkët që i palluan në tendera”, tha Tahiri duke shtuar se si për një spital një rrugë janë paguar nga 4-5 herë. I quajtur si koka që po mban peng integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, Tahiri u shpreh: “Jam shumë i vogël për të penguar integrimin e shqipërisë në BE. Duan kurban njerëzish për të shkelur në Evropë”.

Por çfarë do ndodhë me të? A do kërkojë Prokuroria e Krimeve të Rënda arrestimin? Fillimisht pritet që mandati i tij të shkojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

KQZ duhet të pranojë dorëheqjen dhe të konstatojë përfundimin e mandatit për deputetin Saimir Tahiri.

Pas kësaj, nëse prokuroria e vlerëson për një arrest të mundshëm të tij, atëherë mund të ve-

projë me “urdhër arrest” dhe më pas ky urdhër të vlerësohet nga gjykata.

Ruga e dytë është që t'i drejtohet gjykatës për Krime të Rënda për caktimin e masës së sigurisë “arrest me burg” dhe vetëm nëse e siguron një vendim të tillë, atëherë mund të ketë një arrestim të mundshëm të tij.

Kujtojmë që ish-ministri Saimir Tahiri u përfshi në skandalin e përgjimeve të trafikantëve “Habibaj” kushërinj të tij të largët, të cilëve iu kishte shitur edhe makinën. Në përgjimet e Prokurorisë së Kataniatrafikantët e përmendnin si personi me të cilin ndanin fitime.

Pas kësaj nisën hetimet paralele në Itali dhe Shqipëri, por edhe pse prokuroria e Krimeve të Rënda kërkoi arrestimin e tij, Kuvendi nuk ia hoqi mandatin e deputetit. Partia Socialiste e shkarkoi nga të gjitha funksionet dhe prej 6 muajsh ai qëndroi si deputet i pavarur, derisa sot mori vendimin.

Pas skandalit me Facebook-un, mbyllet Cambridge Analytica

Cambridge Analytica, firmë konsultante me seli në Britani, tha se do të mbyllet, pas akuzave se ka keqpërdorur të dhënat e miliona përdoruesve në Facebook, për të ndikuar zgjedhjet presidenciale në SHBA, më 2016. "Kemi vendosur se nuk është më e dobishme të vazhdojmë biznesin", tha kompania, duke shtuar se, së shpejti, do të nisë procedurat e falimentimit në SHBA dhe Britani. Cambridge Analytica, kompani e angazhuar nga fushata zgjedhore e presidentit të tanishëm amerikan, Donald Trump, është bërë objektivi i hetimeve, pasi një ish-punonjësi i saj ka zbuluar se ajo ka pasur qasje të paligjshme në të dhënat e miliona përdoruesve në Facebook dhe se i ka përdorur ato për të ndikuar votuesit në SHBA. Cambridge Analytica e ka mohuar se i ka shfrytëzuar këto të dhëna për të ndihmuar fitoren e Trumpit.

Trump ia kthen paratë avokatit që pagoi prostitutën



Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ia ka kthyer personalisht avokatit të tij 130,000 dollarë, të cilat janë përdorur për të "blerë" heshtjen e aktores së filmave pornografikë, Stormy Daniels, në lidhje me një aferë të dyshuar, tha ndihmësi ligjor i Trumpit, Rudy Giuliani. Ky pohim duket se bie në kundërshtim me Trumpin, i cili ka thënë se nuk ka ditur për pagesën që i ka bërë avokati Michael Cohen Danielsit, përpara zgjedhjeve të vitit 2016. Trump po ashtu ka mohuar se ka pasur aferë me Danielsin në vitin 2006 - ashtu siç pretendon kjo e fundit. Giuliani tha se nuk janë përdorur financat e fushatës dhe se shlyerja e borxhit është bërë "për një periudhë prej disa muajsh".

DITA NDËRKOMBËTARE E LIRISË SË SHTYPIT

VRASJA E GAZETARËVE



Sa më i lirë që është një shtet në aspektin ekonomik dhe sa më shumë që jep hapësirë për subjekte tjera në treg, aq më të mëdha janë mundësitë që mediat të jenë të lira. Rasti i Evropës Perëndimore dhe Amerikës Veriore, tregon se tregjet e lira janë të lidhura me liri në media. Por jo vetëm ekonomia, edhe jeta e gazetarëve është në rrezik. Këtë të hënë, nëntë gazetarë kanë qenë në mesin e të paktën 25 personave të vrarë në dy sulme me bomba në Afganistan

Gjashtëdhjetepesë gazetarë janë vrarë derisa kanë qenë duke kryer punën e tyre më 2017, ka bërë të ditur raporti i fundit i Reporterëve pa Kufij. Ky njëherësh ka qenë detaji më i zymtë i raportit, i cili më 3 maj, në Ditën Ndërkombëtare të Lirisë së Shtypit vë në pah kohë të vështira për mediat. Këtë të hënë, nëntë gazetarë kanë qenë në mesin e të paktën 25 personave të vrarë në dy sulme me bomba në Afganistan. Në një artikull të gazetës Wall Street Journal theksohet se mënyra se si mund të ndihmohen gazetarët në gjithë botën është përmes zgjerimit të lirisë ekonomike, pasi ajo konsiderohet e domosdoshme për demokracinë.

Aty thuhet se liria ekonomike është tejet e nevojshme për lirinë e shtypit, pasi në kohërat moderne nuk ka pasur kurrë shoqëri demokratike e cila ka respektuar të drejtat e individëve pa të paktën minimumin e lirisë ekonomike. Sa më i lirë që është një shtet në aspektin ekonomik dhe sa më shumë që jep hapësirë për subjekte tjera në treg, aq më të mëdha janë mundësitë që mediat të jenë të lira. Rasti i Evropës Perëndimore dhe Amerikës Veriore, tregon se tregjet e lira janë të lidhura me liri në media.

Mirëpo Turqia përbën rast tjetër. Ditë

më parë, agjencia e lajmeve AFP, në një shkrim për gjendjen e mediave në këtë vend, shkruan se e përditshmja Cumhuriyet, e themeluar gati një vit pas krijimit të Turqisë moderne, përbën një nga bastionet e fundit për liri të mediave. Cumhuriyet, e cila do të thotë "Republikë", ka krijuar një linjë të ashpër kundër Partisë për Drejtësi dhe Zhvillim (AKP), e cila ka nxitur përplasje të gazetës me presidentin turk, Recep Tayyip Erdogan.

Në muajin prill shteti turk ka dënuar 13 gazetarë të kësaj gazete, duke u dhënë dënime të shumëfishta për "ndihmë dhe nxitje të organizatave terroriste pa qenë anëtarë". Ata janë akuzuar për lidhje me militantët kurdë dhe klerikun fetar, Fethullah Gulen, i cili fajësohet për tentimet e dështura për grushtshtet në korrik të vitit 2016. Mirëpo duket se mediat e reja përbëjnë një tjetër sfidë për fjalën e lirë dhe të vërtetën. Në një tjetër artikull të Wall Street Journal përmendet deklarata e udhëheqësit të Facebook-it, Mark Zuckerberg për siç ka thënë ai vënien në funksion të intelegjencës artificiale me qëllim të identifikimit dhe zhdukjes së "gjuhës së urrejtjes". Sidoqoftë ai ka pasur vështirësi në përcaktimin e qartë të termit. Edhe ai ka pranuar vitin e kaluar se standardet e fjalës së pranueshme janë

shumë subjektive.

"Komuniteti ynë përfshin shumë shtete dhe kultura andaj normat janë të ndryshme për secilin rajon", duke bërë standardet universale "më pak të realizueshme". Së fundmi, agjencia e lajmeve, Reuters ka raportuar se gjigantët teknologjikë, Facebook dhe Google duhet të përshejtojnë përpjekjet e tyre për të luftuar shpërndarjen e lajmeve të rreme në gjashtë muajt e ardhshëm apo do të përballen me rregullore të reja nga Bashkimi Evropian. Komisioni Evropian do të hartojë deri në muajin korrik një kod të ri të Praktikave të BE-së mbi Dezinformimin, me qëllim të parandalimit të shpërndarjes së lajmeve të rreme.

"Këto platforma online kanë dështuar deri më tash për të vepruar në mënyrë proporcionale, në sfidën që paraqet dezinformimi dhe përdorimi manipulues i platformave, ka njoftuar ky Komision në strategjinë për luftimin e lajmeve të rreme. Reporterët pa Kufij e kanë listuar këtë vit Kosovën në vendin 78-të, apo katër vende më lartë sesa vitin e kaluar sa i përket lirisë së shtypit. Në raportin e ri është përmendur se ndikimi politik dhe mungesa e sigurisë së gazetarëve kanë ndikuar që Kosova të jetë në mesin e vendeve me probleme.

URDHËRARREST PËR 70 USHTARË TË LIDHUR ME FETO-n

Prokuroria e Turqisë ka lëshuar urdhër arresti për 70 ushtarë të dyshuar për lidhje me FETO-n, grupin terrorist i cili qëndron pas tentimit të grushtit ushtarak të vitit të kaluar, thanë sot burimet gjyqësore. Prokurorët në provincën qendrore të Anadollit, Konya lëshuan urdhër-arrestet për 70 pjesëtarë të Forcave të Armatosura Turke, përfshirë edhe

ushtarët në detyrë, të akuzuar për lidhje me Organizatën Terroriste FETO. Policia e Konyas urdhëroi nisjen e operacioneve në 34 provinca. Kërkimet për të dyshuarit janë në zhvillim e sipër, thanë burimet, të cilët kërkuan të mbeten anonim për shkak të kufizimeve për të folur për mediat. Organizata FETO dhe udhëheqësi i saj me qëndrim në SHBA, Fetullah Gü-

len orkestruan tentimin e grushtshtetit ushtarak të 15 korrikut 2016, në të cilin ranë dëshmorë 250 persona dhe rreth 2.200 të tjerë u plagosën. Ankaraja gjithashtu akuzon FETO-n se ka qëndruar pas një fushate të gjatë për përmbysjen e shtetit përmes infiltrimit të ithtarëve të saj në institucionet turke, veçanërisht në ushtri, polici dhe gjyqësor.



Historiani Amir Duranoviq flet për Al-Jazeera në lidhje me motivet e shkarkimit të nënkryetarit të dikurshëm të Jugosllavisë Aleksandar Rankoviq dhe për pasojat në jetën politike të shtetit të atëhershëm

Jehonën më të fuqishme të libeve për Brionet e ka bërë ai i historianit Amir Duranoviq, në të cilin autori përshkruan seancën, motivet dhe rrjedhën e mbledhjes plenare, e cila e ndryshoi rrjedhën e ideve komuniste jugosllave dhe fuqimisht i preku reformat e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Me Plenumin e Brioneve (1966) iu dha legjitimitet aspiratave që kërkuan ndryshime të rregullimit shtetëror dhe pikëpamjeve komuniste, duke u fokusuar në pasojat që i prodhoi seanca në jetën e përditshme politike të vendit. Si figurë qenësore e të gjitha diskutimeve dhe debateve të Brioneve paraqitet nënkryetari i RSF të Jugosllavisë, Aleksandar Rankoviq, shkarkimi i të cilit, praktikisht dhe simbolikisht, del të jetë një pikë kthese në luftën ndërmjet fraksioneve "konservatore" dhe "liberale" brenda Lidhjes së Komunistëve.

Me "rënien" e Rankoviqit hapen dhe shfaqen proceset e dukshme që kishin për qëllim reformimin e shoqërisë jugosllave dhe bashkësitë politike. Për më tepër, në libër përshkruhen jo vetëm proceset e ndërmarra për shkarkimin e Rankoviqit, por edhe atmosfera që mbizotëronte në shoqërinë jugosllave, e cila e mbështeti shkarkimin e nënkryetarit të fuqishëm, si dhe përpjekjet e presidentit Josip Broz Tito për t'u tërhequr nga koncepti i rregullimit centralist të Jugosllavisë. Me këto reforma, shoqëria u hap për idetë pluraliste dhe federaliste të rregullimit shtetëror. Në një intervistë për Al-Jazeera, Duranoviq flet për motivet e ndërrimit të Rankoviqit, si dhe për pasojat që ky ndërrim pati në shoqërinë jugosllave dhe në strukturën e Lidhjes së Komunistëve, duke theksuar se hulumtimet e tij historiografe kërkonin të nxirrin në pah ngjarjet që ndodhën para, gjatë dhe pas Plenumit të Brioneve nga disa aspekte. Sipas mendimit të Duranoviqit, Plenumi i Brioneve e kishte një ndikim të fuqishëm në opinionin e atëhershëm jugosllav, ndërsa rëndësia e librit pasqyrohet më së tepërmi në nevojën për ta kuptuar siç duhet historinë e vendit në vitet 1960.

"Rëndësia e titullit, sipas mendimit tim, është se unë besoj që edhe 50 vjet pas Plenumit të Brioneve kemi nevojë për t'i shqyrtuar seriozisht shumë çështje të historisë jugosllave, madje edhe këtë çështje. Interpretimet e deritanishme të Plenumit të Brioneve ishin kryesisht reovertime të kohës në të cilën ato u

AMIR DURANOVIQ PËR AL-JAZEERA

KUR TITO RRËZOI RANKOVIQIN NË BRIONI



krijuan. Përpjekja ime me këtë libër është kthimi i vëmendjes së ekspertëve profesionistë në burimet historike nga mesi i viteve të gjashtëdhjeta, me të cilat në fokus të diskutimeve tona, tema popullore e ndërrimit të Aleksandar Rankoviqit do të zhvendosej në kërkimet më të thella në marrëdhëniet e Lidhjes së Komunistëve dhe Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit, në kontrollimin e autoriteteve policore dhe çështjet tjera në nivele më të ulëta, në nivele lokale dhe republikane nëpër gjithë Bosnjë-Hercegovinën, gjë që deri më tani shpesh është injoruar në kërkimet historiografike".

Në Plenumin e Brioneve u shkarkua nënkryetari i RSFJ-së, Aleksandar Rankoviqi. Cilat ishin motivet për shkarkimin e tij?

Plenumi i Brioneve është kulmi i një procesi afatgjatë të thyerjes së pushtetit politik në kreun e Lidhjes së Komunistëve në rrugën e transformimit serioz të shoqërisë jugosllave, sidomos pas Kushtetutës së vitit 1963 dhe pas fillimit të reformave ekonomike në vitin 1965. Në këtë kontekst, Plenumi i Brioneve paraqitet si një pikë kthese në të cilën, ta quajmë ashtu, një rrymë konservatore në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë praktikisht u mund, përkatësisht dominimin e morën ata që mendonin se marrëdhëniet ekonomike dhe politike jugosllave duhet të jenë më të liberalizuara. Në këtë mënyrë erdhi deri te ndërrimi i Rankoviqit, përkatësisht, nëse e themi shkurt e troç, Rankoviqi e dha dorëheqjen nga funksioni që e kryente. Domethënë, ai nuk u ndërrua, edhe pse në kontekstin sesi ndodhi është shumë e qartë se ajo ishte një

dorëheqje, e cila iu imponua. E dyta: Rankoviqi u ndërrua nga pozita e nënkryetarit të Jugosllavisë dhe nga funksionet partiake që mbante, ndërsa qysh më herët, që nga viti 1963, ai nuk ishte as formalisht i lidhur me strukturat e policisë, me gjithë faktin që deri atëherë ai kishte qenë ministër federal i Punëve të Brendshme.

Nga distanca historike, a qëndron ende teoria apo këndvështrimi se Rankoviqi u shkarkua për aferën "Përgjimet"? Çfarë në të vërtetë ishte kjo aferë?

Afera "Përgjimet" është ndoshta pjesa më e popullarizuar dhe më e eksploruar e tregimit për shkarkimin e Rankoviqit, sepse ajo, në mënyrën që është paraqitur në atë kohë, ishte tronditëse, pra, meqë papritmas u supozua se të gjitha hapësirat në të cilat ishte presidenti jugosllav Josip Broz Tito, duke përfshirë edhe hapësirat e tij private, ishin përgjuar dhe incizuar, dhe praktikisht ky moment i mundësoi ato ndryshime të imponuara. Kjo çështje ishte aktuale në historiografi atëherë, në vitin 1966, është edhe sot. Një libër u publikua para një viti në Beograd, si dhe disa shkrime të tjera, në të cilat pretendohet se praktikisht nuk kishte përgjime, por kjo është ajo që ka mbetur më e habitshme, edhe pse unë kam shumë rezerva në lidhje me këtë. Nuk jam i bindur se ai ishte i vetmi motiv, apo që kishte fare përgjime. Më shumë arsye për këtë, unë do të përiqem t'i paraqes nëpërmjet disa diskutimeve gojore që ndodhën në kreun e elitës komuniste jugosllave. Është e vështirë të besohet në faktin se diçka e tillë e madhe ndodh dhe se Titoja dhe ushtria nuk dinë asgjë që më parë. Kjo është një gjë, ndër-

sa tjetra është e vështirë të besohet se një pjesë e udhëheqjes së partisë bën atë që dëshiron, ndërsa pjesa tjetër, policia sekrete dhe UDB-ja nuk dinë asgjë për këtë, prandaj të ketë nevojë për përgjim. Që ta shpjegoj në mënyrë më elokvente: në një libër të karakterit publicistik, Rankoviqi, duke iu arsyetuar një miku të tij, përkatësisht duke pretenduar se nuk kishte përgjime, e pyet në mënyrë retorike se çfarë ishte ajo që mund të oitej atje dhe ai të mos dinte diçka për të. Ai ishte vetë kreu i partisë dhe nuk besoj se ky ishte motivi kryesor, por është diçka që është e njohur dhe domethënëse. Unë me librin tim jam përpjekur për ta kthyer fokusin në gjëra tjera, ku, siç shihet, kishte tejkalim të kompetencave në punën e policisë dhe ndërhyrje në punët që nuk janë në radhë të parë të karakterit të saj. Kjo, në radhë të parë, shihet sidomos në disa nivele më të ulëta. Ndërsa në krye, unë mendoj se kjo është vetëm pjesë e folklorit politik dhe asgjë më shumë.

Kush janë bartësit e mendimit konservator në rregullimin e Jugosllavisë në Lidhjen e Komunistëve, e kush janë liberalët dhe cilat janë idetë e njërës, e cilat të grupit tjetër? Sot mbizotëron mendimi se ideja e Rankoviqit për organizimin centralist të Jugosllavisë u mund në Plenumin e Brioneve dhe se fituan forcat që e promovuan reformën dhe federalizimin e vendit. Sa u bazua ky kuptim në faktet historiografike?

Në thelb, nëse bisedën për "konservatorët" dhe "liberalët" në udhëheqjen politike komuniste jugosllave do ta paraqitnim nëpërmjet personaliteteve, atëherë, në një rënje anë, fuqinë konservatore,

në njëfarë mënyre, e ka udhëhequr Rankoviqi, ndërsa në anën tjetër ishte Eduard Kardeli, si njeriu që praktikisht e ka menduar dhe konceptuar çdo kushtetutë dhe strukturë të shtetit jugosllav. Në këtë kontekst, ky koncept i Kardelit për transformimin e shtetit jugosllav, i cili deri në fund të viteve të '50 ishte shumë i centralizuar, në të vërtetë është duhur të shkojë në drejtim të asaj që ndodhi në vitet e '60, e ajo është më shumë pushtet për republikat, dhe në këtë mënyrë forcimi i konceptit federal, gjë të cilën kjo e fundit, rryma konservatore, nuk e mbështeti, duke vlerësuar se një shtet i fortë centralist mund të funksionojë dhe si i tillë do të mbijetojë. Kjo pastaj krijoi një mori çështjesh të tjera, të cilat janë të ndërthurura në aspektin e politikës së personelit, të participimit politik nga të gjitha republikat jugosllave dhe krahinat, por edhe nga popujt... Në këtë kontekst, është e qartë se ekzistonin këto dy rryma dhe se jo vetëm për shkak të Plenumit të Brioneve, por, në përgjithësi, për shkak të marrëdhënies në Jugosllavi, që nga fillimi e deri në fund të viteve të '60 ky koncept liberal, apo më liberal, të themi ashtu, do të mbizotërojë.

Në ç'masë kanë ndikuar raportet personale të funksionarëve partiakë në politikën e Lidhjes së Komunistëve?

Sa ishin të forta armiqësitë personale ndërmjet tyre dhe sa ishin pasqyruar, dhe sa është formësuar nga këto raporte politika shtetërore? Jam shumë i prirë për të besuar se dëmet më të mëdha janë shkakuar atje ku raportet kanë qenë jashtëzakonisht të forta, ose jashtëzakonisht të afërta. Nëse i shikoni personalitetet që janë udhëheqës komunistë jugosllavë në vitet e '60, atëherë e kuptoni se ata kanë qenë njerëz që e kanë njohur njëri-tjetrin për dekada të tëra, nga diçka e përbashkët në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, deri te ajo që në Luftën e Dytë Botërore kanë vepruar, si bartës të asaj që ata e quajtën revolucion, domethënë revolucionarë, të cilët në përfundim të luftës erdhën në pozitë për ta krijuar pushtetin dhe ta formojnë shtetin në përputhje me bindjet e tyre politike. Është e qartë se marrëdhëniet e tilla ndërmjet tyre në një fazë mund të kenë shkuar në

drejtimin që ne mund ta konsidero-
nim të padëshirueshëm, për shem-
bull, se bëhej luftë për pushtet,
përpjekje që disa nga anëtarët e një
rangu të asaj elite politike të pozi-
cionohen më mirë, apo të gjenden
në pozitë më të mirë... sikur, pra,
këto marrëdhënie personale ta ki-
shin një rolin më të rëndësishëm.
Për shembull, në pozitën e nënkrye-
tarit të Jugosllavisë, Rankoviçin e
zëvendësoi Koça Popoviç, i cili deri
atëherë për një kohë të gjatë ishte
ministër i Jashtëm, dhe atëherë, në
një rast, në "Kujtimet" e tij, thotë se
e pranoi këtë ofertë, për të cilën e
bindën kolegët dhe miqtë e tij nga
udhëheqja politike serbe, ndër të
tjera, edhe me qëllim që nga kjo
pozitë të përipiqet të ndikojë në
ndërrimin e disa pozicioneve të cak-
tuara në kreun ushtarak. Nga këto
kujtime mund të vijmë në përfun-
dim se ne sot e shohim se gjith-
monë kishte konkurrencë personale.
Kudo që keni pushtet dhe kudo
që keni fuqi, përpjekjet për të
ardhur në këtë, apo për ta zotëruar
atë një masë më të madhe patjetër
se prodhojnë edhe mosmarrëvesh-
je, jo vetëm armiqësi politike, por
shumë shpesh edhe private e perso-
nale.

**Një pjesë e mirë e librit, direkt
dhe indirekt, është historia e
shkarkimit të Rankoviçit. A qën-
dron teza e Dobrica Qosiqit, i cili
atëbotë ishte i afërt me Titon dhe
udhëheqjen komuniste serbe, e
cila thotë se goditja në Rankoviçit
ishte goditje ndaj kuadrove serbe
në Lidhjen Komuniste?**

Ky është përfundim logjik, se-
pse, në qoftë se bëhet analizë, e, në
qoftë se doni, edhe analizë e struk-
turës nacionale të kuadrove të cilat
janë shkarkuar pas Plenumit të
Brioneve në vetë kreun e UDB-së,
ajo ishte e nacionalitetit serb, edhe
sepse ajo ishte më shumë e përfaq-
ësuar atje. Ky është një përfundim
matematikor. Por, në kontekstin e
transformimit të federatës dhe sho-
qërisë jugosllave, hapja e hapësirës
për të tjerët, joserbët, për participi-
min e tyre edhe në UDB dhe në poli-
ci nuk mund të kalonte pa këtë lloj
ndryshimi. Ndoshta në një nivel
simbolik, por Rankoviçit ishte, si të
thuash, figura më përfaqësuese e
udhëheqjes politike serbe, por nuk
ishin më të vlefshëm edhe perso-
nalitetet Koça Popoviç, Dobrivoje
Radosavljeviç, apo ndonjë tjetër, që
mbetën në pozicionet e tyre, apo
sikur rasti i Popoviçit, që erdhi në
vendin e nënkryetarit të shtetit. Ajo
çfarë mund të shihet në nivele më të
ulëta, e atë jam përpjekur ta gjur-
moj nëpër libër, është se në disa
vende në Bosnjë-Hercegovinë u fol
se duhet që politikën e kuadrove
edhe në polici, ndër të tjera, bara-
zuar me strukturën nacionale të
zonës së caktuar ku ajo polici ve-
pron. Për shembull, konkretisht
kam sjellë shembuj sipas të cilëve
në zonat perëndimore të Hercego-
vinës 90 për qind të popullsisë e
përbëjnë kroatët, kurse 90 për qind
e policëve ishin serbë. Këtë çeku-
libër dikush është dashur ta hetojë



dhe të bëjë përpjekje për ta ndry-
shuar në kontekstin e këtyre ndry-
shimeve në marrëdhëniet shoqë-
rore në Jugosllavi. Pas Plenumit të
Brioneve, rreth Rankoviçit u krijua
një grup i mbështetësve të tij, por jo
me vullnetin e tyre, shumë prej të
cilëve, në fakt, këtë e kanë interpre-
tuar vetëm në kontekstin e asaj që e
kishte instaluar Dobrica Qosiq, pra
se në fakt ajo ishte një goditje
kundër kuadrove serbe, prandaj
atëherë shtrohet një çështje më e
madhe: çfarë është karakteri i sh-
tetit jugosllav, para dhe pas kësaj?
Pra, a është Jugosllavia ashtu si e
sheh vetëm ndonjëri kuadër parti-
ak – për shembull, si e sheh këtë
Qosiqi – apo Jugosllavia është një
koncept disi ndryshe, përkatësisht
se si në këtë rast do të ndihen po-
pujt tjerë?

**Për publikun e gjerë është pak
e njohur se Rankoviçit ishte anëtar
i Partisë Komuniste shumë përpa-
ra Luftës së Dytë Botërore, dhe për
shkak të ideve komuniste ishte
burgosur gjatë kohës së Jugosllavi-
së monarkike. Ishte një nga figurat
më të rëndësishme në Luftën Na-
cionalçlirimtare dhe jashtëzakoni-
sh i orientuar kah jugosllavizmi.
Ishte i martuar me sllovenen
Becela Ladislav, dhe deri në vdekje
jetoi në Dubrovnik. Shikuar nga ky
këndvështrim, a mund të konside-
rohet ai si njeriu që ishte bartës i
ideve proserbe?**

Unë nuk jam marrë me Ranko-
viçin në atë mënyrë, por kam
ardhur edhe deri te të dhëna të tilla.
Disa njerëz e kanë vlerësuar atë
si personifikim të jugosllavizmit,
duke dëshmuar atë për të cilën ju
oisni – një kuadër serb i martuar
me një sllovene që jeton në Kroaci.
Nga ky këndvështrim, është intere-
sante kjo kombinatorikë, të them
ashtu, por kombinime të tilla mund
të gjenden edhe te disa personalite-
te të tjera që kanë vizione tjera për
Jugosllavinë deri te këto marrëdhë-
nie, ose të paktën për figurat kryeso-
re që e sollën Jugosllavinë në vitet e
'60, edhe pse them: unë nuk e kam
trajtuar shumë këtë çështje në
mënyrë specifike, por kjo çështje në
literaturë megjithatë hapet. Nuk
mendoj se është veçanërisht rele-
vante.

**Pas Plenumit të Brioneve, e për
këtë shkruani mjaft në libër, a
erdhi deri te një reformë brenda
Lidhjes së Komunistëve dhe sho-
qërisë jugosllave?**

Plenumi i Brioneve vërtet është

një ngjarje e rëndësishme dhe në li-
brin tim unë jam përpjekur ta tregoj
dinamikën e vitit 1966. Por, Plenumi
i Brioneve, si i tillë, nuk i inicioi të
gjitha proceset. Është fakt se disa i
theu, por disa kishin filluar që më
herët. Pra, në rastin e Bosnjë-Herce-
govinës, kur flasim për vitin 1966,
zakonisht i referohemi një të ashtu-
quajturit Këshillim i Mostarit nga sh-
tatori i atij viti, në të cilin u diskutua
për këto marrëdhënie në Bosnjë-
Hercegovinë dhe për participimin
e pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve
të ndryshme nacionale. Ai ishte
një proces afatgjatë, i cili kishte
nisur më herët, prandaj edhe çështja
e riorganizimit të partisë ishte
çështje e shtruar më herët, por
Plenumi i Brioneve i dha këtë procesi
një dinamikë të re dhe ndryshe, të
re në kuptimin që disa çështje u
hapën pas Plenumit të Brioneve
dhe ndryshe në kuptimin që disa
nga çështjet e hapura më parë për
një moment u ndalën, u ngadalë-
suan, u lanë mënjanë, derisa të
zgjidhet ajo që unë në libër e quaj
jehonë e Plenumit të Brioneve, e
pastaj më vonë rifilluan. Kjo ndikoi
në atë dinamikë. Në shembullin e
Bosnjë-Hercegovinës kjo shihet më
së miri në të ashtuquajturën hapje
e Hercegovinës Perëndimore, për
shkak se ajo pjesë e Bosnjë-Herce-
govinës, për shkak të situatës në
Luftën e Dytë Botërore, shumë kohë
pas luftës, ishte praktikisht dhe eko-
nomikisht zonë e izoluar shoqërore,
e në vitet e '60 kjo çështje u hap,
përkatësisht edhe Hercegovina
Perëndimore u hap në drejtim të
rritjes së numrit të investimeve. Dhe
tani në mënyrë kronologjike ndodh
që Këshillimi i Mostarit, që pasoi
pas Plenumit të Brioneve, të disku-
tojë pikërisht për atë, prandaj 'fi-
tohet përshtypja se kjo ndodhi pas
ndërrimit të Rankoviçit. E vërteta
është se kjo çështje ishte shtruar
edhe më herët dhe se Plenumi i
Brioneve vetëm se i dha dinamikë të
re.

**Në fragmentet e Plenumit të
Brioneve evidentoni edhe reagi-
met e njerëzve në mbledhjet e parti-
së, nga të cilat shihet qartë se
shumëkush situatën politike e
vlerëson të njëjtë me atë të vitit
1948, kur Titoja iu kundërvu Stali-
nit dhe rezolutës së Informbyrosë.
A është përdorur një analogji e til-
lë? A ka pasur Plenumi i Brioneve
rëndësi të tillë politike, ekonomike
dhe gjeostrategjike sikur "jo" e Ti-
tos në vitin 1948?**

Nuk mendoj ashtu. Plenumi i

Brioneve për nga rëndësia e tillë
nuk mund të krahasohet me vitin
1948, por për nga efektet e prodhu-
ara mund të themi se ka paralele të
ngjashme, për shkak se është një
thyerje e madhe. Ne kemi pasur
thyerje brenda udhëheqjes partiake
edhe para Plenumit të Brioneve. Në
mesin e viteve të '50 i kemi para-
qitjet e Gjiljasit, pas të cilave ai i brak-
tis pozicionet politike dhe shkon në
mërgim politik, por largimi i Gjiljasit
nga komunizmi, të them ashtu, ose
nga Partia Komuniste, nuk ishte
tronditës sikur ky, të paktën sipas
reagimeve që mund të shihen në
nivelin më të ulët. Unë i kam regi-
struar më shumë rastet ku njerëzit
në takimet partiake i referohen vitit
1948 dhe pyesin nëse është e mun-
dur që të ndodhemi përsëri në si-
tuatën si vitin 1948, çfarë do të
ndodhë tani, ngase kjo vërtet ishte
një çarje e madhe, sepse, krahas
Kardelit, Rankoviçit ishte praktiki-
sht figura e dytë e skenës politike
jugosllave, pas Josip Broz Titos. E
nga kjo pozitë, reagimi i tillë ishte i
pritshtëm. Ajo që gjithashtu është
shumë e rëndësishme për këtë lloj
reagimi është një perceptim i
përgjithshëm, i ndërtuar nga Lidhja
e Komunistëve, e që në një masë të
madhe ishte pranuar nga shoqëria
jugosllave, që marrëdhëniet në
Lidhjen e Komunistëve ishin mjaft
monolite, pra se vendimet merre-
shin njëzëri, se të gjithë pajtohe-
shin për çdo gjë. Lidhja e Komuni-
stëve vërtet e kishte një imazh të
tillë. Por, nëse i përcillni marrëdhë-
niet brenda Lidhjes së Komunistëve
duke i ndjekur mbledhjet e tyre, di-
skutimet, grindjet, marrëveshjet
dhe mosmarrëveshjet, atëherë do
ta shihni se ajo nuk ishte edhe aq
monolite ashtu siç pretendohet.
Plenumi i Brioneve dëshmoi për
opinionin se marrëdhëniet në
Lidhjen e Komunistëve nuk janë aq
monolite, dhe këtu është rëndësia e
tij.

**Çfarë ishte dhe a ishte UDB-ja,
ashtu siç besohet tani, polici e
gjithëfuqishme, sekrete, politike
dhe a ka udhëhequr Rankoviçit me
të në mënyrë sovraane, autonome
dhe të tjetërsuar nga pjesa tjetër e
pushtetit?**

Drejtorja e Sigurimit të Shtetit
ishte struktura organizative e siste-
mit të sigurisë brenda Jugosllavisë,
një element, përkatësisht një lidhje
e aparatit represiv të shtetit, e
ngarkuar me ruajtjen e ligjit, paqes
dhe rendit kushtetues të vendit. Për
nga karakteri, ajo është shumë e
ngjashme me çdo polici inteligjen-
te sekrete në vendet e tjera, në të
cilat u ndërtua socializmi. UDB
rrjedh nga Departamenti për
Mbrotjen e Popullit (OZNA), for-
macion që u krijua në fund të Luftës
së Dytë Botërore dhe luajti rol të
rëndësishëm në operacionet e fun-
dit të luftës, por edhe në krijimin e
rendit të ri pas luftës. UDB-ja u tran-
sformua pas Plenumit të Brioneve
dhe u riemërtua Shërbimi i Siguri-
mit Shtetëror; një pjesë e fuqishme
e pushtetit që e kishte pasur deri
atëherë UDB-ja u transferua në po-

lici, një pjesë drejt Shërbimit të In-
teligjencës të Armatës Popullore Ju-
gosllave. Ajo që kam mundur ta
shoh nga dokumentet që nuk janë
të UDB-së, por të organeve politike,
siç është Lidhja e Komunistëve,
është se një pjesë e mirë e shoqëri-
së ose anëtarë të shoqërisë në Bo-
snjë-Hercegovinë, njerëz në pozita
politike, në pozitat e drejtuesve të
ndërmarrjeve të caktuara ekono-
mike, u ankuan për mënyrën e ve-
primit të UDB-së. Në një rast unë
flas për gjendjen në ekonomi; pran-
daj e di që drejtori i Energoinvestit
të Sarajevës është ankuar se ai e ki-
shte ndjenjën se dikush e përcillte
dhe e përgjonte, në Hekurdhën
Zenica gjithashtu, por e gjitha kjo
mua përsëri më ngjan në kontek-
stin e Luftës së Ftohtë, një frikë e til-
lë e armikut të jashtëm, i cili duhet
të vijë dhe papritmas të sulmojë,
dhe pastaj ju përsëri nga brendia
përgatiteni, ndër të tjera, edhe me
këtë veprim të fshehtë. Ky është një
kontekst në të cilin vepronte UDB-
ja. Atë që e tregoi raportimi në Ple-
numin e Brioneve dhe që mund të
shihet nga diskutimet është se në
nivelet e ulëta vërtet ndodhi abuzi-
mi i pushtetit në punën e UDB-së
dhe se ky është momenti i rëndësi-
shëm. Tani e kam fjalën për disa
nga pyetjet e mëparshme. Ndoshta
nuk kishte përgjime në vetë kreun,
por në nivele të ulëta, e kjo e vësh-
tiroi mjaft shpesh komunikimin
normal. E di që një ndërmarrës nga
Bijelina është ankuar se pas çdo bi-
sede me partnerët nga Gjermania
për shitjen e ndonjë produkti të cak-
tuar i është dashur të shkojë në poli-
ci për të rrëfyer në lidhje bisedën e
zhvilluar, edhe pse, siç thotë ai, 95
për qind e bisedave nuk ishin të
lidhura me politikën, por me ekono-
minë. Por, kjo përpjekje e policisë
për të ditur gjithçka çfarë po ndodh-
te atje, për çfarë bisedohet, tregon
në fakt sesa kjo strukturë ishte e
përfshirë në të gjitha sferat e shoqë-
risë, dhe kjo sigurisht që ka pasur
një jehonë edhe në shoqëri në tërë-
si.

**Në fund, një pyetje konkrete
dhe precize, e cila i ngjan më
shumë një bisede të lirshme, por e
cila e di se është atraktive për
lexuesit: A e rrëzoi Titoja Ranko-
viçin?**

Mendoj se këtu ekziston një
përgjigje e thjeshtë në mënyrën
"po" ose "jo". Nga e gjithë ajo që e
shohim të ketë ndodhur në vitet e
'60, është e qartë se një vendim i til-
lë nuk mund të merrej pa mbështet-
jen e Titos. Në fund të fundit, kjo
mund të shihet nga diskutimet e
Titos edhe në Plenumin e Brioneve
dhe më pas, kur dëshirohet që kjo të
justifikohet, përkatësisht për ta pre-
zantuar në mënyrën siç prezantohet.
Mendoj se Rankoviçit ishte një
njeri i dhënë shumë pas ruajtjes
së rendit ekzistues, e kjo, në anën
tjetër, nuk ishte një përgjigje
adekuate për ndryshimet që
ndodhën në vitet e '60. Sipas men-
dimit tim, kjo duhet të ishte një
përçarje e natyrshme ndërmjet një-
rit dhe konceptit tjetër.

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15 dhe 72/15), Pëlqimit të Ministrisë së financave nr. 18-2384/2 të datës 22.02.2018 dhe nenit 37 të Statutit të IPKÇF "SNEZHANA" Drejtori i Institutit publik publikon

SHPALLJE PUBLIKE
Për punësim të

1. Përkëdhelës – numër të realizuesve 1 (një)
2. Logoped – numër të realizuesve 1 (një)

Kushtet e nevojshme:

Kandidatët është e nevojshme të përmbushin kushtet në vijim:

1. **Kushtet e përgjithshme që duhet t'i përmbushin kandidatët me numër rendor 1 (një) dhe 2 (dy)** të përcaktuara me ligj të posaçëm ose marrëveshje kolektive për ofruesit e shërbimeve nga sfera e mbrojtjes së fëmijëve janë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë i aftë fizikisht dhe psikikisht;
- Të njihë gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksion kundërvajtjeje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Të mos i jetë shqiptuar dënimi me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën është dënuar për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht të sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është caktuar sjellje diskriminuese;
- Të plotësojë kushte të tjera të caktuara në aktin për organizim të punës dhe sistematizim të vendeve të punës.

Për vendin e punës me numër 1 (një) – përkëdhelës duhet të përmbushen kushtet e posaçme në vijim edhe atë:

- Kualifikimet profesionale
- Me dhe pa përvojë pune

Për nivelin G1 përkëdhelës kërkohet:

- Arsimit mesëm (katër vjeçar) dhe licencë të vlefshme për përkëdhelës
- Të posedojë licencë për përkëdhelës.

Për vendin e punës me numër 2 (dy) – logoped duhet të përmbushen kushtet e posaçme në vijim edhe atë:

- Kualifikimet profesionale
- Me dhe pa përvojë pune

Për nivelin A1 logoped kërkohet:

- Arsimit sipëror – 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit – (Logoped i diplomuar, Fakultet të medicinës ose Defektologji i diplomuar, drejtimi defektologji – Fakulteti filozofik)
- të posedojë licencë për punëtor profesional.

2. Orari i punës së përkëdhelësit në ditë është prej ora 08.00 deri në ora 16.00 (35 orë për punë me fëmijë dhe 5 orë pune të mbetura për aktivitetet e tjera programore) gjegjësisht 8 orë në ditë dhe 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte.

Neto pagesa bazë për përkëdhelës me AMP është: 14.480,00 (katërmëbëdhjetë mijë e katërqindetëdhjetë)

Orari i punës së logopedit në ditë është prej ora 08.30 deri në ora 16.30, gjegjësisht 8 orë në ditë dhe 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte.

Neto pagesa bazë e Logopedit me PSP është: 20.056,00 (njëzetmijë e pesëdhjetëgjashtë denarë)

3. Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Lutje
- Biografi të shkurtër (CV)
- Diplomë për arsimin e mbaruar përkatës (kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë të shtetësisë së RM (kopje)
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar masë për siguri ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet deri në IPKÇF "Snezhana" Çair – Shkup, rr. "Xhon Kenedi" nr. 1 përmes postës ose në Institutin.

Shpallja publike zgjatë 5 (pesë) ditë pune duke llogaritur nga dita e publikimit.

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e paraqitjes.

Fletëparaqitjet të cilat nuk do të dorëzohen në afatin e caktuar, si dhe fletëparaqitjet të cilat nuk do të përmbajnë dokumentet e kërkuara do të konsiderohen si të pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit dhe nuk do të merren parasysh.

Shpallës është IPKÇF "SNEZHANA" Komuna e Çairit me seli në rrugën "Xhon Kenedi" nr. 1, personi për kontakt: Miradije Bushi – Mamut, numri i telefonit 02 2622-454

IPKÇF "SNEZHANA"

Në bazë të nenit 14 paragrafi 2 dhe 3, nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – teksti i pastruar ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 167/2015), nenit 20 – g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14 dhe 199/14), dhe në lidhje me Planin vjetor nr. 04-436/1 të datës 23.02.2018, dhe mendimit të pranuar pozitiv për Planin për punësime gjatë vitit 2018 me nr. 12/6 – 2283/7 të datës 20.04.2018, NP "Parqe dhe gjelbërime" – Shpall:

KONKURS PUBLIK me nr. 03/2018
për plotësimin e vendeve të punës në kohë të pa caktuar

1. NP "Parqe dhe gjelbërime" – Shkup ka nevojë për punësimin e:

Nr. rend.	Shifra	Emri i vendit të punës	Nr. i realizuesve
1	KDR.03.05.A01.038	Ndihmës drejtor për punët operative	1

2. Marrëdhënia e punës themelohet në kohë të pa caktuar të angazhimit punes.

3. Marrëdhënia e punës themelohet me orar të plotë të angazhimit punes.

4. Çdo kandidat duhet t'i plotësojë këto kushte të përgjithshme:

- Të jetë nënshkretas i Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të shfrytëzojë gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të jetë i moshës së pjekur madhore;
- Të posedojë aftësinë e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi me ndalesë të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

5. Kandidatët të cilët do të paraqiten për vendet e punës me numër rendor 1, duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me LMP ose me Marrëveshjen kolektive për veprimtaritë komunale dhe kushtet e përcaktuara në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në NP "Parqe dhe gjelbërime" – Shkup, përkatësisht:

Kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe me LMP ose Marrëveshjen kolektive për veprimtaritë komunale për ofruesit e shërbimit publik të kategorisë A janë:

Kualifikime profesionale së paku 240 kredi të fituara sipas EKTs ose të përfunduar nivelin VII/1;

- Përvojë pune, me sa vijon:

Për nivelin A1 së paku katër vite përvojë pune në profesionin, prej të cilave së paku dy vite në vende udhëheqëse pune në sektorin publik, përkatësisht së paku gjashtë vite përvojë pune në profesionin, prej të cilave së paku tre vite në vendin udhëheqës në sektorin privat.

Njohtje aktive të programeve kompjuterike për punë kancelarie, përmes dorëzimit të vërtetimit.

Njohtje aktive të një prej tre gjuhëve që më shpesh shfrytëzohen në Unionin Evropian (gjuhën angleze, frënge ose gjermane).

6. Orari i punës përfshin pesë ditë pune të javës (nga e hëna deri te premtën) dhe do të llogaritet nga ora 7 deri në ora 15.

7. Neto paga themelore për këtë vend pune është në shumën prej 42.140,00 denarë për orar të plotë pune.

8. Kandidatët e interesuar për punësim, duhet të paraqiten në këtë konkurs publik përmes plotësimit të fletëparaqitjes. Fletëparaqitjen për punësim, kandidatët mund ta marrin në zyrat e ndërmarrjes publike ose në ueb faqen www.parkovi.com.mk.

9. Së bashku me fletëparaqitjen, kandidatët duhet të parashtrojnë edhe:

- Biografi të shkurtër;
- Dëshmi për nivelin e përfunduar të arsimit (diplomën në trajtë origjinale ose kopje e verifikuar te noter);
- Vërtetimin për nënshkretësinë e Republikës së Maqedonisë (në trajtë origjinale ose kopje e verifikuar te noter);
- Dëshmi se nuk iu janë shqiptuar dënime për ndalesë të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose të detyrës (në trajtë origjinale ose kopje e verifikuar te noter).

10. Fletëparaqitjen së bashku me shtojcat duhet të dorëzohen personalisht në ndërmarrjen publike ose përmes postës në adresën vijuese: NP "Parqe dhe gjelbërime" – Shkup, bul. Ilinden nr. 104, 1000 Shkup.

Kontakt telefoni: 02/3070 112 , e-maili: covecki.resursi@parkovi.mk.com

Konkursi zgjat 5 (pesë) ditë, llogaritur nga dita e shpalljes së konkursit në shtypin ditorë.

Fletëparaqitjet e dorëzuara me vonesë dhe të plotësuar në mënyrë të parregullt, nuk do të jenë lëndë e shqyrtimit.

NP "Parqe dhe gjelbërime"
UD Drejtor
Ardijan Muça

Në bazë të nenit 21, paragrafi 2 e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/141, 199/14 dhe 27/16) dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Sveti Nikole publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të 1 (një) realizuesi për kohë të pacaktuar në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Sveti Nikole

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Sveti Nikole publikon shpallje për punësim të 1 (një) realizuesi për kohë të pacaktuar për pozitën në vijim

1. **Nëpunës profesional – Psikolog, 1 (një) realizues**

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Sveti Nikole:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të njihë gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e posaçme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Sveti Nikole

-Së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit sipëror, fakulteti psikologji pa përvojë pune;

-Njohtje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë,

Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët përmbushin kushtet për konkurrim. Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrojnë dëshmitë për përmbushje të kushteve, në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

Kandidatët duhet të parashtrojnë dokumentet në vijim:

- Dëshmi të shtetësisë;
- Certifikatë të mjekut;
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit.
- Dëshmi për njohtje të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- Biografi të shkurtër;
- Letër motivimi.

Orari i kohës së punës: orë të punës në javë: 40, koha e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte në mënyrë fleksibile me fillim prej ora 07:30 deri 08:30 dhe mbarim prej 15:30 deri në 16:30.

Shuma në të holla e neto pagesës bazë është 23,181,00 denarë.

Kandidatët e zgjedhur do të lidhin marrëveshje për punësim për kohë të pacaktuar.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar vetë ditën e publikimit). Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm duhet të parashtrohet në arkivin e: IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Sveti Nikole, ose përmes postës në adresën në vijim:

rr. Velko Vllahoviq nr. 38 a Sveti Nikole
(me shenjë "për shpallje") nr. 04-536/3 e datës 02.05.2018.
Personi për kontakt u.d drejtor Melita Stojkova
Kontakt telefoni 072 210 995

Fletëparaqitjet e parashtruara pas afatit, jo të plota dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IP Qendra ndërkomunale
për punë sociale Sveti Nikole
U.D Drejtor
Melita Stojkova

Në bazë të nenit 22 paragrafi 3 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16) dhe pëlqimit të marrë nga MASH nr. 12-1745/2 të datës 22.02.2018, SHF "H. Todorovski Karposh" f. Rankovcë, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për përmbushjen e vendeve të lira të punës në vijim për kohë të caktuar të punës:

1. Një mësimdhënës për 4 (katër) orë mësimore të Gjuhës maqedonase në SHFP f. German
2. Një mësimdhënës për 5 (pesë) orë mësimore të Matematikës dhe 2 (dy) orë mësimore të Fizikës në SHFP f. German

Kandidatët të cilët do të paraqiten në shpallje krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të ketë të mbaruar arsimin përkatës;
- Certifikatë se nuk është i dënuar.

Neto pagesa fillestare me orar të plotë të punës është 20.600 den. Afati për paraqitje është 5 ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtruara pas afatit nuk do të merren parasysh.

Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme të dorëzohen adresën në vijim:

SHF "Hristian Todorovski Karposh" f. Rankovcë, ose personalisht në arkivin e shkollës.

SHF "H. Todorovski Karposh" f. Rankovcë
u.d Drejtor Hristina Mlladenovska

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 54/2013) dhe nenit 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 103/2008 dhe 33/2010) dhe pëlqimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës nr. 12-4143/2 të datës 11.04.2018, SHF "Gjorgji Sugarev" – Manastir, publikon

SHPALLJE
Për praninë të punëtorëve

4. Dy mësimdhënës të mësimi klasor me orar të plotë të punës më së shumti deri më 31.08.2018 dhe me pagesë fillestare 20.649,00;

Orari i punës së mësimdhënësve është me dy ndërrime edhe atë ndërrimi i parë prej ora 7,30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13 ndërsa përfundon sipas numrit të orëve në pajtim me Programin vjetor për punë të shkollës.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune duhet të përmbushen edhe kushtet e posaçme të parapara në nenin 80, 81 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor;

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 30 ditëve duke konsideruar nga dita e përfundimit të shpalljes.

Kontrollimi i njohtjes së gjuhës maqedonase për kuadrin mësimor do të bëhet më datë 17.05.2018 me fillim në ora 10 në lokale të shkollës.

Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrihen personalisht ose përmes postës në adresën: SHF "Gjorgji Sugarev" – Manastir, rr. "Dimitar Vllahov" nr. 32, tel. 047-222-661

SHF "Gjorgji Sugarev"
Manastir

MES SHUMË POLEMIKAVE PËRFUNDOI PA FITUES DERBI MES FC SHKUPIT DHE SILEKSIT

BARDHEKALTËRIT "SHPËRTHEJNË" ME KRITIKA NDAJ STAVREVIT

Ndeshja e cila ishte e rëndësishme për të dyja skuadrat përfundoi 1-1, mes shumë polemikave për referimin nga ana e referit kryesor Aleksandar Stavrev. Gjatë ditës së djeshme, nga radhët e skuadrës nga Çairi paraqitën një vide-material, në të cilën tregojnë se si futbollistët e Sileksit shtrihen në fushë gjatë 25 minutave, ndërsa ndërprerjet zgjatnin shumë, kurse të gjitha këto i lejonte referi Stavrev



këto i lejonte referi Stavrev. Ata nëpërmjet një reagim, pyesin referin Stavrev, 'se a do të referonte kështu në ndeshje ndërkombëtare?'. "Sot në ndeshjen e javës së 32-të, ndodhi vjedhje klasike, edhe atë nga arbitri që në fanellën e tij të zezë mban emblemën e FIFA-s, Aleksandar Stavrev. Se vjedhja ishte klasike në prani të më shumë se 2000 tifozëve, sjellim edhe videon ku kemi mbledhur momentet me ndërprerjet, zhagjitjet, shtrirjet dhe aktrimin në fushë të futbollistëve të Sileksit, e që gjithçka ishte në regji të 'Hitçkokut', në këtë rast Aleksandar Stavrevit. Këtë nuk e themi vetëm ne dhe ata që ishin në stadium, por ky është edhe mendimi i gazetarëve që ishin pre-

zent në këtë përballje me shumë peshë për dy ekipet, ku nuk u la të fitojë më i miri. Gjatë 90 minutave lojë, çdo 5-10 minuta mund të shihet skena e njëjtë, kur lojtarët mysafir shtriheshin në fushë, ndërsa rolin kryesor në dramën e sotme e luante aktori (portieri) i Sileksit, Mitrovic që 'vodhi' shumë minuta në çdo situatë kur kthente me vonesë topin në lojë", thonë nga FC Shkupi. Në reagimin e tyre, nga skuadra e Çairit çuditen se si është e mundur që nga gjashtë minutat shtesë që i kishte treguar Stavrevi, të zhvillohen vetëm tre. "Duke parë skena të tilla që ishin në numër të shumtë, në vend se të jepen më së paku 10 minuta shtesë, Stavrevi merr tjetër vendim skandaloz,

duke treguar vetëm 6 minuta vazhdim. Mirëpo, skandali nuk ndalet këtu, pasi në harkun kohor prej 6 minutave shtesë, u zhvillua vetëm 3 minuta futboll efektiv. Do e lëmë videon të titulluar "NO COMMENT", ku janë 25 minuta e 19 sekonda lojë pasive, ndërsa Stavrevit do ti parashtrijmë vetëm një pyetje: Aleksandar Stavrev a do të kishte guxuar të referosh kështu në ndonjë ndeshje ndërkombëtare?", thuhet në reagimin e klubit nga Çairi. Ndërkohë, pas këtij barazimi Sileksi ka 46 pikë dhe vazhdon të qëndrojë në pozitën e tretë, derisa FC Shkupi me 38 pikë, mban pozitën e shtatë, katër më pak se pozita e katër që dërgon në Liga Evropë.



Mustafi shpreson të luajë në Botëror

Kampionati Botëror po afron, por Shkodran Mustafi nuk e di ende nëse do të jetë pjesë e tij, apo jo. Konkurrenca në mbrojtjen e Përfaqësueses së Gjermanisë është e jashtëzakonshme dhe gjasat që futbollisti shqiptar të jetë pjesë e evenimentit më të rëndësishëm të futbollit botëror nuk janë shumë të mëdha. Sidoqoftë, futbollisti shqiptar nga Maqedonia po mundohet ta japë maksimumin tek Arsenali për ta bindur trajnerin Joakim Lev që ta ftojë në evenimentin, i cili do të mbahet muajin tjetër në Rusi. "Shkodran Mustafi dëshiron absolutisht të shkojë në Botëror. Megjithatë, mundësitë për të janë të vogla. Por, shpresa mbetet gjallë", shkruan e përditshmja gjermane "TZ" në versionin e saj online, ku ia ka kushtuar një shkrim ish-futbollistit të Evertonit, Sampdorias dhe Valencias. Fatmirësisht, kampioni botëror është ende i ri. Ai është 26 vjeç dhe nëse vazhdon me formë të mirë mund të luajë për Gjermaninë edhe pas katër vjetësh, kur të jetë 30 vjeç, në "Botërorin 2022". Megjithatë, fokusi i tij është te "Rusia 2018". Ai dëshiron ta bëjë krenare vajzën e tij njëvjeçare, duke u shpallur kampion bote dy herë, pasi e bëri një gjë të tillë para katër vjetësh në Brazil me "Die Mannschaft". Sigurisht, vajza e tij nuk e di ende se çka do të thotë të jesh e bija e një kampioni botëror. "Kjo do të jetë njëra prej detyrave më të vështira si baba. Nuk është e lehtë kur të gjithë personat duan të bëjnë foto me ty: unë jam babai dhe ajo personi më i afërt imi", thotë Mustafi. Ndërkohë, Shkodran Mustafi njihet si një futbollist me fat të madh. Ai ishte pjesë e Kombëtares së Gjermanisë në "Botërorin 2014" vetëm falë lëndimit të Marko Reusit në atë kohë. Ndërsa, shkoi në "Evropianin 2016" pasi iu falënderua lëndimit të Mats Hummelsit. Tash duket se futbollisti shqiptar nga Maqedonia mund t'ia shohë hairin lëndimit të Zherom Boatengut dhe të ftohet në Botërorin e Rusisë. Me siguri besimi i tij i madh në Zot do ta ndihmojë. Para fillimit të lojës ai gjithmonë këndon ajete kuranore.

QATIP OSMANI FLET PAS FITORES NDAJ RABOTNIÇKIT

Kjo është Shkëndija që duam ta shohim të gjithë

Shkup, 3 maj - Pavarësisht se i ka mbyllur hesapet me titullin kampion, Shkëndija nuk ka ndërmend të ulë ritmin dhe është rikthyer menjëherë te fitorja. Kuqezinjtë kanë mposhtur në shtëpi Rabotniçkin, me rezultatin e pastër 3-0, falë golave të shënuar nga Zhunior, Todorovski dhe Alimi, ndërsa miqtë e mbyllën takimin me 10 futbollistë, pas kartonit të kuq të marrë nga Sadiki në minutën e 66'. Trajneri i Shkëndijës, Qatip Osmani pas përfundimit të ndeshjes vlerësoi se ky është modeli si duhet të luajë skuadra, pavarësisht se vazhdon të bëjë rotacion në formacion duke u dhënë shans të luajnë gjithë futbollistëve.

"Jo vetëm unë, por kjo ishte Shkëndija që duam ta shohim të gjithë. Lojë e mirë, e hapur, me aksione të rrjedhshme dhe shumë shanse shënimi. Fituam bindshëm edhe pse po të kishim shfrytëzuar gjithë rastet fitorja do të ishte edhe më e thellë. Sigurisht jemi të kënaqur dhe duam të vazhdojmë me këtë rritëm, pa marrë parasysh se do të vazhdojmë me rotacionin në formacion për të pritur sa më të përgatitur finalen e Kupës", deklaroi pas ndeshjes trajneri Qatip Osmani. Osmani ka bërë thirrje vazhdimisht që skuadra të mos e ulë ritmin, në pritje të finales së Kupës, që do të luhet më 23 maj ndaj Pelisterit.





REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMUNA E KISELLA VODËS

rr. "Petar Deljan" nr. 17, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë, tel. ++389 2 2785-400; faks: ++389 2 2785 471 www.kiselavoda.gov.mk / contact@kiselavoda.gov.mk

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune - tekst i pastruar (Gazeta zyrtare e R.M. nr. 167/2015), nenit 57 paragrafit 1 alineja 20 të Statutit të Komunës së Kisella Vodës (Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit numër 8/05 dhe Lajmëtari zyrtar të Komunës së Kisella Vodës numër 13/2006) dhe Vendimit numër 04-4006/1 nga 02.05.2018, Komuna e Kisella Vodës publikon

SHPALLJE

Për pranimin e 1 (një) punëtorit për kohë të pacaktuar

1. Për vendin e punës **voztës II të sekretarit të komunës në departamentin për punë të përgjithshme në Sektorin për furnizime publike dhe punë të përgjithshme të Komunës së Kisella Vodës**

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, kandidatit duhet të përmbushë edhe kushtet e përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në administratën komunale të Komunës së Kisella Vodës:

Kushtet e posaçme

- Lloji i arsimit: arsim i mesëm – drejtimi i makinerisë (180/240 ECVET/MKSOO);
- Përvojë pune së paku prej 1 vit në sektorin publik ose privat;
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera profesionale duke përfshirë edhe kualitetet personale:

- Aftësi për punë ekipore;
- Leje të vozitjes të kategorisë "B"

Orari i punës me kohëzgjatje prej 40 orësh në javë nga e hëna deri të premten gjegjësisht 8 orë pune në ditë me fillim prej 8.30 deri 16.30. Neto pagesa bazë e punëtorit do të jetë 21.120 denarë.

Kandidatët e paraqitur dokumentet e nevojshme (biografi e shkurtër, fotokopje e diplomës për arsimin e përfunduar, fotokopje të nënshtetësisë dhe lejes së vozitjes, kontakt telefoni dhe dokumentet e tjera) ti dorëzojnë në arkivin e Komunës Kisella Voda me seli në rr. "Petar Deljan" nr. 17, Shkup.

Me kandidatët që kanë dokumentacion të rregullt dhe përmbushin kushtet e lartpërmendura do të realizohet intervistë për çka do të njoftohen.

Vërtetimi mjekësor dhe dëshmia se nuk është shqiptuar vendim i plotfuqishëm gjyqësor për kryerjen e veprimtarisë, do të dorëzojë kandidati i cili do të lajmërohet se është zgjedhur.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë nga dita e shpalljes në shtypin ditor.

Punëdhënësi do të kryejë zgjedhjen në një afat prej 45 ditësh pas përfundimit të afatit për paraqitje. Dokumentet jo të kompletuara dhe që nuk dorëzohen me kohë nuk do të shqyrtohen.

Kryetari i Komunës Kisella Voda
Filip Temellkovski



Republika e Maqedonisë
Ministria e Drejtësisë – Drejtoria për udhëheqje të librave amë

SHPALLJE PUBLIKE

Ministria e Drejtësisë – Drejtoria për udhëheqje të librave amë në pajtim me nenin 22 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare nr. 27/2014 dhe 199/2014) publikon shpallje publike për punësim të dy personave në Drejtorinë për udhëheqje të librave amë për kohë të caktuar edhe atë:

- **UPR0101V04000** Bashkëpunëtor i ri për punë në librat amë me arsim sipëror të mbaruar me së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, Fakulteti juridik, (1) realizues
- **UPR0101V04000** Bashkëpunëtor i ri për mirëmbajtjen e IT rrjetit me arsim sipëror të mbaruar me së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, Fakulteti i informatikës, (1) realizues

Kandidatët do të punësohen për kohë të caktuar deri më 31.12.2018.

Kandidatët e interesuar të parashtrojnë letër interesi, biografi të shkurtër dhe certifikatë për arsimin e mbaruar. Dokumentacioni i kompletuar të parashtrohet përmes postës ose personalisht në adresën: **Drejtoria për udhëheqje të librave amë, rr. "Sv. Kiril i Metodi" nr. 54 hyrja 1, Shkup me shejër për shpallje për kohë të caktuar.** Shpallja zgjatë 5 ditë nga dita e publikimit.

U. D Drejtor
Bujar Dardhishta

Në bazë të nenit 17 të Rregullores për mënyrën dhe realizimin e ekskursioneve shkollore dhe aktiviteteve tjerat lira të nxënësve të shkollave fillore dhe Programit për realizimin e ekskursioneve shkollore SHF "Goce Dellçev" Gostivar, shpall :

SHPALLJE
Ftesë për dorëzimin e ofertave

Për grumbullimin e ofertave për realizimin e ekskursionit për nxënës të klasës së tretë, gjashtë dhe klasës së nëntë.

Kriteret për dhënie të kontratës për realizimin e ekskursionit është çmimi më i ulët.

Komisioni si ofertes më të volitshëm i cili i plotëson kriteret në pajtim me nenin 19 të Rregullores së lartpërmendur do ta zgjedh atë i cili i plotëson minimum kriteret në vijim:

- Të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në R.M. për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse turistike;
- Të ketë realizuar me sukses së paku 3 ekskursione në tre vitet e fundit;
- Të plotësojë kushtet për transport të grupeve me fëmijë në pajtim me Ligjin për sigurim në komunikacion rrugor dhe me Rregulloren për kërkesa të veçanta teknike për automjetet me te cilat behet transporti i grupeve të fëmijëve;
- Garanci bankare për realizim kualitativ të kontratës prej 5% të vlerës së kontratës, do të dorëzojë ofertesuesi i zgjedhur, garancia do të kthehet më së voni 7 ditë pas realizimit të marrëveshjes;
- Oferta e ofertesuesit i cili nuk përmbushë kushtet minimale do të refuzohet nga ana e komisionit si e papranueshme.

Informata plotësuese dhe marrja e **specifikimeve** me kushtet e kërkuara për ekskursionet merren në lokalet e në SHF "Goce Dellçev" Gostivar çdo ditë pune prej ora 09 deri në ora 15 apo në e-mail: goce.dellcev.gv@gmail.com
Oferta për shpalljen duhet të dorëzohet në SHF "Goce Dellçev" Gostivar, rr. "Braqa Blazheski" nr. 6, në zarf të brendshëm të mbyllur me emrin e ofertesuesit ndërsa në zarfin e jashtëm me shenjë – MOS HAP për Komisionin për grumbullimin e ofertave për ekskursione për nxënës.

Shpallja zgjatë pesë ditë nga dita e publikimit.

SHF "Goce Dellçev" Gostivar
Komisionin për realizimin e procedurës për grumbullimin e ofertave për zgjedhje të subjektit juridik për realizim të ekskursioneve

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 74/2015), nenit 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 56/12, 100/12, 24/13, 14/14, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15 dhe 30/16) SHFK "Kiril i Metodi" Sveti Nikole publikon

SHPALLJE

për plotësimin e vendeve të punës për kohë të caktuar të punës

1. Një mesimdhënës për 14 orë për art figurativ deri më 31.08.2018 gjegjësisht deri në kthimin e punëtorit që mungon nga pushimi mjekësor me pagesë prej 14.451 denarë.
2. Një mesimdhënës për 2 orë për art figurativ në paralelet për nxënësit me nevoja të posaçme deri më 31.08.2018 gjegjësisht deri në kthimin e punëtorit që mungon nga pushimi mjekësor me pagesë prej 2.064 denarë.
3. Një mesimdhënës për 4 orë – Projekte të artit figurativ deri më 31.08.2018 gjegjësisht deri në kthimin e punëtorit që mungon nga pushimi mjekësor me pagesë prej 4.129 denarë.
4. Një mesimdhënës për gjuhë angleze për 20 orë deri më 31.08.2018 gjegjësisht deri në përfundimin e mandatit të u.d drejtorit.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet pe parapara në Ligjin për marrëdhënie pune dhe Ligjin për arsim fillor. Orari i punës është prej ora 07 deri në ora 13.

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 7 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.

SHFK "Kiril i Metodi" Sveti Nikole
rr. Angell Trajçev nr. 40, Sveti Nikole

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë

SHPALL

Kërkesën për dhënie e Lejes për shfrytëzim të ujit për kultivimin e troftës së lumit dhe troftës Kaliforniane, në fshatin Smillanci, Radovish, shpknjp "Pema Elektrik" njësia rajonale "Suva Livada" Radovish.

Në pajtim me nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit të ujërave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14, 146/15 dhe 52/16), deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë është dorëzuar kërkesë pr dhënie e Lejes për shfrytëzimin e ujit për kultivimin e troftës së lumit dhe troftës Kaliforniane në fshatin Smillanci PK 1104, KK Smillanci, Komuna Radovish, me nr. UP1-11/5-33/2018 më 12.01.2018.

Parashtrues i kërkesës:

shpknjp "Pema Elektrik" njësia rajonale "Suva Livada" Radovish.

Pika mesatare ku merret uji është në koordinatat
Y=634452.69 X=617845.76

Vendi ku lëshohet uji është në koordinatat
Y=634501.03 X=617807.88

Informata në lidhje me kërkesën, opinionin i interesuar mund të marrë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në e-mail M.Seadini@moepp.gov.mk

Opinionin i përfshirë, në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të kërkesës, ka të drejtë të dorëzojë mendime dhe komente në formë me shkrim deri në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, bulevardi "Goce Dellçev" nr. 18 ndërtesa e RTM (kati 10), 1000 Shkup.

Në bazë të nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/41, 199/14 dhe 27/16) dhe nenit 14 paragrafi 1, nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), nenit 110-g dhe 110-e të Ligjit për mbrojtje sociale ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 72/15, 104/15, 105/15, 173/15, 192/15 dhe 30/16), pas Pëlqimit të marrë nga Ministria e financave nr. 18-1398/2 të datës 20.02.2018, dhe Vendimit të UD Drejtorit të IP Enti special Demir Kapia, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE
Për punësim të:

1. 1 (një) realizues për kohë të pacaktuar për vendin e punës – motër medicinale
Kandidatët të cilët do të konkurrojnë për vendin e punës, është e nevojshme të përmbushin Kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligj:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë dhe detyrës.

Shpallja publike zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.

- Fillimi dhe mbarimi i orarit ditor dhe javor të punës të motër medicinale është puna me tre ndërrime ose 40 orë në javë

Ndërrimi i parë prej ora 6,30 deri në ora 14,30

Ndërrimi i dytë prej ora 12,20 deri në ora 19,20

Ndërrimi i tretë prej ora 18,30 deri në ora 6,30

- shuma në të holla e neto pagesës fillestare për motër medicinale është: 14.816,00 denarë.

2. **Kandidatët obligohen të parashtrojnë dëshmi përkatëse në formë origjinale ose kopje të vërtetuar në noter, si për përmbushjen e kushteve të përgjithshme, ashtu edhe të parashtrojnë dëshmi për përmbushjen e kushteve të posaçme, edhe atë:**
-Për motër medicinale për nivelin B2 së paku niveli i kualifikimeve IV, 240 kredi sipas ECVET ose MKSOO ose arsim të mesëm katërvjeçar (arsim i mesëm i medicinës) pa përvojë pune

- Diplomë/Certifikatë/Dëftesa për shkallën e mbaruar të arsimit përkatës që kërkohet për vendin e punës;
- Shtetësi dhe
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë gjyqësore për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës – jo më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj.

Dokumentet e kërkuara parashtrohen me zarf të mbyllur me shenjë "Të mos hapet" në adresën në vijim:

IP Enti special Demir Kapia

rr. Naum Naumovski nr. 4

Demir Kapia

Arkivi i Institucionit

(me shenjë "për shpallje")

Letërpërparaqitja dhe dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

IP Enti special Demir Kapia

UD Drejtor

Aleksandra Vellkovska

Në bazë të nenit 385, nenit 387, nenit 388 nga Ligji për Shoqata tregtare ("Gazeta zyrtare e RM numër 28/04), nenit 46 dhe nenit 47 të Statutit të SH A Konfeksioni "Edinstvo" Strugë nr. 01-165 të datës 01.11.2010 dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 02- 15/3 të datës 30.04.2018, Këshilli Drejtues i SH A Konfeksioni "Edinstvo" Strugë publikon:

THIRRJE PUBLIKE

Për mbajtjen e Kuvendit Vjetor të shoqatës së aksionarëve

Kuvendi do të mbahet më datën 30.05.2018 (e mërkur) në ora 13.00 në lokalet e SH A Konfeksioni "Edinstvo" Strugë në selinë e shoqatës në rr. "Marshall Tito" nr. 118 Strugë në vijim me këtë:

RENDI TË DITËS

1. Miratim i propozimit për rendin e ditës së Kuvendit,
2. Zgjedhja e Udhëheqësit të Kuvendit,
3. Verifikim i listës së aksionarëve prezent gjegjësisht të të autorizuarve të tyre,
4. Përcaktim i numrit të votave për punë dhe vendim të Kuvendit (kuotë) të Shoqërisë,
5. Përcaktim të numëruesve të votave,
6. Debat dhe sjellje të Vendimit për miratim të llogarisë përfundimtare vjetore dhe raportit vjetor për punën e shoqërisë në vitin afarist 2017,
7. Sjellje të Vendimit për mbulimin e një pjese të humbjeve nga vitet e kaluara në barrë të fitimit të përgjithshëm të akumuluar dhe në barrë të fitimit për vitin financiar.

Materialet sipas të cilave do të debatohet në Kuvend të aksionarëve nga pika 6 e rendit të ditës, aksionarët mund t'i shohin në selinë e shoqërisë çdo ditë pune prej ora 12.00 deri në ora 15.00. Propozimet nga pika 2 e rendit të ditës të dorëzohen deri tek organizatori i Kuvendit në afat prej 8 (tetë) ditëve duke llogaritur nga dita e mos dërgimit të ftesës gjegjësisht nga dita e publikimit të thirrjes publike për pjesëmarrje në Kuvend. Në mbledhjen e Kuvendit mund të merr pjesë çdo aksionar personalisht ose të përfaqësojë person i cili do ta përfaqësojë në Kuvend me autorizim të vërtetuar në noter.

Secili aksionar ose përfaqësues i aksionarit është i obliguar që prezencën e tij të mbledhje të Kuvendit ta paralajmërojë së paku 3 (tre) ditë para mbajtjes së Kuvendit në selinë e shoqërisë, në orar të punës.

SH A Konfeksioni Edinstvo Strugë
Kryetar i Këshillit Drejtues
Fazli Rakipi



**REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMUNA E BOGOVINËS**

nr. 11-2395/9-3
16.04.2018 viti

Në bazë të nenit 69 nga Ligji për mjedis jetësor ("Gazeta Zyrtare e RM. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 51/11, 123/12 и 93/13, 42/14, 44/15, 129/15 dhe 39/16) dhe Rregullorja për pjesëmarrje të publikut gjatë përgatitjes së rregulloreve dhe akteve të tjera, si dhe planet dhe programet nga fusha e mjedisit jetësor ("Gazeta Zyrtare e RM. 147/08"), Kryetari i Komunës së Bogovinës

ORGANIZON

Shqyrtim publik dhe diskutim publik mbi Draft Raportin mbi vlerësimin strategjik për mjedisin jetësor për PK nr. 249, 250/1, 250/2, 251/1, 251/2, 252, 253, 254, 255, 256 dhe 257, KK Kamjan jasht r.n. Komuna e Bogovinës.

Raporti për vlerësimin Strategjik të ndikimit të mjedisit jetësor, është ekspozuar në Komunën e Bogovinës çdo ditë nga ora 8:00 - 16:00 në periudhë prej 16.04.2018 deri 16.05.2018vit.

Diskusim publik do të mbahet më 07.05.2018vit në Komunën e Bogovinës, me fillim në ora 12.00.

Personat juridik dhe fizik dhe publiku mund të dorëzojnë mendimin e tyre në lidhje me Raportin deri te Komuna e Bogovinës në periudhën e shqyrtimit prej 30 ditë.

Të gjithë palët e interesuar janë të ftuar të marrin pjesë në diskutimin publik dhe të japin mendimin e tyre, vërejtjet dhe propozimet mbi Raportin për vlerësimin Strategjik të ndikimit të mjedisin jetësor dhe të nejtjet mund ti dërgoni në e-mail: abazi.feti@gmail.com, ose me postë në adresën e mëposhtme: Skenderbeg 101, 1220 Bogovinë.

KOMUNA E BOGOVINËS
Kryetar
Albon Xhemali



Deri tek: Nova Makedonija AD Shkup
Lënda: konkurs

Të nderuar,
IP Qendra e Informativ-Kulturor - Shkup, dëshiron të shpallë një konkurs për regjistrimin e artistëve kulturorë nga të gjitha fushat që duan të aplikojnë me programin e tyre në QIK -Shkup.

Grupi artistik:
organizimi:
institucioni:
Shteti:
ADRESA:
Tel / Fax:
E-mail / Website:
të dhënat:
Kategoria (Ju lutem zgjidhni një)
Artet vizuale dhe të aplikuara muzikë
- Jazz / Bashkëkohore
- Pop / Rock
- Klasike
- Muzikë qytetare
- Elektronike / DJ
Arti publik dhe pikat urbane
- Baleti / Dance Moderne
- Teatri i Kukullave
- Mjuzikëll
- Shoqëri kulturore artistike - vallëtar
- Të tjerë
Përshkrim i shkurtër i veprave të artit:
Lista e pajisjeve dhe lokacioneve të nevojshme teknike (hapësira ekspozuese ...)
Numri i pjesëmarrësve:
Data e mbërritjes: (për pjesëmarrësit nga jashtë)
Data e kthimit: data (për pjesëmarrësit nga jashtë)
Serminë Purini, drejtor

Shpallja e konkursit:
IP Qendra e Informativ-Kulturor - Shkup I fton të gjithë artistët nga të gjitha drejtimet artistike (poetët, artet vizatimore dhe muzikore, grupet, ansamble folklorike dhe orkestra, DJ dhe interpretues të tjerë) të konkurrojnë me projektet e tyre në QIK - Shkup deri më 30.06.2018 për manifestimet:
Nëse doni të jeni pjesë e PROJEKTEVE: "Vijmë...", "Tingujt e Çarshisë", "Instalacion – pa kufi" dhe "Shkupi lexon", me idea dhe projektet e juaja aplikoni në:
kicgov@gmail.com
info@kic.mk
tel..02/3238158
Për të marrë pjesë në thirrje, artistët duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:
- një biografi e të dhënave personale të artistit ose grupit
- fotografi, skica dhe vizatime
- materiale promocionale (nëse ka): katalog, broshurë, komente, komente ...
- aplikacion i plotësuar dhe i nënshkruar (në vazhdim)

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – tekst i pastruar ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167 e datës 28.09.2015 si dhe ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për marrëdhënie pune "Gazeta zyrtare e RM" nr. 27 e datës 15.02.2016), Shtëpia e studentëve "Koço Racin" Manastir publikon

SHPALLJE

Për punësim të punëtorit në vijim

Një (1) Mjeshtër të përgjithshëm për kohë të pacaktuar me 40 orë pune në javë, punë me ndërrime (ndërrimi i parë dhe ndërrimi i dytë), me arsim të mesëm të mbaruar të elektroteknikës dhe 2 vjet përvojë pune.

Krahas kushteve të lartpërmendura të posaçme, të parapara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në Shtëpinë shtetërore të studentëve "Koço Racin" Manastir nr. 01-74/1 të datës 31.01.2018 kandidatët e interesuar duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme për punësim të punëtorëve në pajtim me LMP.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët e interesuar duhet të parashtrajnë edhe:

1. Lutje
2. Certifikatë të lindjes (Original ose kopje të vërtetuar në noter)
3. Certifikatë të shtetësisë (Original ose kopje të vërtetuar në noter)
4. Dëftesë për arsim të mbaruar (Original ose kopje të vërtetuar në noter)]
5. Dëshmi për përvojën e punës, duke theksuar përvojën e punës dhe kohëzgjatjen e asaj përvoje, të dhënë nga kompania, institucioni – organi, me të cilën dëshmohet se personi – kandidati ka arritur përvojë pune (Original ose kopje të vërtetuar në noter)
6. Dëshmi se nuk u është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Fletëparaqitjet e dorëzuara me vonesë si dhe ato të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Dokumentet e nevojshme nga Shpallja, parashtrohen deri në arkivin e Shtëpisë, në Ndërtesën administrative, rr. Studentska nr. 2 Manastir, tel. 047 255 132,

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune, duke filluar nga dita e publikimit në shtypin ditor, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.

Drejtor,
Sonja Karapeç

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, Vendimit për nevojën për punëtorë nr. 05-536/1 të datës 23.04.2018, nenit 23 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe nenit 34 të Statutit të NP Komunalec, Kavadar ndërsa në pajtim me Rregulloren për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës, UD Drejtori i ndërmarrjes, publikon

SHPALLJE

Për pranin të punëtorit

I . NP Komunalec – Kavadar ka nevojë për pranin të një realizuesi për kohë të caktuar prej 6 (gjashtë) muajve edhe atë për vendet e punës në vijim:

1. "Ekolog" në departamentin për hortikulturë, Sektori për Higjienë Komunale, 1 (një) realizues, shifra e vendit të punës KDR 03 05 B 01 034, me neto pagesë fillestare prej 24.040,00 denarë,

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
Për vendin e punës të ketë kualifikime profesionale të shkallës së VII/1, 240 kredi të fituara sipas SETK arsim sipëror për pylltari ose hortikulturë.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune, duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes në tabelën për shpallje të ndërmarrjes dhe në shtypin ditor në tri gazeta ditore prej të cilave një në gazetën që publikohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që e flasin gjuhën zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase.

Zgjedhja do të realizohet në pajtim me nenin 23 paragrafi 2 i Ligjit për marrëdhënie pune gjegjësisht nëse në shpalljen publike janë paraqitur deri në 200 kandidatë për një vend pune zgjedhja e kandidatëve bëhet në afat prej 45 ditë, prej 201 deri në 500 kandidatë për një vend pune bëhet në afat prej 90 ditë dhe mbi 500 kandidatë për një vend pune bëhet në afat prej 120 ditë, pas kalimit të afatit për paraqitje. Kandidatët fletëparaqitjet me të gjitha dokumentet duhet t'i parashtrajnë në adresën: NP Komunalec Kavadar, rr. "Industriska" pn, Kavadar, personalisht në arkiv ose përmes postës. Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit dhe të paplotësuara nuk do të merren parasysh.

NP Komunalec Kavadar
UD Drejtor
Gjorgji Pop Icov

Institucioni publik Muzeu i Qytetit të Shkupit, në bazë të Programit të punës së Institucionit për vitin 2018 dhe Programit për kulturë të Qytetit të Shkupit për vitin 2018, dhe në suaza të projektit "Shënimi i 26 Korrikut", shpall:

Thirrje publike

për zgjedhjen e skenarit me realizim e aktiviteteve për "Shënimi e 26 Korrikut" – 55 vjetori i tërmetit katastrofal në qytetin e Shkupit

Qëllimi i thirrjes publike: Me qëllim të krijimit të një platforme të gjerë dhe të përfshirjes së koncepteve të reja dhe kreative për shënimin e 55 vjetorit nga tërmeti katastrofal në qytetin e Shkupit, i datës 26 korrik të vitit 1963, thirren të gjithë subjektet dhe personat juridik të interesuar në Republikën e Maqedonisë, të parashtrajnë propozim projekte për zgjedhjen e skenarit me realizim e tij, me këtë të njëjtit do të inkuadrohen në projektin për shënimin e kësaj date dhe do të kontribuonin për ngritjen e cilësisë së programit të lartpërmendur.

Të drejtën e pjesëmarrjes: Të gjithë subjektet dhe personat juridik. Dokumentet e nevojshme:

- Propozim skenari me përshkrimin e aktiviteteve të propozuara
- Konstruksioni financiarë për realizimin e aktiviteteve

Kriteret për zgjedhjen e propozim – projekteve të cilat do të përfshihen në Kriteret për zgjedhjen në shënimin e tërmetit katastrofal në qytetin e Shkupit:

- Kompatibiliteti i skenarëve të propozuar me aktiviteteve e planifikuara në temën: "Shënimi i tërmetit në qytetin e Shkupit";
- Inovacionet e propozim skenarit me të cilat do të ofrohen përmbajtje aktuale dhe tërheqëse për qytetarët e Shkupit, nga të gjitha grup moshat;
- Oferta e përmbajtjeve me mjete të ndryshme dhe bashkëkohore të shprehjes artistike.

Thirrja publike zgjat 20 (njëzet) ditë nga dita e shpalljes. Propozim projektet duhet të dorëzohen deri te I.P. Muzeu i Qytetit të Shkupit, përmes postës në adresën: rr. "Shën Qirili dhe Metodi" p.n. ose në Arkivin e I.P. Muzeu i Qytetit të Shkupit, më vonë deri në ora 15:00 të ditës së fundit të thirrjes publike.

Komisioni i përbërë nga përfaqësuesit e I.P. Muzeu i Qytetit të Shkupit dhe nga Qyteti i Shkupit, do të realizojnë përzgjedhjen e skenarit, të cilin do ta realizojë subjekti i zgjedhur.

Propozimet me të dhëna të pa plota, si dhe propozimet të cilat do të dorëzohen me vonesë, nuk do të jenë lëndë e shqyrtimit.

Informacione plotësuese mund të siguroni në e – mailin: mgs@mgs.org.mk dhe në tel. 02 3115367
Mjetet për realizimin e aktiviteteve i siguron I.P. Muzeu i Qytetit të Shkupit.

I.P. Muzeu i Qytetit të Shkupit



www.koha.mk
koha@koha.com.mk | marketing@koha.com.mk
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;
Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bal, Goce Delçev rr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhësë, Shkup

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

POKERI I GOLAVE NUK I MJAFTON ROMËS

LIVERPULI NË FINALE ME REALIN

Roma mposhti me rezultatin 4-2 në "Stadio Olimpico", Liverpoolin, duke dalë me nder nga Çampions Liga. Të besuarit e Klopp rigjejnë finalen duke u kualifikuar me rezultatin e përgjithshëm 7-6, pas fitores 5-2 në "Anfield" një javë më parë. Ashtu si ndeshja e parë, edhe sonte spektakli nuk mungoi, me tifozët që u argëtuan, por anglezët e shijuan më shumë, pasi gjejnë në finale pas 11 vitesh



Pavarësisht fitores dhe natës së madhe të "Olimpico", Roma nuk arriti ta eliminojë Liverpoolin, i cili do të shkojë në finalen e Kievit për të sfiduar Real Madridin, në fund të majit. Në kryeqytetin italian skuadra e Eusebio Di Françeskos nuk arriti të realizonte një tjetër përmbysje historike si ajo ndaj Barcelonës edhe pse ja doli të fitonte me shifrat 4-2, por falë suksesit 5-2 në ndeshjen e parë dhe me rezultat të përgjithshëm 7-6, Liverpooli avancoi më tej. Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka pranuar se skuadra e tij ka qenë me fat kundër Romas, por ka thënë se finalja e Çampions Ligës ka qenë e merituar. "E meritojmë 100 për qind finalen. Por, nuk mund të kesh sukses pa fat. Edhe Reali pati fat kundër Bajernit", ka thënë trajneri gjerman. "Tani kemi dy ndeshje të rëndësishme në Premier Ligë dhe më pas kemi finalen. Djemtë bënë një ndeshje të shkëlqyer dhe unë nuk mbaj mend rezultatin! 7-6 apo jo? E pabesueshme?", deklaroi Klopp. Derisa, kolegu i tij, Di Françesko nuk ka dashur të flasë shumë për referimin dhe penaltinë e mundshme për Romën, duke thënë se gabimet i kushtuan skuadrës së tij në fund. "Jemi rritur shumë me këtë eksperiencë, por pendohem sepse se ky ekip është dashur të besojë më shumë në shanset, mund të kishim shënuar më shumë gola dhe të kishim shtyrë Liverpoolin më shumë

prapa", tha ai për "Mediaset Premium". "Unë jam më i zhgënjyeri për këtë eliminim dhe dua t'i përgëzoj lojtarët, sepse të reagosh në këtë mënyrë kundër Liverpoolit, është fantastike, ishim pothuajse perfekt në pjesën e dytë. VAR-i në Çampions? Nuk më takon mua të ngre zërin për këtë, çfarëdo që ne të kishim bërë, gjyqtari nuk do të kishte ndryshuar mendjen. Sigurisht, 20-25 minuta nga fundi me një karton të kuq dhe penalti, ndeshja do të ishte rihapur. Sido që të jetë, ne bëmë gabime gjithashtu dhe këto na kushtuan më shumë", deklaroi trajneri i Romës. Ndërkohë, Ragja Nainggolan shënoi dy gola, por u kërkoi falje tifozëve të Romës për gabimin e tij, kur Mane shënoi për 0-1. Kjo ka bërë që belgu të ndihet fajtor dhe të kërkojë falje tek tifozët pas ndeshjes. "Jam krenar që jam pjesë e këtij ekipi..." shkroi fillimisht Nainggolan në profilin e tij në "Instagram". "Më vjen keq për gabimin që peshonte rëndë në rezultatin përfundimtar. Ne vazhdojmë përpara... Forca Roma", përfundoi mesfushori belg.

SHPËRTHEN PALLOTTA: ARBITRIMI ISHTE I PAPANUESHËM

Roma u eliminua në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve dhe opinionet u ndanë në dy drejtime. Nëse Daniele De Rossi, kapiteni i Romës, nuk ka dyshime për dy pe-

nalltitë e mohuara për ekipin e tij, fytyra e dyshimeve e arbitrimin të slovenit Skomina duket më e spikatur te Florenzi, Fazio dhe presidenti James Pallotta. Dy ditë të vështira për arbitrimin në Çampions, duke pasur parasysh se edhe Real Madrid-Bajern Munih ka parë jo pak polemika, sidomos për një prekje të topit me dorë të Marseles, e pranuar edhe nga vetë braziliani, pas ndeshjes. "Arbitrimi sot ishte i papranueshëm, - tha plot zemërim Pallotta, pas ndeshjes, e cila përfundoi 4-2 për të tjetër. - Unë e di se është e vështirë për të arbitruar, por pse nuk aplikohet VAR. Nuk mund të vazhdohet kështu, përndryshe arbitrat rrezikojnë të bëhen qesharakë". Pallotta, pastaj, e rriti dozën, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar të gjitha episodet e dyshimta: "Ju i keni parë të gjitha imazhet, të gjithë kanë vënë re dy episode, përveç zyrtarëve në fushë. Ata injoruan një faull ndaj Xhekos dhe një "hendboll" shumë të pastër në goditjen e El Shaaravy. Përveç kësaj, ka pasur një ndërhyrje të gabuar ndaj Shik", deklaroi Pallotta.

SALAH, MANE DHE FIRMINO THYJENË REKORDIN E BBC-SË NË ÇAMPIONS

Treshja e sulmit të Liverpoolit e përbërë nga Mohamed Salah, Sadio Mane dhe Roberto Firmino po vazhdojnë të mahnitin me paraqitjet e tyre. Goli i parë i ndeshjes



Federico Fazio

Sa keq për dy penalti që arbitri nuk i akordoi sot për ne. Sa keq gjithashtu që akorduan vetëm tri minuta shtesë. Duhet të kemi vazhdimësi në vitet në vijim. Të mendojmë për vitin e ardhshëm dhe të mësojmë nga gabimet tona. Ky duhet të jetë vetëm fillimi. Duhet të mendojmë pozitivisht dhe të marrim më të mirën e kësaj eksperience. Të ngremë kokën lart dhe të vazhdojmë

u shënuar nga Mane për epërsinë e Liverpoolit 0-1 dhe ku gol ka bërë që të thuhet një rekord i madh në Ligën e Kampionëve. Me golin e senegalezit, treshja e famshme e Liverpoolit Salah-Mane-Firmino kanë arritur në kuotën e 29 golave brenda këtë sezon në garën elitare evropiane, ku egjiptiani dhe braziliani kanë nga 10 gola, ndërsa senegalezi nëntë sosh. Me këto 29 gola, treshja sulmuese e Liverpoolit ka thyer rekordin e mbajtur deri tani nga treshja e njohur e Real Madridit, Bejll-Benzema-Kristiano e njohur si BBC. BBC kishte 28 gola



Monçi

Komplimente Liverpoolit për finale, por ka ardhur moment që futbollit Italian të ngrejë zërin. Ajo që ka ndodhur nuk është normale. Pa gabimet e arbitrave do të kishte ndryshuar gjithçka. Në ndeshjen e parë kemi pësuar një gol në pozicion jashtë loje, këtë herë na kanë mohuar dy penalti. Edhe Juventusit është penalizuar në Evropë: ka ardhur moment të ngremë zërin. Nuk mund të vazhdohet kështu, ne meritonim më shumë

në Ligën e Kampionëve në edicionin 2013/15, atë vit kur Reali arriti ta fitojë edhe trofeun duke mposhtur në finale Atletiko Madridin. Treshja e Liverpoolit ka mundësi të mirë ta thellojë edhe më shumë këtë rekord në finalen e madhe të Ligës së Kampionëve me 26 maj, pikërisht ndaj Mbretërve. Ndryshe, Mane theu edhe një rekord tjetër duke shënuar plot nëntë gola në 10 ndeshjet e tij të parë në karrierën e tij në Ligën e Kampionëve.

24 MAJ 1543, dita kur u themelua shkenca moderne

Nikola Koperniku ndodhet në shtratin e vdekjes. Në duar mban trashëgiminë e tij, botimin e parë të "Mbi revolucionet e sferave qiellore". Ky libër do të ndryshojë historinë e shkencës, do të hedhë në erë të vërteta mbi 1400 vjeçare, dhe do të sigurojë që në të ardhmen, qeniet njerëzore do të jenë në gjendje të dër-

gojnë robotë në mars. Është një libër që e ka shkruar vetë Koperniku - 34 vjet më herët. Përmbajtja e tij është radikale, ai argumenton se Toka rrotullohet përreth Diellit. Bie ndesh me gjithçka në të cilën qeniet njerëzore kanë besuar deri në ato momente. Përse e ka fshehur për një kohë kaq të gjatë këtë vepër? Ai nuk e



thotë. A mos kish frikë mos dukej qesharak?

A kishte frikë nga Kisha? Kur Koperniku ndërroi jetë

në 24 maj 1543, vepra e tij më në fund botohet - dhe hap një epokë të re për shkencën moderne.

Kanabis në zyrë, si antistres për punonjësit



Shumë orë para kompjuterit ju stresson dhe ju lodh, simptoma që nëse i nënvlerësoni mund t'ju çojnë në depresion. Një kompani në Rimini ka vendosur të ndihmojë punonjësit të luftojnë lodhjen nga kompjuteri në një mënyrë të veçantë. Në dispozicion të tyre ka kanabis. Shoqëria, që merret me marketing, ka vendosur si benefit për punonjësit çaj marihuane, biskota dhe aroma. Të gjitha me bazën kryesore të kanabisit, cannabidiol. Ideja e futjes së kanabis për punonjësit ka ardhur nga themeluesi i kompanisë, sipas medias Il Resto del Carlino. Qëllimi është të krijojë një ambient pune të qetë dhe relaksues. Atyre që kanë kritikuar këtë zgjedhje, shoqëria i është përgjigjur se objektivi nuk është ajo "e shtrirjes pas tavolinës", por "garantimi i relaksit", të punonjëseve. Jo rastësisht në këtë kompani nuk ka kartelë që duhet të check-osh, dhe oraret janë mjaft fleksibël, punonjësit kanë një sallë relaksi dhe ftesa falas për diskoteka.

BMW i8, hibridi i mrekullueshëm që kushton 160 mijë euro



BMW ka testuar modelin e saj të ri i8, e cila ka në përbërje dy motorë një elektrik dhe një me benzinë, duke u vlerësuar si një makinë ekologjike. Ajo mund të arrijë deri shpejtësinë në 100 km/orë në 4,6 sekonda dhe arrin një shpejtësi maksimale prej

250 km në orë. E testi i parë i saj në rrugë ka rezultuar 100% i suksesshëm, e tashmë pritet të pushtojë tregjet e automobilizmit ku falë karakteristikave të saj do të jetë shumë i konkurrueshëm, pavarësisht çmimit të kripur prej 160 mijë euro.



Mos qëndroni zgjuar deri vonë!



Ata që flenë vonë mund ta paguajnë një 'çmim' kur është fjala për shëndetin dhe

jetëgjatësinë e tyre. Personat të cilët qëndrojnë zgjuar deri vonë dhe kanë probleme të

zgjohen në mëngjes, kanë 10 për qind shanse më të larta të rrezikut për të vdekur më herët sesa ata që flenë dhe zgjohen herët.

Ekspertët tregojnë se është e rëndësishme që personat të cilët qëndrojnë zgjuar deri vonë ta kuptojnë se shprehitë e tyre të gjumit mund të kenë pasoja serioze shëndetësore, dhe ka shumë gjëra që iu ndihmojnë atyre t'i largojnë këto shprehitë. Vlen të ceket se këto zbulime janë

bazuar në studimin e më shumë se 433,000 britanikëve. Ndër tjerash, ata që qëndrojnë zgjuar deri vonë janë dyfish më të prirë të vuajnë nga çrregullimet psikologjike, 30 për qind më të rrezikuar nga diabeti, 25 për qind më të rrezikuar nga problemet neurologjike, 23 për qind më të rrezikuar nga çrregullimet gastrointestinale dhe 22 për qind më të rrezikuar nga sëmundjet respiratore.

1494 - Kristofer Kolombo zbarkon në Jamajka

1540 - Venediku dhe Turqia nënshkruajnë Traktatin e Konstantinopojës

1776 - Rhode Island shpall pavarësinë nga Anglia

1780 - Formohet Akademia e Shkencës dhe Arteve të Amerikës

1814 - Pushteti Burbon kthehet në Francë

1846 - Shteti amerikan Michigan ndalon dënimin me vdekje

1897 - Zjarri në tregun e Parisit në Rue Jean Goujon mbytet 200 persona

1910 - Themelohet Tel Avivi

1915 - Italia largohet nga Aleanca tripalëshe me Austro-Hungarinë dhe Gjermaninë

1926 - Grevë e përgjithshme në Britani

1931 - Mustafa Kemal bëhet kryetar i Turqisë

1945 - Trupat gjermane në Hollandë, Danimarkë dhe Norvegji dorëzohen

1978 - Presidenti rus Brezhnev viziton Gjermaninë Perëndimore

2000 - Ken Livingstone bëhet prefekti i parë i Londrës.

KALENDARI HISTORIK 3 MAJ



A E DINI SE...

Devetë kanë tre palë qerpikë që të mund të mbrohen nga era me rërë e shkretëtirës.



Libri i Rekordëve të Ginesit mban rekord si libri që vidhet më shpejt nga libraritë publike.



Është fizikisht e pamundur për një derr që të ngrrejë kokën dhe të shohë qiellin.



GJITHÇKA E BARABARTË

Burri kthehet i dehur në shtëpi, gruaja nuk ia hap derën.

- Kam lule për gruan më të bukur në botë - thotë ai.

Gruaja e hap derën.

- Ku janë lulet?

- E ku është gruaja më e bukur në botë?

BARSOLETA

THËNIA E DITËS



Lutesh për shiun, por duhet të bëhesh gati edhe për baltën. Është pjesë e tij. (Denzel Washington)